


August 30, 2022

KARAVASTA SOLAR

Projekti për Parkun Fotovoltaik Karavasta 140 MW

PLANI I RIKUPERIMIT TË JETESËS

Përditësim i Ndërmjetëm
Gusht 2022



INDEX

FJALORTH I TERMAVE	8
PARATHËNIE	11
ANGAZHIMI I PROPOZUESIT TË PROJEKTIT	12
PËRMBLEDHJE.....	12
Hyrje	12
Një vështrim i përgjithshëm i projektit	12
Kalendari i ndërtimit të projektit	13
Përmbledhje e Marrjes së Tokës dhe e Ndikimeve të Projektit	13
Mbledhja dhe analiza e të dhënave bazë	14
Angazhimi i Palëve të Interesit	15
Parimet e Kompensimit.....	17
Kudri i Kompensimit.....	18
Procesi i hyrjes në tokë dhe blerjes së saj	21
Plani i Rikuperimit të Jetesës.....	24
Menaxhimi i Ankesave.....	25
Korniza Organizative	26
Plani dhe Buxheti	27
Procesi i M&E	28
Menaxhimi i ndryshimit	28
1 HYRJE	29
1.1 Një vështrim i përgjithshëm i projektit	29
1.2 Qëllimi dhe objektivat e LRP-së.....	29
1.3 Struktura e LRP-së.....	30
2 PËRSHKRIMI I PROJEKTIT	32
2.1 QËLLIMI I PROJEKTIT	32
2.2 Përbërësit kryesorë të projektit dhe karakteristikat kryesore	32
2.2.1 Parku PV	32
2.2.2 Linja ajrore e transmetimit (OHL).....	34
2.3 Fazat dhe aktivitetet e projektit	35
2.3.1 Mobilizimi/Para Ndërtimit	35
2.3.2 Ndërtimi & Instalimi	35
2.3.3 Operimi & Mirëmbajtja.....	36
2.3.4 Ndërprerja ose Zgjatja e aktivitetit.....	37
2.4 Kalendari i ndërtimit të projektit.....	37

2.5	Veprimet për shmangien ose minimizimin e zhvendosjes	38
2.6	Përmbledhje e Marrjes së Tokës dhe e Ndikimeve të Projektit	40
3	KUADRI INSTITUCIONAL & LIGJOR	43
3.1	Kuadri Institucional i Shqipërisë	43
3.2	Kuadri Ligjor Shqiptar	43
3.2.1	Kushtetuta (Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë)	43
3.2.2	Ligjet / Aktet përkatëse	43
3.2.3	Procesi i shpronësimit	46
3.2.4	Marrja në Përdorim të Përkohshëm të Tokës	47
3.2.5	Procesi i vlerësimit	48
3.2.6	Mekanizmat e ankesave (GM)	48
3.3	Standardet dhe Udhëzimet Ndërkombëtare	48
3.3.1	Standardet e Performancës së IFC	49
3.3.2	Kërkesat e Performancës së BERZH-it	50
3.4	Politikat dhe Standardet e Korporatës	52
3.5	Analiza Krahasuese e Ligjit Kombëtar dhe Standardeve Ndërkombëtare	52
4	MBLEDHJA DHE ANALIZAT E TË DHENAVE BAZË	57
4.1	Hyrje	57
4.2	Mbledhja dhe analiza e të dhënave bazë të VNMS-së	58
4.2.1	Organizimi Administrativ i Zonës së Studimit të VNMS-së	58
4.2.2	Demografia dhe Përbërja e Familjeve	59
4.2.3	Gjuha, Etnia dhe Feja	59
4.2.4	Punësimi, Jetesa dhe Ekonomia	60
4.2.5	Përdorimi i tokës, Mbulimi i tokës dhe Pronësia	60
4.2.6	Infrastruktura dhe Shërbimet Komunale	61
4.2.7	Arsimi	61
4.2.8	Shëndeti	62
4.2.9	Gjinia dhe grupet e cënueshme	62
4.2.10	Trashëgimia kulturore	62
4.3	Mbledhja dhe analiza e të dhënave bazë të LRP	63
4.3.1	Vizitat në terren	64
4.3.2	Analiza e marrjes së tokës historike – Parku PV	64
4.3.3	Analiza e Pronësisë së Tokës dhe Informacionit Kadastral	65
4.3.4	Zhvillimi i Matricës së Anketës LRP	67
4.3.5	Analiza e burimeve dytësore	67
4.3.6	Anketa socio-ekonomike e familjeve	67

4.3.7	Anketa e aseteve (toka, ferma dhe kultura bujqësore)	77
4.3.8	Regjistri i Ndikimit Social të Projektit.....	83
4.4	Data e ndërprerjes së të drejtës së kompensimit.....	83
4.5	Sondazhe të Mëtejshme	84
4.6	Ruajtja dhe analiza e të dhënave bazë	84
5	ANGAZHIMI I PALËVE TË INTERESUARA	85
5.1	Praktika më e mirë ndërkombëtare	85
5.2	Qëllimi & Objektivat e Angazhimit të Palëve të Interesit	85
5.3	Identifikimi dhe analiza e palëve të interesuara	86
5.3.1	Identifikimi i grupit të palëve të interesuara.....	86
5.3.2	Identifikimi i grave dhe grupeve vulnerabël.....	89
5.4	Angazhimi i palëve të interesuara deri më sot	90
5.4.1	Takimet Publike	90
5.4.2	Takimet Konsultative	90
5.4.3	Anketa socio-ekonomike VNMS.....	91
5.4.4	Takimet në Kuadër të Publikimit të VNMS-së.....	91
5.4.5	Angazhimi i palëve të interesuara në lidhje me LRP	92
5.5	Aktivitetet e ardhshme për angazhimin e palëve të interesuara	95
5.5.1	Informimi dhe/ose takime me palët kryesore të interesuara	95
5.5.2	Planet e komunikimit	96
5.5.3	Udhëzues për blerjen dhe kompensimin e tokës	96
5.5.4	Plani i Rikuperimit të Jetesës	96
5.6	Kalendari i Angazhimit të Palëve të Interesit	97
6	IDENTIFIKIMI I NDIKIMEVE TË PROJEKTIT.....	100
6.1	Përpjekjet për të shmangur ose minimizuar ndikimet e projektit	100
6.2	Identifikimi i ndikimeve të projektit.....	101
7	KUADRI I KOMPENSIMIT.....	106
7.1	Konsideratat kryesore dhe praktikat më të mira ndërkombëtare	106
7.2	Objektivat e Kornizës së Kompensimit	107
7.3	Parimet e Kompensimit	107
7.3.1	Blerja e Përhershme e Tokës.....	108
7.3.2	Marrja e Përkohshme e Tokës	108
7.3.3	Aksesi i përkohshëm në tokë	109
7.3.4	Toka jetime.....	109
7.3.5	Kufizimet e servitutit	110
7.4	Studimi i vlerave të kompensimit.....	110

7.5	Matrica e vlerave të kompensimit.....	111
7.5.1	Përcaktimi i vlerave të zëvendësimit për parcelat e prekura	112
7.5.2	Tabelat e Detajuara të Vlerave të Kompensimit	113
7.6	Kuadri i pranueshmërisë: Identifikimi i grupeve të pranueshme	113
7.7	Matrica e pranueshmërisë dhe të drejtës.....	114
8	PROCESI I AKSESIT DHE BLERJES SË TOKËS	116
8.1	Hapat kyç	116
8.2	Përgatitja e Dosjeve Familjare	119
8.3	Përgatitja & Prezantimi i Ofertave	120
8.4	Procesi i Marrëveshjes Vullnetare me Familjet.....	120
8.5	Procedurat e shpronësimit	121
8.6	Marrëveshjet e Kompensimit.....	123
8.7	Pagesa e Kompensimit	124
8.8	Hyrja në Tokë.....	124
8.9	Dalja nga Toka & Dorëzimi te Pronari.....	125
9	PLANI I RIKUPERIMIT TË JETESËS	116
9.1	Masat për rikuperimin e jetesës	116
9.1.1	Rikthimi i parcelës në gjendjen e mëparshme	116
9.1.2	Këshilla dhe inpute bujqësore	116
9.1.3	Monitorimi Bujqësor dhe Vizitat Përmbyllëse.....	117
9.2	Vështirësitë e përkohshme dhe familjet vulnerabël	117
9.2.1	Përcaktimi i cënueshmërisë	117
9.2.2	Identifikimi i familjeve të cënueshme.....	118
9.2.3	Ndihma e mundshme / Mbështetje Tranzicionale.....	119
10	MBROJTJA E TRASHËGIMISË KULTURORE	120
10.1	Vlerësimi i Trashëgimisë Kulturore (TK)	120
11	MENAXHIMI I ANKESAVE.....	122
11.1	Praktika më e mirë ndërkombëtare	122
11.2	Parimet kryesore	122
11.3	Mekanizmi i Ankesave (GM)	122
11.3.1	Hapi 1 – Pritja dhe Regjistrimi i Ankesave	123
11.3.2	Hapi 2 – Shqyrtimi dhe Hetimi.....	124
11.3.3	Hapi 3 – Zgjidhja dhe Përgjigja e Ankesave	125
11.3.4	Hapi 4 – Mbyllja e ankesave	125
11.3.5	Hapi 5 – Vlerësimi i zgjidhjes	125
11.4	Monitorimi & Raportimi.....	125

12	KORNIZA ORGANIZATIVE.....	126
12.1	Organigrama e përgjithshme e projektit.....	126
12.2	Organograma e LRP-së	127
12.3	Përfshirja e Komunitetit	129
13	KALENDARI DHE BUXHETI.....	130
13.1	Kalendari i LRP-së	130
13.2	Buxheti i LRP-së	130
14	MONITORIMI DHE VLERËSIMI.....	132
14.1	Procesi i M&E.....	132
14.1.1	Procesi i brendshëm i M&E	132
14.1.2	Procesi i jashtëm M&E	133
14.2	Përfshirja e Komunitetit	134
14.3	Treguesit kryesorë të performancës	134
14.4	Raportimi	135
14.5	Auditimi i Përfundimit	135
15	MENAXHIMI I NDRYSHIMIT.....	136
	SHTOJCA 1 TABELAT E VLERAVE TË KOMPENSIMIT	137
	AKRONIMET	149

Figura 1:	Skema e projektit.....	9
Figura 2.1:	Vendndodhja e Projektit PV Solar Karavasta	29
Figura 3.1:	Planvendosja e impiantit	33
Figura 3.2:	Rruga e hyrjes në kantierin e PV	33
Figura 3.3:	Rruga e linjës ajrore	34
Figura 3.4:	Itinerari i rishikuar i OHL-së për të shmangur numrin e parcelave të ndikuara ...	39
Figura 3.5:	Itinerari i rishikuar i OHL-së në Nënstacion - duke shmangur numrin e parcelave të ndikuara dhe duke shkuar drejt OHL-së ndryshe nga kabllo të nëntokësore	40
Figura 5.1:	Harta e Trashëgimisë Kulturore të Zonës së Studimit	62
Figura 5.2:	Asetet e Trashëgimisë Kulturore në Zonën e Parkut PV.....	63
Figura 5.3:	Vizita në kantierin e parkut PV dhe angazhimet paraprake	64
Figura 5.4:	Paraqitja e bazës së të dhënave të Regjistrit Kadastral.....	66
Figura 5.5:	Numri i anëtarëve të familjes në mesin e PAH-ve të prekura.....	70
Figura 5.6:	Burimet kryesore të të ardhurave për AP.....	71
Figura 5.7:	PAH-të e angazhuar në bujqësi për mbijetesë/komerciale/të përziera.....	72
Figura 5.8:	Pjesa e produktit bujqësor të konsumuar për nevojat e HH	73
Figura 5.9:	PAH-të e angazhuar në blegtorinë për jetesë/comerciale/blegtori të përzier.....	73
FigurA 5.10:	PAH-të e angazhuar në blegtorinë për jetesë/comerciale/blegtori të përzier ...	74
Figura 5.11:	Produktiviteti i tokës për vitin e fundit dhe 5 vitet e fundit.....	74
Figura 5.12:	Pronësia mesatare e tokës për familje në mesin e PAH-ve të prekura	75
FigurA 5.13:	Kalendari i kulturave bujqësore të zonës së projektit / Të mbjellat mbizotëruese	78
Figura 5.14:	Mosha mesatare e pemëve në parcelat e prekura nga projekti	80
Figura 5.15:	Pemët frutore dhe vreshtat mbizotëruese në parcelat e prekura	81
Figura 5.16:	Mosha mesatare e pemëve pyjore në parcelat e tokës së prekur	81

Figura 5.17: Pemët pyjore në parcelat e tokës së prekur nga projekti	82
Figura 6.1: Angazhimi i përgjithshëm në vend deri më sot*	92
Figura 6.2: Posteri i Voltalia-s i vendosur në Projektin e fshatrave pranë	93
Figura 6.3: Angazhimi i palëve të interesuara me familjet e prekura nga projekti gjatë vërtetimit në terren të RSIR	95
Figura 11.1: Bunkeri i gjetur në kantierin e parkut PV.....	120
Figura 12.1: Hapat kyç të Mekanizmit të Ankesave	123
Figura 13.1: Organograma e Projektit	127
Figura 13.2: Organograma e LRP	129
Tabela 3.1: Orari i projektit Datat kryesore	38
Tabela 3.2: Zënia dhe ndikimet e parashikuara të tokës nga projekti	41
Tabela 4.1: Legjislacioni kryesor në lidhje me blerjen e tokës	44
Tabela 4.2: Procesi i shpronësimit Hapat kyç.....	46
Tabela 4.3: Analiza e mangësive të kërkesave kombëtare dhe ndërkombëtare	52
Tabela 5.1 : Organizimi administrativ i zonës së përshkuar nga Projekti	58
Tabela 5.2: Popullsia në Zonën e Studimit të VNMS-së	59
Tabela 5.3: Numri i familjeve me anketë socio-ekonomike sipas fshatit	67
Tabela 5.4: Organizimi administrativ i zonës së prekur nga gjurmët e projektit	69
Tabela 5.5: Treguesit kryesorë demografikë të PAH-ve në zonën e projektit	70
Tabela 5.6: Përqindja e tokës së përfituar përgjithmonë për projektin (parcelat e shtyllave) në krahasim me pronat totale të tokës *	75
Tabela 5.7: Zona e projektit të mbjellat mbizotëruese dhe periudhat kryesore të kultivimit ..	79
Tabela 6.1: Palët kryesore të interesit për projektin LRP	86
Tabela 6.2: Kalendar i Angazhimit të Palëve të Interesit.....	97
Tabela 7.1: Ndikimet e hyrjes në tokë	101
Tabela 7.2 Vlerësimi i Ndikimeve	102
Tabela 8.1: Matrica e Kompensimit	111
Tabela 8.2: Matrica e pranueshmërisë dhe të drejtës.....	114
Tabela 9.1: Procesi i Negocimit dhe Shpronësimit	121
Tabela 10.1: Vlerësimi i rrezikut të cënueshmërisë	118
Tabela 14.1: Programi i nivelit të lartë të LRP	130
Tabela 14.2: Vlerësimi i buxhetit të LRP.....	131
Tabela 16.1 : Menaxhimi i Ndryshimit të LRP.....	136

FJALORTH I TERMAVE

Akti i Marrjes së Tokës në Pronësi (AMTP): akt administrativ i nxjerrë për pronësinë për tokën bujqësore, i cili ka pasur për qëllim kalimin e pronësisë së tokës shtet në favor të pronarëve privatë.

Agjencia Shtetërore e Kadastrës (ASHK): Agjencia qeveritare shqiptare e krijuar për të trajtuar çështjet e legalizimit, kthimit dhe regjistrimit të banesave dhe të gjitha pronave të paluajtshme në të gjithë territorin e Shqipërisë.

Komuniteti: Një grup individësh më i gjerë se familja, të cilët e identifikojnë veten si një njësi e përbashkët për shkak të lidhjeve të njohura sociale, fetare, ekonomike ose lidhjeve tradicionale administrative ose përmes të jetuarit në të njëjtin lokalitet.

Kompensim: Pagesa me para në dorë ose në natyrë për një aset ose për një burim që blihet ose që preket nga një projekt në kohën kur ky aset duhet të zëvendësohet.

Toke Truall: i referohet tokës urbane në të cilën është i lejuar përdorimi për zhvillim urban (tokë urbane formale), ose tokë në të cilën nuk lejohet por është përdorur tashmë për zhvillim urban (tokë urbane informale). Për qëllimin e kësaj LRP-je Tokë Truall konsiderohet vetëm parcela e tokës e cila është kategorizuar si "truall" në certifikatën e pronësisë së tokës. Shpesh përdoret termi "tokë urbane".

Ndihma për Zhvendosjen: Mbështetje që u ofrohet njerëzve që zhvendosen fizikisht për shkak të një projekti. Kjo ndihmë mund të përfshijë transportin, strehimin dhe shërbimet që u ofrohen njerëzve të prekur gjatë zhvendosjes. Ndihma mund të përfshijë edhe kompensime me para në dorë që kompensojnë personat e prekur nga projekti për shqetësimet e shkaktuara nga zhvendosja dhe mbulon shpenzimet e zhvendosjes në një vend të ri, si për shembull shpenzimet e transportit.

Servituti: Servituti është e [drejta jo poseduese](#) mbi tokën për ta përdorur dhe/ose për të hyrë në një [pronë të paluajtshme](#) të një personi tjetër pa e patur atë tokë në pronësi.

Kufizimet e **servitutit: Kufizimet** e servitutit janë kufizime të lidhura me servitutin, që e pengojnë një pronar tokë ose përdorues të kryejë një veprimtari që do të kishte qenë e ligjshme në kushte të tjera në pronën e tyre, si ndërtimi i strukturave mbi një lartësi të caktuar në tokë urbane ose kultivimi i pemëve mbi një lartësi të caktuar në tokë bujqësore ose tokë pyll.

Zhvendosja ekonomike: Humbja e rrjedhave të të ardhurave ose mjeteve të jetesës që rezultojnë nga blerja e tokës ose aksesit i penguar në burime (tokë, ujë ose pyll) që rezulton nga ndërtimi ose funksionimi i një projekti ose objekteve të lidhura me të.

Familjet e zhvendosura ekonomikisht: Familjet, mjetet e jetesës së të cilave ndikohen nga Projekti, ku mund të përfshijë si familjet që jetojnë në zonën ku do të zhvillohet projekti, ashtu edhe njerëzit që jetojnë jashtë Zonës së Projektit, por që kanë tokë, kultura bujqësore, biznese ose të drejta të ndryshme përdorimi në të.

Vlerësimi i **Shërbimeve të Ekosistemit:** Studim për të përcaktuar përfitimet që njerëzit, duke përfshirë edhe bizneset, nxjerrin nga ekosistemet, ndikimet e mundshme të një projekti në këto shërbime dhe masat për të zbutur ndikimet.

Kulturat bujqësore të kompensueshme: Kulturat bujqësore të mbjella brenda zonës së projektit nga personat e prekur nga projekti përpara datës prej së cilës ato kanë të drejtën e kompensimit dhe që plotësojnë kriteret për kompensim në përputhje me këtë LRP.

Toka e **kompensueshme**: Toka (të mbjella dhe djerrë, toka bujqësore apo toka që i përkasin njësisë administrative përkatëse) brenda zonës së projektit që plotësojnë kriteret për kompensim në përputhje me këtë LRP.

Të **drejtat**: Përfitimet e përcaktuara në këtë LRP, duke përfshirë kompensimin financiar dhe të drejtën për të marrë pjesë në programet e rikuperimit të mjeteve të jetesës.

Data e ndërprerjes së kompensimit: Data e përcaktuar nga Projekti si afati i fundit për të drejtën për kompensim, e njohur gjithashtu si **Data e Moratoriumit**. Personat që zënë zonën e projektit pas datës së ndërprerjes së kompensimit nuk kanë të drejtë për kompensim dhe/ose për ndihmë lidhur me zhvendosjen e tyre. Po kështu, as asetet fikse (të tilla si strukturat e ndërtruara, kulturat bujqësore, pemët frutore) të krijuara pas datës së ndërprerjes së kompensimit (Data e Moratoriumit) nuk do të kompensohen.

Vlerësimi i Ndikimit Mjedisor dhe Social (VNMS): Për Projektin Karavasta 140 MW është përgatitur një VNMS. VNMS është një studim i integruar që shqyrton se si mjediset biofizike, sociale dhe shëndetësore ka të ngjarë të ndikohen nga Projekti.

BERZH: Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim, Korporata Financiare, bankë e cila ofron shërbime investimi dhe këshillimore për projektet e sektorit privat në vendet në zhvillim me synimin garantimin e përfitimit të të gjithëve nga rritja ekonomike.

Fermer: Një person që ka fituar të drejtën për të përdorur një pjesë toke për aktivitete bujqësore, qoftë për gjenerim parash ose për konsum familjar dhe është i angazhuar në aktivitete të tilla në kohën e datës së ndërprerjes së kompensimit.

Kostoja e plotë e zëvendësimit: Vlera e tregut e aseteve plus kostot e transaksionit, ku amortizimi i strukturave dhe aseteve nuk merret parasysh.

Familja: Një person, ose grup personash që jetojnë së bashku, në një shtëpi individuale, që përdorin ambiente të përbashkëta gatimi dhe ngrënieje dhe që formojnë një njësi bazë socio-ekonomike dhe vendimmarrëse.

IFC: Korporata Financiare Ndërkombëtare, bankë e cila ofron shërbime investimi, këshillimi dhe shërbime për administrimin e aseteve për të inkurajuar zhvillimin e sektorit privat në vendet më pak të zhvilluara.

Zhvendosja e pavullnetshme: Zhvendosja, e cila mund të konsistojë në zhvendosje ekonomike dhe/ose zhvendosje fizike, është e pavullnetshme kur ndodh pa pëlqimin e informuar të personave të zhvendosur ose nëse ata japin pëlqimin e tyre pa pasur fuqinë për ta kundërshtuar zhvendosjen.

Blerja e tokës / Aksesimi i tokës: Në kuptimin e BERZH PR5, IFC PS 5, dhe kërkesave të tjera të ngjashme ndërkombëtare, "blerja e tokës" kuptohet se përfshin blerjet e plota të pronës dhe blerjet e të drejtave të ndryshme nga të drejtat e plota pronësore, si p.sh. e drejta e kalimit. Në vitet e fundit, specialistët shpesh kanë preferuar të përdorin termin "akses në tokë" dhe jo "blerje të tokës", për të mbuluar jo vetëm blerjet reale, por edhe forma të tjera të aksesit në tokë, si zënie e përkohshme të tokës ose përftimin e të drejtave të ndryshme nga të drejtat e pronësisë së plotë (të drejtat e kalimit ose disa të drejta të uzufruktit).

Inventari i tokës, fermave dhe kulturave bujqësore: Inventarizimi i të gjitha tokave, fermave dhe kulturave të kompensueshme brenda zonës së projektit.

Pronari i tokës: Është personi që ka pronësinë e tokës në të cilën ndodhet një fermë.

Mjetet e jetesës: Mjetet e jetesës përfshijnë kapacitetet, asetet (duke përfshirë burimet materiale dhe sociale) dhe aktivitetet e nevojshme si mjet jetese. Jetesa është e qëndrueshme kur mund të përballet dhe të rikuperohet nga stresi dhe goditjet dhe të ruajë ose përmirësojë aftësitë dhe asetet si në të tashmen, ashtu edhe në të ardhmen, duke mos dëmtuar bazën e burimeve natyrore.

Programet e **jetesës**: Programe që synojnë të rikuperojnë ose të përmirësojnë sigurinë ekonomike për njerëzit e prekur nga projekti nëpërmjet ofrimit të ndihmës ekonomike, duke përfshirë, por pa u kufizuar në aktivitete të tilla si trajnimi dhe prodhimi bujqësor.

Plani i Rimëkëmbjes së Jetesës (PRJ): Dokumenti në të cilin një propozues i projektit specifikon procedurat që do të ndiqen dhe veprimet që do të ndërmerren për të zbutur efektet negative, për të kompensuar humbjet dhe për të ofruar përfitime zhvillimore për personat dhe komunitetet e prekura nga një projekt.

Data e Moratoriumit: Një tjetër afat për datën e **ndërprerjes** së kompensimit, duke qenë data e përcaktuar nga Projekti si afati i fundit për të drejtën për kompensim. Personat që vendosen në zonën e projektit pas datës së ndërprerjes së kompensimit nuk kanë të drejtë për kompensim dhe/ose ndihmë për zhvendosjen. Po kështu, as asetet fikse (si strukturat e ndërtuara, kulturat bujqësore, pemët frutore dhe parcelat pyjore) të krijuara pas datës së ndërprerjes së kompensimit nuk do të kompensohen.

Tokë jetime: Sipërfaqe toke brenda një parcele toke që nuk është drejtpërdrejt objekt i blerjes së tokës (qoftë blerjes së përkohshme apo të përhershme), por që bëhet joekonomike për shkak të madhësisë ose formës në të cilën mbetet toka.

Operatori i Sistemit të Transmetimit (OST): Ofruesi shtetëror i energjisë që administron sistemin e transmetimit të energjisë elektrike në Shqipëri. Zona e Impiantit do të ndërtohet dhe do të operohet nga Karavasta Solar sh.p.k, ndërsa Linja ajrore e transmetimit (LT) do të ndërtohet nga Karavasta Solar sh.p.k, por do të jetë nën pronësinë dhe operimin e OST-së.

Linja ajrore transmetimi (OHL): Tela ose kablo të varura midis shtyllave që përdoren për shpërndarjen e energjisë.

Projekti: Projekti i Karavastasë, i përbërë nga një Park Fotovoltaik diellor 140 MW (Vendi i parkut) dhe Linja ajrore e transmetimit 220 kV (OHL).

Zona e **projektit**: Zona e identifikuar nga Projekti, e cila nevojitet si zonë për ndërtimin e Parkut FV dhe të linjës së transmetimit (OHL). Të gjitha kulturat bujqësore të kompensueshme dhe toka brenda kësaj zone brenda afatit të kompensimit do të kenë të drejtën e kompensimit sipas kushteve të kësaj LRP-je.

Norma e projektit për blerjen e tokës: Vlera e tregut e tokës me të njëjtin përdorim produktiv ose me të njëjtin potencial që gjendet në afërsi të tokës së prekur, plus koston e përgatitjes në nivele të ngjashme ose në nivel më të mirë se ato të tokës së prekur, plus koston e çdo regjistrimi dhe takse pas transferimit të pronësisë.

Norma e projektit për kompensimin e kulturave bujqësore: Kostoja e zëvendësimit për bimët dhe pemët shumëvjeçare duhet të jetë ekuivalente me çmimet aktuale të tregut duke pasur parasysh llojin, moshën dhe vlerën prodhuese të bimëve dhe/ose të pemëve, duke përfshirë produktivitetin e humbur për të ardhmen.

Zhvendosja fizike: Humbja e strehimit dhe e aseteve që vijnë si rrjedhojë e blerjes së tokës në lidhje me një projekt që kërkon që personi(at) që preken prej tij të zhvendosen në një vend tjetër.

Familje e prekur nga projekti: Të gjithë anëtarët e një familjeje, qofshin ata të lidhur ose jo me njëri-tjetrin, që veprojnë si një njësi e vetme socio-ekonomike dhe vendimmarrëse që preket nga një projekt.

Person i prekur nga projekti: Çdo person që, si rezultat i zbatimit të një projekti, humbet të drejtën e zotërimit, përdorimit apo qoftë edhe të përfitimit nga një strukturë e ndërtuar, një tokë, nga kulturat dhe pemët njëvjeçare dhe shumëvjeçare, ose nga ndonjë tjetër aset i luajtshëm apo i paluajtshëm, plotësisht ose pjesërisht, përgjithmonë ose përkohësisht.

Kostoja e zëvendësimit: Shkalla e kompensimit për aktivet e humbura duhet të llogaritet me koston e plotë të zëvendësimit, domethënë me vlerën e tregut të aktiveve plus koston e transaksionit.

Risistemimi: Procesi përmes të cilit familjeve të zhvendosura fizikisht u sigurohen parcela zëvendësuese dhe struktura banimi në një vend të caktuar. Risistemimi përfshin iniciativa për të rikthyer në gjendjen e mëparshme dhe për të përmirësuar standardet e jetesës së atyre që do të zhvendosen.

E drejta e kalimit: E drejta ligjore që një projekt publik (në këtë rast, një projekt energjie) të kalojë përgjatë një rruge të caktuar përmes terreneve ose pronës që i përket individëve privatë.

Spekulime: Ngritja e ndërtesave ose strukturave, ose mbjellja e të korrave brenda zonës së Projektit, me qëllimin e vetëm për të kërkuar kompensim nga propozuesi i projektit. Spekulumet mund të bëhen para moratoriumit; që ndodhin përpara se të deklarohet data e ndërprerjes së kompensimit ose pas moratoriumit, d.m.th. që ndodhin pas datës së ndërprerjes së kompensimit.

Palët e interesuara: Çdo dhe të gjithë individët, grupet, organizatat dhe institucionet e interesuara dhe potencialisht të prekura nga një projekt ose që kanë aftësinë për të ndikuar në një projekt.

Zona e studimit: Zona e studimit i referohet zonës së identifikuar nga Projekti si me interes për anketën socio-ekonomike të Vlerësimit të Ndikimit Mjedisor dhe Social (VNMS), pasi ajo shërben si baza informuese për vlerësimin nga ana e projektit të ndikimit social dhe ndikimit sa i përket zhvendosjeve.

Tokë Urbane: I referohet tokës e cila lejohet të përdoret për zhvillim urban (tokë urbane formale), ose tokë në të cilën nuk lejohet por është përdorur tashmë për zhvillim urban (tokë urbane informale). Për tokën urbane përdoret tani më shumë termi "Truall", e cila e dallon atë nga toka bujqësore apo pyjore.

Personat e cenueshëm: Njerëzit të cilët për shkak të gjinisë, përkatësisë etnike, moshës, aftësisë së kufizuar fizike ose mendore, disavantazhit ekonomik ose statusit social mund të ndikohen më negativisht se të tjerët nga zhvendosja dhe që mund të kenë aftësi të kufizuara për të kërkuar ose për të përfituar nga ndihma që jepet për zhvendosjen dhe përfitimet e lidhura me zhvillimin.

E drejta e kalimit: Një lloj Servituti që përdoret nga kompanitë që siguron akses në pronë për qëllim ndërtimi dhe mirëmbajtjeje.

PARATHËNIE

Ky Plan i Rikuperimit të Jetesës (LRP) për Projektin Fotovoltaik 140 MW të Karavastasë (projekti) është përgatitur nga Steyn Reddy Associates (SRA), në bashkëpunim të ngushtë me, dhe në emër të Voltalia SA, dhe filialit të saj në pronësi të plotë shqiptare, Karavasta Solar. Sh.p.k (Voltalia).

Dokumenti përmban një procesverbal të procedurave, veprimeve dhe angazhimeve që do të ndërmerren për të kompensuar personat e prekur nga projekti, në përputhje me ligjet e Shqipërisë dhe me politikat mjedisore dhe sociale në fuqi të Korporatës Financiare Ndërkombëtare (IFC) dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH).

ANGAZHIMI I PROPOZUESIT TË PROJEKTIT

Voltalia miraton LRP-në e paraqitur në këtë dokument dhe angazhohet për zbatimin e tij të në mënyrë të plotë, në kohën e duhur dhe në mënyrë efikase. Versioni përfundimtar i LRP do të bëhet publik, së bashku me angazhimin e deklaruar të Voltalia për zbatimin e LRP-së.

PËRMBLEDHJE

Hyrje

Karavasta Solar sh.p.k, një korporatë shqiptare, propozon ndërtimin e Projektit “Karavasta Solar”, një park Fotovoltaik 140 MW dhe një linjë ajrore transmetimi (OHL) në bashkitë Divjakë dhe Fier të Shqipërisë (Projekti). Zona e Impiantit do të ndërtohet dhe do të operohet nga Karavasta Solar sh.p.k, ndërsa Linja Ajrore e Transmetimit (OHL) do të ndërtohet nga Karavasta Solar sh.p.k, por do të jetë në pronësinë dhe operimin e Operatorit të Sistemit të Transmetimit (OST), Ofruesit Shtetëror të Energjisë.

Ky dokument përfaqëson Planin e Rikuperimit të Jetesës (LRP) për Projektin “Karavasta Solar”. Në zhvillimin e LRP-së, Kompania është e angazhuar të respektojë legjislacionin Shqiptar, politikat mjedisore dhe sociale të Korporatës Financiare Ndërkombëtare (IFC) dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH), si dhe praktikat më të mira ndërkombëtare.

Një vështrim i përgjithshëm i projektit

Projekti “Karavasta Solar” (Projekti) është një zhvillim i energjisë fotovoltaike të rinovueshme (PV) i vendosur në rajonin e Divjakës në Shqipëri, i cili përfshin komponentët e mëposhtëm:

1. Një park fotovoltaik (PV) me sipërfaqe 185 ha dhe me kapacitet maksimal të instaluar prej 140 MW;
2. Një linjë ajrore transmetimi 220 kV rreth 19 km e gjatë me 57 kulla që lidhin parkun PV me një nënstacion elektrik ekzistues në Fier.

FIGURA 0.1: SKEMA E PROJEKTIT



Kalendari i ndërtimit të projektit

Ndërtimi i Projektit është planifikuar të fillojë me punimet e hershme të kantierit në tremujorin e 3-të të vitit 2022 dhe të jetë në funksionim të plotë në gjysmën e 2-të të vitit 2023. Kohëzgjatja e pritshme e periudhës së ndërtimit konsiston në 2 muaj përgatitje të kantierit dhe 11 muaj ndërtim. Plani përfundimtar i ndërtimit do të specifikohet gjatë fazës së projektimit të detajuar.

Tabela më poshtë tregon datat kryesore.

Faza e projektit	Kohëzgjatja e parashikuar	Gama e parashikuar e datave
Vendndodhja e parkut PV		
Lejet dhe miratimet	3 muaj	Tetor '20 - Maj '22
Punimet e hershme	2 muaj	Korrik'22 - Gusht '22
Faza e ndërtimit	11 muaj	Korrik '22 - Gusht '23
Testimi dhe vënia në punë	3muaj	Gusht '23 - Tetor '23
Linja e Transmentimit Ajror - OHL		
Lejet dhe miratimet	3 muaj	Gusht '22 - Tetor '22
Faza e ndërtimit	10 muaj	Shtator '22 - Gusht '23
Testimi dhe vënia në punë	2 muaj	Gusht '23 - Tetor '23

Përmbledhje e Marrjes së Tokës dhe e Ndikimeve të Projektit

Projekti do të përfshijë marrjen e masave për shmangien dhe minimizimin e zhvendosjeve në fazën e projektimit të detajuar dhe të ndërtimit. Megjithatë, ndikimet kryesore në marrjen e tokës mund të vlerësohen me saktësi në këtë fazë, ku ato janë marrë parasysh në zhvillimin e këtij dokumenti LRP për të adresuar të gjitha ndikimet.

Faza e Projektit	Komponenti	Marrja e parashikuar e tokës	Parcelat e parashikuara të tokës	Kohëzgjatja	Ndikimet e mundshme
Ndërtimi	Zona e parkut	185 ha	21 parcela toke	Të përhershme	Ndikimet në kullotjen informale dhe në aktivitete të tjera; kufizimet e aksesit
	Kantieret e ndërtimit dhe zonat e shtrimit	4 ha	2 parcela toke	E përkohshme	Ndikimet në kullotjen informale; kufizimet e aksesit

Faza e Projektit	Komponenti	Marrja e parashikuar e tokës	Parcelat e parashikuara të tokës	Kohëzgjatja	Ndikimet e mundshme
	Rrugët e hyrjes në kantier	Mbeten për t'u përcaktuar	25 parcela toke	E përkohshme	Ndikimet në kullotje informale dhe aktivitete të tjera; kufizimet e aksesit; humbja e kulturave bujqësore
	Shtyllat e OHL	57 shtylla që zënë një sipërfaqe toke prej mesatarisht 10m x 10m	578 parcela toke	Të përhershme	Humbja e tokës; humbja e kulturave bujqësore dhe të ardhurave bujqësore
	Rrugët hyrëse të shtyllave të OHL	57 parcela toke për rrugët hyrëse (përlllogaritja e marrjes së përkohshme të tokës 5m x 5m)	57 parcela toke	E përkohshme	Humbja e përkohshme e tokës, humbje e kulturave bujqësore dhe të ardhurave bujqësore; probleme për dheun
	Rrugët e hyrjes dhe Korridori i Ndërtimit të OHL-së	Përafërsisht. 17 ha	725 parcela toke*	E përkohshme	Humbja e kulturave bujqësore dhe të ardhurave bujqësore; problemet për dheun
Operacionet	E drejta e kalimit për tek OHL-ja	25 m rrugë kalimi në secilës anë të OHL-së	725 parcela toke*	Të përhershme (kufizime të pjesshme)	Kufizimet e servitutit në lidhje me përdorimet e lejuara në tokën urbane sa i përket të drejtës së kalimit dhe zonës në të cilën vlen kjo e drejtë kalimi**.

*634 parcela toke të inventarizuara më 21 dhjetor, 32 parcela të reja toke të identifikuar për ndryshimin e gjurmës së OHL-së dhe 50 parcela të reja toke të prekura nga rrugët hyrëse në OHL.

**Projekti nuk do të aplikojë servitut mbi tokat bujqësore apo pyjet. Megjithatë, pronarët e tokave të cilët kanë tokë truall (tokë urbane) brenda korridorit 25 m në të dyja anët e linjës OHL në praktike mund të mos jenë në gjendje të ndërtojnë në këto toka në të ardhmen, pavarësisht se nuk do të aplikohet asnjë kufizim ligjor mbi këto toka. Në këto raste, do të paguhet kompensim sipas Normave të Servitutit për Tokën Urbane.

Mbledhja dhe analiza e të dhënave bazë

Mbledhja e të dhënave bazë për të informuar LRP-në u bazua në burimet e mëposhtme:

1. Informacioni bazë relevant dytësor socio-ekonomik i referuar në zhvillimin e LRP (p.sh., të dhënat kombëtare, të dhënat e Vlerësimit të Ndikimit Mjedisor dhe Social të Projektit (VNMS))
2. Mbledhja dhe analiza e të dhënave primare të ndërmarra për të informuar LRP-në, duke përfshirë
 - Analizën e Pronësisë së Tokës dhe Informacionit Kadastral;
 - Anketat socio-ekonomike të familjeve të prekura drejtpërdrejt;
 - Anketat e aseteve dhe vlerësimi bazë agronomik i parcelave të prekura të tokës.
3. Angazhimi i palëve të interesuara

Familjet e prekura nga projekti (PAH) në zonën e gjurmës së Projektit janë shumë të prekura nga tendencat e migrimit dhe shumica e PAH-ve mbështeten në bujqësi dhe në fondet e pensioneve si burimet kryesore të jetesës dhe të të ardhurave.

Angazhimi i Palëve të Interesit

Pjesëmarrja e komunitetit dhe kontributet në zhvillimin e projektit deri më sot janë siguruar nëpërmjet mekanizmave të mëposhtëm:

1. Takimet Publike;
2. Takimet Konsultative;
3. Angazhimet e VNMS-së në Anketën Socio-Ekonomike;
4. Angazhimi i palëve të interesuara në lidhje me LRP, i cili përfshinte:
 - Zhvillimin e planeve të komunikimit në lidhje me komunikimin me komunitetin dhe aktivitetet e inventarizimit;
 - Angazhimi në lidhje me anketat bazë;
 - Postera informuese për projektin në fshatra;
 - Përhapja e Mekanizmit të Ankesave për familjet e përfshira në procesin e inventarizimit;
 - Vlerësimi i Regjistrimit të Ndikimit Social të Gjurmës – angazhimet me familjet/bizneset që mund të preken.

Angazhimi i palëve të interesuara për të gjitha çështjet që lidhen me zhvendosjen do të vazhdojë të zhvillohet përmes një sërë procesesh dhe aktiviteteve:

- Informimi dhe/ose takime me palët kryesore të interesuara;
- Planet e komunikimit për aktivitetet kryesore të projektit (p.sh., inventarizimi para ndërtimit, regjistrimi i tokës, etj.);
- Bërja e ditur e Udhëzuesit për Blerjen dhe Kompensimin e Tokës për familjet e prekura;
- Zbatimi dhe monitorimi i Planit të Rikuperimit të Jetesës.

Kalendari i Angazhimit të Palëve të Interesit që mbulon periudhën e zhvillimit të LRP-së, marrëveshjet vullnetare dhe shpronësimet, dhe ndërtimin e projektit, paraqitet më poshtë.

Metodologjia dhe Grupi i Palëve të Interesit	Formati	Frekuenca
Konsultimet		
Takim informues për OST (përfshirë prezantimin e matricës së kompensimit, GLAC, LRP, etj.)	Takime sistematike dhe korrespondencë me shkrim	Çdo dy javë
Agjencia Shtetërore e Shpronësimit (ASHSH) (duke përfshirë edhe paraqitjen e matricës së kompensimit)	Korrespondencë me shkrim sipas nevojës	Sipas nevojës

Metodologjia dhe Grupi i Palëve të Interesit	Formati	Frekuenca
Informim për Ministritë/Agjencitë: <ol style="list-style-type: none"> 1. Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë 2. Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural 3. Ministria e Kulturës 4. Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit 5. Agjencia Kombëtare e Kompensimit dhe Kthimit të Pronave 	Takimi fillestar zyrtar i pasur nga korrespondenca me shkrim	Çdo tremujor
Informim për Institucionet, Zyrtarët dhe Agjencitë Rajonale dhe Lokale: <ol style="list-style-type: none"> 1. Prefektura e Qarkut Fier 2. Këshilli i Qarkut Fier 3. Drejtoria Rajonale e Bujqësisë 4. Drejtoria Rajonale e Mjedisit 5. Agjencia e Zhvillimit Bujqësor dhe Rural 6. Njësia Administrative Fier 7. Njësia Administrative Libofshë 8. Kryetar i Bashkisë Fier 9. Kryetar i Bashkisë Divjakë 	Takimi fillestar zyrtar i pasuar nga korrespondenca me shkrim	Çdo tremujor
Takim informues për mediat rajonale	Takimi fillestar zyrtar i pasur nga korrespondenca me shkrim	Çdo tremujor
Fokus grupe me grupe të veçanta të interesit duke përfshirë Grupet e Shoqërisë Civile (OJQ), Biznesin, Grupet e Grave	Takimi fillestar zyrtar i pasuar nga korrespondenca me shkrim	Çdo tremujor
Shpërndarja e Informacionit dhe Zgjidhja e Ankesave		
Bërja e ditur e GLAC për Departamentet dhe Agjencitë Rajonale dhe Komunale	Takime formale	Maj 2022
Prezantimi i GLAC për PAH	Vizita në familje	Maj - Qershor 2022
Angazhimi me PAH që kanë paraqitur një ankesë në Projekt nëse është e nevojshme	Takime ad-hoc	Ad-hoc
Angazhim me PAH, toka e të cilëve nevojitet për studime gjeologjike bazë në terren	Takime ad-hoc	Ad-hoc
Marrëveshjet Vullnetare Familjare & Nënshkrimi		
Takimi ballë për ballë me PAH (kryefamiljarët dhe bashkëshortet) për t'u paraqitur Ofertën e Kompensimit	Vizitë në familje	Një vizitë e vetme

Metodologjia dhe Grupi i Palëve të Interesit	Formati	Frekuenca
Vizita të mëtejshme në PAH (me kryefamiljarët dhe me bashkëshortet e tyre) për nënshkrimin e marrëveshjes. Angazhim i zgjeruar për PAH vulnerabël që janë identifikuar	Vizita në familje (2-4 takime, sipas nevojës)	Dyjavore dhe javore (një herë të vetme)
Hyrja në Tokë dhe Dalja prej saj		
Angazhimi i menaxherit të ndërtimit dhe CLO me PAH për të nënshkruar Protokollet e hyrjes në Tokë	Vizitë në familje	Gjatë ndërtimit sipas nevojës
Angazhimi i Menaxherit të ndërtimit, Agronomit dhe CLO-së me PAH për të nënshkruar Formularin e Rikthimit të Tokës në Gjendjen e Mëparshme dhe Daljes nga Toka	Vizitë në familje	Gjatë ndërtimit / pas ndërtimit sipas nevojës
Shpërndarja e Informacionit dhe Zgjidhja e Ankesave		
Tabela informacioni në çdo fshat në lidhje me: punësimin, trajnimin, çështjet e sigurisë dhe kalendarin e ndërtimit	Tabelat e shpalljeve publike	Sipas nevojës
Vizitat e planifikuara nga Koordinatorët për Marrëdhëniet me Komunitetin (CLO) në çdo fshat	Takimi fillestar dhe vizitat nga CLO(të) në çdo fshat	Çdo javë ose sipas nevojës
Programet për mjetet e jetesës dhe për personat vulnerabël		
Programet për mjetet e jetesës dhe për personat vulnerabël	Vizita në familje si pjesë e procesit të nënshkrimit të marrëveshjes	Sipas nevojës

Bazuar në angazhimet e palëve të interesuara, analizën e të dhënave dhe karakteristikat e projektit, u ndërmor një vlerësim i ndikimeve të projektit, i cili rezultoi në zhvillimin e Kornizës së Kompensimit të Projektit për të adresuar të gjitha ndikimet e identifikuara.

Parimet e Kompensimit

Parimet e përgjithshme që do të miratohen nga projekti në lidhje me kompensimin janë si më poshtë:

1. Voltalia kërkon të arrijë marrëveshje vullnetare me personat dhe familjet e prekura, me shpronësimin e përdorur vetëm kur është e nevojshme – në praktikë për shkak të vështirësive që familjet hasin në sigurimin e dokumentacionit përkatës të pronësisë për nënshkrimin e marrëveshjeve të kompensimit, do të ndiqet procesi i shpronësimit për shumicën e rasteve. Në këto raste, Voltalia do të hyjë në marrëveshje kompensimi me familjet në mënyrë që të paguajë kompensimin e plotë paraprakisht (shih Parimin 3 më poshtë).
2. Kompensimi do të jetë me vlerën e plotë të zëvendësimit, pa zhvlerësim dhe duke marrë parasysh të gjitha kostot e transaksionit
3. në rastin e shpronësimit, për familjet që më parë kanë hyrë në një marrëveshje vullnetare, Voltalia do të paguajë shumën e plotë të kompensimit përpara hyrjes në tokë, pavarësisht pagesës që familja mund të përfitojë nëpërmjet procesit të shpronësimit. Procedurat për procesin e shpronësimit fillohen para fillimit të ndërtimit.
4. Për familjet që refuzojnë marrëveshjet vullnetare, Voltalia do të vërë në dispozicion pjesën shtesë të pagesës që i shtohet pagesës së shpronësimit që të arrihet vlera e plotë e kompensimit sipas normave të projektit.

5. Përveç kompensimit për asetet, do të merren edhe masa të tjera sipas nevojës për të siguruar restaurimin efektiv dhe në kohë të parcelave të prekura
6. Familjet e identifikuar si të cenueshme do të kenë të drejtë për ndihmë shtesë për fazën kalimtare.

Kuadri i Kompensimit

Matrica e Kompensimit për Projektin është përmbledhur më poshtë. Ajo është paraqitur gjithashtu edhe në Udhëzuesin për Blerjen dhe Kompensimin e Tokës (GLAC) që do t'u jepet të gjitha familjeve që preken drejtpërdrejt nga projekti.

Lloji i Ndikimit	Lloji i kompensimit
1. Blerja e përhershme e tokës	Për pronarin e tokës (duke përfshirë edhe ata që kanë një certifikatë AMTP (Akti i Marrjes së Tokës në Pronësi), por që nuk e kanë të regjistruar: Blerja e tokës në këto raste duhet të bëhet sipas Normës së Projektit për Blerjen e Tokës* bazuar në vlerën e tregut. Kompensimi për çdo aset fiks të prekur me vlerën e plotë të zëvendësimit (p.sh., strukturat e ujitjes, kullimit, barakat, pusët etj.)
	Për përdoruesin e tokës: Kompensimi për humbjen e kulturave bujqësore sipas normës së projektit për kulturat bujqësore** bazuar në vlerën e plotë të zëvendësimit
2. Blerja e Përkohshme e Tokës	Për pronarin e tokës (duke përfshirë edhe ata që kanë një certifikatë AMTP (Akti i Marrjes së Tokës në Pronësi), por që nuk e kanë të regjistruar): Kompensim për tokën në masën 12.5% të Normës së Projektit për Blerjen e Tokës (Normat e Projektit për Qiranë e Tokës), e paguar çdo vit.
	Për përdoruesin e tokës: Kompensimi për humbjen e kulturave bujqësore sipas normës së projektit për kulturat bujqësore** bazuar në vlerën e plotë të zëvendësimit
3. Akses i përkohshëm në tokë	<p>Për pronarin (përfshirë mbajtësit e Aktit të Marrjes së Tokës në Pronësi "AMTP"): Kompensim për tokën në masën 12.5% të Normës së Projektit për Marrjen e Tokës, në raport me periudhën e përdorimit të tokës gjatë ndërtimit (nga hyrja në toke deri në daljen nga toka).</p> <p>Për përdoruesin e tokës: Kompensimi për humbjen e kulturave bujqësore sipas normës së projektit për kulturat bujqësore** bazuar në vlerën e plotë të zëvendësimit</p>
4. Toka jetime	I nënshtrohet shqyrtimit rast pas rasti të opinionit prej ekspertit të agronomëve të projektit. Kur aksesi në tokë çon në kthimin e një pjese të parcelës së tokës në një tokë që konsiderohet joekonomike, projekti do ta kompensojë tokën e mbetur që konsiderohet joekonomike sipas parimeve të mësipërme.
5. Kufizimet e servitutit	Toka Urbane (Trualj) Formale: 90% e Normës së Projektit për Blerjen e Tokës bazuar në vlerën e tregut

* Norma e projektit për blerjen e tokës: Vlera e tregut e tokës me përdorim ose potencial të barabartë produktiv që ndodhet në afërsi të tokës së prekur, plus koston e përgatitjes në nivele të ngjashme ose më të mira se ato të tokës së prekur, plus koston e çdo regjistrimi dhe taksat e transfertave.

** Norma e projektit për kompensimin e kulturave bujqësore: Kostoja e zëvendësimit për bimët dhe pemët shumëvjeçare duhet të jetë ekuivalente me çmimet aktuale të tregut duke pasur parasysh llojin, moshën dhe vlerën prodhuese të bimëve dhe/ose pemëve, duke përfshirë produktivitetin e humbur në të ardhmen.

Përveç Matricës së Kompensimit, Projekti ka zhvilluar edhe një Matricë të plotë të Krieteve të Kompensimit, për të pasqyruar gamën e plotë të mbështetjeve të ofruara për familjet e prekura nga projekti, duke përfshirë masat e rikuperimit të jetesës dhe mbështetjen kalimtare për familjet e cënueshme.

Duke marrë parasysh nivelin e ulët të marrjes së përhershme të tokës dhe afatin shumë të shkurtër të aksesit të përkohshëm në tokë gjatë ndërtimit, ndikimi i projektit në mjetet e jetesës pritet të jetë i vogël. Megjithatë, në rastet kur ka ndikim të konsiderueshëm në tokë, apo në rastet kur familja është e cënueshme, mund të kërkohet mbështetje shtesë në mënyrë që të sigurohet kthimi në kohë i aktivitetit bujqësor dhe rikuperimi i produktivitetit të tokës.

Masat e Projektit për rikuperimin e jetesës fokusohen në: restaurimin e tokës, këshilla bujqësore dhe inpute shtesë sipas nevojës; dhe monitorim bujqësor.

Cënueshmëria do të përcaktohet për çdo familje rast pas rasti. Identifikimi i familjeve të cënueshme përcaktohet nëpërmjet angazhimit të palëve të interesit dhe në bazë të analizës së studimeve socio-ekonomike dhe inventarin e pronave. Familjet e cënueshme gjithashtu mund të identifikohen nga Oficeri i Ndërlidhjes me Komunitetin i Projektit (CLO) dhe personeli tjetër i projektit. U krye një Vlerësim fillestar i Riskut të Cënueshmërisë për të identifikuar familjet që mund të përfshiheshin në “listën e cënueshmërisë”. Angazhime të tjera do të ndërmerren me familjet e identifikuara për të konfirmuar / skanuar familjet për mbështetje të mëtejshme, dhe ‘lista e cënueshmërisë’ do të përditësohet sipas nevojës. Identifikimi përfundimtar i familjeve të cënueshme do të kategorizohet në ‘familje kryesisht me aktivitet bujqësor’, dhe familje me aktivitet jo-bujqësor. Familjet me aktivitet kryesisht bujqësor kanë më shumë të ngjarë të përfitojnë nga mbështetja shtesë bujqësore për të rikthyer prodhimin bujqësor, ndërsa familjet me aktivitet jo-bujqësor (p.sh. familjet me pensionistë nuk janë në gjendje të merren me aktivitet bujqësor) mund të përfitojnë nga forma të tjera të individualizuara të mbështetjes si aksesimi/lidhja me asistencën e shëndetësore apo të strehimit. Çdo mbështetje do të individualizohet sipas nevojës së familjes së prekur, dhe do jetë për një kohë të kufizuar, me strategji dalje të qarta.

Kategoria e Ndikimit	Kategoria e PAH	Paketa	Rregullat e kompensimit
Blerja e Përhershme e Tokës	Pronarët e tokave (duke përfshirë edhe ata që kanë një AMTP, por që nuk e kanë të regjistruar tokën zyrtarisht)	Kompensimi për tokën e prekur sipas Normës së Projektit për Blerjen e Tokës Nëse është edhe përdorues i tokës, kompensimi për kulturat bujqësore ekzistuese sipas normës së projektit për kulturat bujqësore. Nëse është edhe përdorues i tokës, pronari ka të drejtën edhe të përfitimit nga programet për mjetet e jetesës	Duhet të ketë qenë pronar deri në datën e ndërprerjes së përfitimit nga këto programe
	Përdoruesit e tokës (nëse nuk janë)	Kompensimi për kulturat bujqësore ekzistuese me tarifat e projektit për kulturat bujqësore Për të përfituar nga Programet e Jetesës	Duhet të jetë përdorues në kohën e

Kategoria e Ndikimit	Kategoria e PAH	Paketa	Rregullat e kompensimit
	pronarë të tokës)		protokolleve të hyrjes në tokë
Marrja e Përkohshme e Tokës	Pronarët e tokave (duke përfshirë edhe ata që kanë një AMTP, por që nuk e kanë të regjistruar tokën zyrtarisht)	Kompensimi për tokën e prekur në shkallën 12.5% të Normës së Projektit për Blerjen e Tokës, e paguar çdo vit Nëse është edhe përdorues i tokës, kompensimi për kulturat bujqësore ekzistuese sipas normës së projektit për kulturat bujqësore. Nëse është edhe përdorues i tokës, pronari ka të drejtën edhe të përfitimit nga programet për mjetet e jetesës	Duhet të ketë qenë pronar deri në datën e ndërprerjes së përfitimit nga këto programe
	Përdoruesit e tokës (nëse nuk janë pronarë të tokës)	Kompensimi për kulturat bujqësore ekzistuese me tarifat e projektit për kulturat bujqësore për të përfituar nga Programet e Jetesës	Duhet të jetë përdorues në kohën e protokolleve të hyrjes në tokë
Aksesi i përkohshëm në tokë	Pronarët e tokave	Kompensimi për tokën në masën 12.5% të Normës së Projektit për Marrjen e Tokës, e shkallëzuar në raport me periudhën e përdorimit të tokës gjatë ndërtimit (nga hyrja në tokë deri në daljen nga toka) Rikthimi i tokës në gjendjen e mëparshme pas ndërtimit Nëse është edhe përdorues i tokës, kompensimi për kulturat bujqësore ekzistuese sipas normës së projektit për kulturat bujqësore. Nëse është edhe përdorues i tokës, pronari ka të drejtën edhe të përfitimit nga programet për mjetet e jetesës	Duhet të ketë qenë pronar deri në datën e ndërprerjes së përfitimit nga këto programe
	Përdoruesit e tokës (nëse nuk janë pronarë të tokës)	Kompensimi për kulturat bujqësore ekzistuese me tarifat e projektit për kulturat bujqësore Për të përfituar nga Programet e Jetesës	Duhet të ketë qenë përdorues në kohën e inventarizimit
Kufizimet e servitutit	Pronarët e tokave	Kompensimi për çdo kufizim të përdorimit me Normën e Projektit për Kufizimin e Servitutit	Duhet të ketë qenë pronar deri në datën e ndërprerjes së përfitimit nga këto programe

Kategoria e Ndikimit	Kategoria e PAH	Paketa	Rregullat e kompensimit
Toka jetime	Pronarët e tokave	Kompensohet me normën e blerjes së tokës të projektit, përveç rasteve kur kufizimet e servitutit ndikojnë në tokën jetime, më pas kompensohen në bazë të vlerave të servitutit të projektit	Toka jetime përcaktohet rast pas rasti

Projekti nuk do të aplikojë servitut mbi tokat bujqësore apo pyjet. Megjithatë, pronarët e tokave të cilët kanë tokë truall (tokë urbane) brenda korridorit 25 m në të dyja anët e linjës OHL në praktike mund të mos jenë në gjendje të ndërtojnë në këto toka në të ardhmen, pavarësisht se nuk do të aplikohet asnjë kufizim ligjor mbi këto toka. Në këto raste, do të paguhet kompensim sipas Normave të Servitutit për Tokën Urbane.

Procesi i hyrjes në tokë dhe blerjes së saj


Bazuar në Kornizën e Kompensimit dhe duke pasur parasysh rregulloret kombëtare të shpronësimit dhe standardet ndërkombëtare dhe praktikatat më të mira, janë ndjekur këto hapa në procesin e aksesit dhe blerjes së tokës në kuadrin e këtij Projekti.

1. Përgatitja e Dosjeve Familjare;
2. Përgatitja & Prezantimi i Ofertave;
3. Procesi i Marrëveshjes Vullnetare me Familjet;
4. Procedurat e shpronësimit;
5. Nënshkrimi nga ana e familjes;
6. Pagesa e Kompensimit;
7. Hyrja në Tokë; dhe
8. Dalja nga Toka & Kthimi te pronari.

Kini parasysh se Voltalia do të mbështesë dhe lehtësojë procesin e blerjes së tokës për Operatorin e Sistemit të Transmetimit (OST). Voltalia do të udhëheqë Procesin e Marrëveshjes Vullnetare. Përveç kësaj, do të mbështetet edhe Procesi i Shpronësimit për t'u siguruar që OST të blejë tokën për Projektin. Voltalia do të drejtojë vlerësimin dhe pagesën e kompensimit për llogari të OST-së, por të gjitha dokumentet e transaksionit për transferimin e pronësisë së tokës do të mbahen nga OST.

Hapat kyç për marrjen e përhershme dhe përkohshme të tokës janë prezantuar në format grafik dhe për to diskutohet më poshtë.

Grafiku më poshtë përfshkruan hapat e Marrjes së Përhershme të Tokës (vendndodhjet e Shtyllave):



Projekti ka bërë përpjekjet më të mira në angazhimin e pronarëve të paidentifikuar apo që nuk ndodhen në zonë si para ashtu edhe gjatë procesit të Marrëveshjeve Vullnetare. Në rast konflikti në identifikimin e pronarëve apo përdoruesve, kryhet një proces verifikimi, dhe çdo shumë kompensimi mbahet në një llogari bankare në pritje të përcaktimit të pronësisë së tokës apo asetëve të tjera (të mbjellat). Me shterimin e procesit të Marrëveshjeve vullnetare (kur kompletohen të gjitha marrëveshjet vullnetare të cilat kanë dokumentacionin e duhur të pronësisë) dhe ka evidencë të mjaftueshme që tregon se familja nuk është në gjendje të sigurojë dokumentacionin e kërkuar në kohë, kalohet në procesin e

shpronësimi për ato familje që kanë refuzuar marrëveshjen vullnetare, që nuk janë identifikuar apo mungojnë, dhe për ato familje të cilat e kanë të pamundur të sigurojnë dokumentacionin e duhur për përmbylljen e marrëveshjeve vullnetare.


Në bazë të eksperiencës së deritanishme me procesin e Marrëveshjeve Vullnetare, ka shumë të ngjarë që pothuajse të gjitha familjet të mos jenë në gjendje të sigurojnë dokumentacion të mjaftueshëm që kërkohet për Marrëveshjen Vullnetare. Voltalia u angazhua me familjet dhe i mbështeti ato në marrjen e dokumentacionit të nevojshëm për marrëveshjet vullnetare, por pas pothuajse dy muajsh asnjë familje nuk arriti të siguronte dokumentacionin e nevojshëm. Si rrjedhojë, do të përdoret procesi i shpronësimit për të gjitha parcelat që preken nga marrja e përhershme e tokës. Projekti do i njoftojë ato familje që janë subjekt i procesit të marrëveshjeve vullnetare por me dokumentacion të pamjaftueshëm të pronësisë, se për to do të ndiqet procesi i shpronësimit. Kjo është kritike për të shmangur vonesa në marrjen e lejeve dhe licencave për ndërtimin e projektit. Megjithatë, në mënyrë që të mos disavantazohen familjet që janë subjekt i procesit të marrëveshjeve vullnetare, Voltalia do të ndërmarrë Marrëveshje Kompensimi me këto familje. Kjo marrëveshje merr përsipër pagesën e shumës së plotë të kompensimit për marrjen e përhershme të tokës, në përputhje me Normat e Projektit.

Çertifikata e Pronësisë do të jetë dokumenti i preferuar për nënshkrimin e marrëveshjeve të kompensimit, dhe projekti do të bëjë përpjekjet më të mira në mbështetjen e familjeve për marrjen e dokumentit para hyrjes në tokë. Megjithatë, në mënyrë që të sigurohet kompensimi para ndikimit real, projekti mund të vendosë që të kërkojë vetëm një AMTP dhe dokumente të tjera mbështetëse që vërtetojnë pronarin e ligjshëm të tokës në momentin e hyrjes në tokë.

Pavarësisht Marrëveshjes së Kompensimit të Projektit, të gjitha familjet do të kenë të drejtë të përfitojnë edhe pagesat e shpronësimit pas përfundimit të procesit të shpronësimit dhe nëse sigurojnë dokumentet e nevojshme të pronësisë. Voltalia do vazhdojë t'i mbështesë familjet ku është e mundur në marrjen e dokumenteve të nevojshme.

Projekti ka bërë ndryshime në projektimin e linjës OHL për të minimizuar aq sa është e mundur, por akoma ka familje që refuzojnë bashkëpunimin. Ato familje që kanë refuzuar të hyjnë në Marrëveshje Vullnetare mund të shfrytëzojnë mundësinë që të hyjnë në Marrëveshje Kompensimi me Projektin. Pas vendimit të shpronësimit nga qeveria, Voltalia do i informojë familjet refuzuese rreth hapave të mëtejshëm dhe do i ri-ftojë ato që të pretendojnë shumën e kompensimit të projektit. Shpronësimi i përkohshëm do të përdoret në rastet kur pronari kundërshton aksesimin e tokës.

Hapat kyç të aksesimit të përkohshëm të tokës (akses i makinerive dhe njerëzve në vendndodhjet e shtyllave, dhe aksesimi i korridorit të OHL për shtrirjen e telave) është i ndryshëm pasi nuk do jetë i nevojshëm sigurimi i dokumentacionit për të pasur të drejtën e kompensimit të të mbjellave sipas normave të Projektit. Kryetari i familjes bujqësore do të nënshkruajë marrëveshjet e kompensimit. Grafiku më poshtë përshkruan hapat e Aksesimit të Përkohshëm të Tokës:



Aksesimi i Përkohshëm i Tokës do të arrihet nëpërmjet një Deklarate Kompensimi si për pronarin ashtu edhe për përdoruesin e tokës, dhe Marrja në Përdorim të Përkohshëm të tokës (“shpronësimi i përkohshëm”) do të përdoret kur të jetë i nevojshëm shpronësimi i përkohshëm i tokës.

Do të përcaktohet një korridor ndërtimi gjatë Hyrjes në Tokë, duke lejuar kështu pagesën e qerasë së tokës dhe kompensimin e të mbjellave përpara ndërtimit. Në rastet kur ka dëme aksidentale apo të paparashikuara të të mbjellave, pagesa do të kryhet pas Daljes nga Toka dhe Dorëzimi.

Si për marrjen e përhershme të tokës ashtu edhe për aksesimin e përkohshëm, do të sigurohet një llogari bankare në mënyrë që pronarët e pidentifikuar apo që mungojnë të kenë mundësi të pretendojnë shumën e kompensimit brenda 5 viteve nga fillimi i ndërtimit. Në rastet kur pronarët prezantohen brenda kësaj periudhe dhe arrihet të verifikohet se ata janë pronarët e ligjshëm të tokës, atëherë do të kryhet pagesa e kompensimit nga kjo llogari bankare.

Së fundmi, marrja e përkohshme e tokës i referohet marrjes së përkohshme me qira të tokës gjatë periudhës së ndërtimit për të paktën një vit. Projekti do të marrë me qira gjatë fazës së ndërtimit dy parcela toke ngjitur me Parkun PV. Projekti do hyjë në një marrëveshje qiraje me pronarin sipas Normave të Projektit.

Plani i Rikuperimit të Jetesës

Duke pasur parasysh llojet e ndikimeve të identifikuar të projektit, ndikimi i projektit tek jetesa pritet të jetë i lehtë, duke pasur parasysh:

- shtrirjen e kufizuar të blerjes së përhershme të tokës
- natyrën e përkohshme dhe shumë të shkurtër të aksesit të përkohshëm në tokë gjatë ndërtimit.

Megjithatë, kur ka një ndikim të rëndësishëm në çdo parcelë ferme të prekur, ose kur familja mund të jetë vulnerabël, mund të kërkohet ndihmë shtesë për të siguruar kthimin në kohë në bujqësi dhe rikuperimin efektiv të produktivitetit. Më tej, Projekti do të përpiqet të marrë masa që aty ku një pjesë e parcelës së fermës është ndikuar nga blerja e përhershme e tokës, parcela e mbetur të rikuperohet në mënyrë që prodhimi të kthehet në nivelet e para projektit.


Për të arritur sa më sipër, masat e projektit për rikuperimin e jetesës fokusohen tek:

1. Rikthimi i parcelës në gjendjen e mëparshme
2. Këshillimi bujqësor dhe inputet shtesë 'sipas nevojës'
3. Monitorimi Bujqësor
4. Ndihma kalimtare për Familjet në nevojë.

Cënueshmëria do të përcaktohet për çdo familje rast pas rasti. Identifikimi i familjeve të cënueshme përcaktohet nëpërmjet angazhimit të palëve të interesit dhe në bazë të analizës së studimeve socio-ekonomike dhe inventarin e pronave. Familjet e cënueshme gjithashtu mund të identifikohen nga Oficeri i Ndërlidhjes me Komitetin i Projektit (CLO) dhe personeli tjetër i projektit. U krye një Vlerësim fillestar i Rrishtit të Cënueshmërisë për të identifikuar familjet që mund të përfshihen në "listën e cënueshmërisë". Angazhime të tjera do të ndërmerren me familjet e identifikuara për të konfirmuar / skanuar familjet për mbështetje të mëtejshme, dhe 'lista e cënueshmërisë' do të përditësohet sipas nevojës. Identifikimi përfundimtar i familjeve të cënueshme do të kategorizohet në 'familje me aktivitet kryesisht bujqësor', dhe familje me aktivitet jo-bujqësor. Familjet me aktivitet kryesisht bujqësor kanë më shumë të ngjarë të përfitojnë nga mbështetja shtesë bujqësore për të rikthyer prodhimin bujqësor, ndërsa familjet me aktivitet jo-bujqësor (p.sh. familjet me pensionistë nuk janë në gjendje të merren me aktivitet bujqësor) mund të përfitojnë nga forma të tjera të individualizuara të mbështetjes si aksesimi/lidhja me asistencën e shëndetësore apo të strehimit. Çdo mbështetje do të individualizohet sipas nevojës së familjes së prekur, dhe do jetë për një kohë të kufizuar, me strategji dalje të qarta.


Menaxhimi i Ankesave

Figura më poshtë paraqet grafikun që tregon se si trajtohen ankesat:



Korniza Organizative

Për të ekzekutuar projektin, ekipi i Voltalia bazohet në ekspertizën e brendshme dhe të jashtme. Kjo lejon menaxhimin efektiv të të gjitha ndikimeve në aspektin social dhe ndikimit në tokë që rrjedhin nga Projekti. Organigrama e Voltalia LRP paraqitet më poshtë.



Kini parasysh se jo i gjithë personeli nevojitet për kohëzgjatjen e LRP-së dhe mundet që me kalimin e kohës punonjësit të kalojnë nga një rol në një tjetër. Për shembull, punonjësit që do të bëjnë inventarin bazë dhe analizën e të dhënave do ta përfundojnë punën përpara procesit të nënshkrimit të marrëveshjeve me familjet dhe disa prej tyre do të formojnë ekipin e marrëveshjeve me familjet, i cili do të garantojë në vazhdimësi edhe një marrëdhënie afatgjatë me familjet. Po kështu, agronomi i përfshirë në inventarin bazë do të drejtojë përpjekjet për rikthimin e tokës në gjendjen e mëparshme dhe për rikuperimin të jetesës në lidhje me parcelat e tokës.

Organigrama e paraqitur në grafikun e mësipërm mund të jetë subjekt i ndryshimeve gjatë implementimit të LRP-së. Gjithashtu, Voltalia mund të vendosë të rekrutojë staf të brendshëm ose të përdorë burime të jashtme për disa pozicione të paraqitura më sipër. Në çdo rast, Voltalia do të sigurojë që të rekrutojë staf të mjaftueshëm dhe kompetent në mënyrë që të garantohen afatet dhe cilësia e zbatimit të LRP-së.

Disa role mund të mbulohen nga i njëjti person. Për shembull, Oficeri i Ndërlidhjes me Komunitetin mund të mbulojë rolin e Menaxherit të Ankesave.

Plani dhe Buxheti

Një përmbledhje e Programit të LRP-së, që tregon datat kryesore, është paraqitur më poshtë. Programi i LRP-së është në përputhje me kalendarin e planifikuar të ndërtimit dhe do të fillojë me kantierin e parkut Fotovoltaik. Të gjitha pagesat e kompensimit do të bëhen përpara hyrjes në tokë.

Komponenti kyç	2021					2022											
	G	S	T	N	D	J	SH	M	P	M	Q	K	G	S	T	N	DH
Plani i Rikuperimit të Jetesës (LRP)																	
Përgatitja e anketave Socio-ekonomike & të Aseteve																	
Studimi i Vlerave të Kompensimit																	
Zhvillimi i Plane të Angazhimit & komunikimit																	
Zhvillimi i planit & regjistrin të ndikimit social të rrugës																	
Surveys implementation & Agronomic Assessment of Parcels																	
Hedhja & Analiza e tëDhënave																	
Rishikimi i kujdesit të duhur për procesin e marrjes së zonës së impiantit																	
Zhvillimi i Kornizës së Kompensimit																	
Zhvillimi i Programeve të jetesës / grupeve vulnerabël																	
Matrica e Detajuar e Kompensimit (për t'u dorëzuar tek autoritetet)																	
Publikimi i LRP / Udhëzuesit të Marrjes së Tokës dhe Kompensimit																	
Zhvillimi i Marrëveshjeve me Familjet / Nënshkrimi i Paketave																	
Marrëveshjet vullnetare me familjet																	
Procedurat e Shpronësimit																	
Pagesat e Kompensimit																	
Punimet fillestare (në zonën e Impiantit)																	
Hyrja në Tokë / Fillimi i Ndërtimit																	
Fillimi i Zbatimit të Programit të Jetesës																	

Vlerësimi i buxhetit të LRP-së paraqitet më poshtë.

Vlerësimi i buxhetit të LRP	
Veprimet	Vlera Euro
Kompensimi për blerjen e përhershme të tokës	87,084.00
Kompensimi për blerjen e përkohshme të tokës	10,000.00
Kulturat vjetore	11,919.74
Kulturat shumëvjeçare	76,680.42
Kompensimi i servitutit	5,000.00

Programi i Jeteses & Vulnerabel	98,640.00
Kontigjenca për punime restauruese përmirësuese	30,000.00
Totali	319,324.16

Procesi i M&E

Proceset e propozuara të monitorimit dhe vlerësimit synojnë të ofrojnë, ndër të tjera, tregues për të gjurmuar vazhdimisht: nivelin e përputhshmërisë me kërkesat ligjore dhe rregullatore; Ndikimet e projektit në familjet dhe komunitetet e prekura drejtpërdrejt; shkallën në të cilën paketa e kompensimit të zhvendosjes dhe ndërhyrjet e tjera janë në rrugën e duhur për të arritur një restaurim të qëndrueshëm dhe përmirësime në mirëqenien e personave të prekur; progresin dhe mbylljen e LRP; dhe shëndetin e marrëdhënieve ndërmjet Projektit dhe palëve të tij të interesuara.

Menaxhimi i ndryshimit

Një version paraprak i LRP u zhvillua në Mars 2022. Ky version i LRP-së (Gusht 2022) reflekton qasjen e rishikuar mbi kompensimin dhe shpronësimin, në mënyrë që të sigurohet akses në kohë i tokës dhe pagesa për pronarët dhe përdoruesit. LRP-ja do të përditësohet si një LRP Përfundimtare pas ndërtimit, kur të njihen të gjitha ndikimet përfundimtare dhe buxhetet dhe të kenë filluar planet e rikuperimit të jetesës.

1 HYRJE

Karavasta Solar sh.p.k, një korporatë shqiptare, propozon ndërtimin e një parku Fotovoltaik 140 MW dhe të një Linje Transmetimi (OHL) në bashkitë Divjakë dhe Fier të Shqipërisë (Projekti).

Zona e parkut do të ndërtohet dhe do të operohet nga Karavasta Solar sh.p.k, ndërsa Linja ajrore e transmetimit do të ndërtohet nga Karavasta Solar sh.pk, por do të jetë në pronësi dhe në operim të OST-së, Ofruesit Shtetëror të Energjisë.

Ky dokument përfaqëson Planin e Rikuperimit të Jetesës (LRP) për Projektin e Karavastasë. Në zhvillimin e LRP-së, Kompania është e angazhuar të respektojë legjislacionin shqiptar, politikat mjedisore dhe sociale të Korporatës Financiare Ndërkombëtare (IFC) dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH), si dhe praktikat më të mira ndërkombëtare.


1.1 Një vështrim i përgjithshëm i projektit

5. Projekti i Energjisë Diellore të Karavastasë (Projekti) përbën një zhvillim të energjisë fotovoltaike të rinovueshme (PV) që ndodhet në rajonin e Divjakës në Shqipëri (shih

Figura 1.1), i cili përfshin komponentët e mëposhtëm:

1. Një park fotovoltaik (PV) me sipërfaqe 185 ha dhe me kapacitet maksimal të instaluar prej 140 MW
2. Një linjë ajrore transmetimi 220 kV rreth 19.2 km e gjatë me 57 kulla që lidhin parkun PV me një nënstacion elektrik ekzistues në Fier.

FIGURA 1.1: VENDNDODHJA E PROJEKTIT PV SOLAR KARAVASTA



1.2 Qëllimi dhe objektivat e LRP-së

Qëllimi i kësaj LRP-je ka të bëjë me zhvendosjen që do të shkaktohet nga blerja dhe aksesimi në tokën që do të shfrytëzohet nga Projekti, dhe ka për qëllim zyrarizimin e planit me anë të të cilit komuniteti dhe familjet e prekura do të identifikohen, do të kompensohen dhe do t'u ofrohen mundësi për t'iu rikthyer jetesës së tyre siç ishte të paktën para zhvillimit të projektit.

Projekti i Karavastasë do të rezultojë në një sërë ndikimesh mbi Familjet që do të ndikohen prej Projektit (PAH). Megjithatë, megjithëse do të ketë zhvendosje ekonomike, nuk do të ketë zhvendosje fizike (d.m.th., asnjë banesë nuk do të ndikohet dhe nuk do të ketë nevojë të lëvizet si rezultat i projektit). Në rastin e projekteve që përfshijnë vetëm zhvendosje ekonomike, Standardi i Performancës 5 i IFC-së për blerjen e tokës dhe për zhvendosjet e pavullnetshme, si dhe Kriteri përkatës 5 i performancës i BERZH-it, kërkojnë që klienti të zhvillojë një plan të rikuperimit të jetesës për të kompensuar personat dhe/ose komunitetet e prekura dhe për të ofruar ndihmë të llojeve të tjera që përmbushin objektivat e Standardeve.

Plani i Rikuperimit të Jetesës duhet të përcaktojë të drejtat e personave dhe/ose të komuniteteve të prekura dhe të marrë masat që ato të sigurohen në mënyrë transparente, të qëndrueshme dhe të barabartë. Zbutja e zhvendosjes ekonomike do të konsiderohet e plotë kur personat ose komunitetet e prekura të kenë marrë kompensim dhe ndihmë të llojeve të tjera sipas kriterëve të Planit të Rikuperimit të Jetesës, ligjit shqiptar dhe standardeve ndërkombëtare dhe kur të gjykohet se u është dhënë mundësia e duhur për rikuperimin e jetesës.

1.3 Struktura e LRP-së

LRP është organizuar sipas seksioneve të mëposhtme:

Seksioni 1: Hyrje	Një pasqyrë e shkurtër e projektit, dhe arsyetimi dhe struktura e kësaj LRP-je
Seksioni 2: Përshkrimi i projektit	Një diskutim i detajuar i elementeve kyçe të projektit dhe ndikimeve të mundshme në lidhje me blerjen e tokës dhe kufizimet e aksesit
Seksioni 3: Kuadri institucional dhe ligjor	Një përshkrim i kuadrit institucional dhe ligjor mbi bazën e të cilit zhvillohet Projekti, duke përfshirë legjisllacionin shqiptar dhe standardet ndërkombëtare
Seksioni 4: Mbledhja dhe analiza e të dhënave bazë	Një përmbledhje e përpjekjeve për mbledhjen e të dhënave bazë dhe një prezantim i analizës së të dhënave që janë përdorur për të identifikuar ndikimet dhe për të informuar zhvillimin e masave zbutëse, pranueshmërinë dhe të drejtat e familjeve.
Seksioni 5: Angazhimi i palëve të interesuara	Një analizë e angazhimit të palëve të interesuara deri më sot, dhe procesi që do të ndiqet për angazhimin e vazhdueshëm dhe të ardhshëm të palëve të interesuara si pjesë e zbatimit të LRP
Seksioni 6: Identifikimi i Ndikimeve të Projektit	Identifikimi i ndikimeve të Projektit në familjet dhe komunitetet që do të preken drejtpërdrejt

Seksioni 7: Korniza e Kompensimit	Identifikimi i grupeve të pranueshme dhe përcaktimi i paketave të kompensimit dhe mjeteve të jetesës, duke përfshirë zhvillimin e Studimit të Vlerave të Kompensimit dhe Matricës së Pranueshmërisë dhe të Drejtave, duke përfshirë çdo masë të kërkuar për rikuperimin e jetesës, ku i kushtohet vëmendje e veçantë familjeve që do të ndikohen.
Seksioni 8: Marrëveshja vullnetare dhe procesi i shpronësimit	Procedura për angazhimin dhe sigurimin e marrëveshjeve vullnetare dhe marrëveshjet e kompensimit me familjet e prekura për kompensimin dhe paketat e rikuperimit të jetesës, në përputhje me procesin e shpronësimit shtetëror dhe pagesën e kompensimit
Seksioni 9: Strategjia e Aksesit dhe Blerjes së Tokës	Hapat kryesorë që duhen ndjekur në proceset e aksesit dhe të blerjes së tokës, duke përfshirë angazhimin me pronarët e tokave në përputhje me legjislacionin shqiptar, duke përfshirë hyrjen, daljen dhe dorëzimin e tokës te pronari.
Seksioni 10: Plani i rikuperimit të mjeteve të jetesës	Përshkrimi i planeve të rikuperimit të jetesës të zhvilluara për të siguruar rikuperimin e jetesës, duke përfshirë masat për familjet e identifikuar si familje që do të preken nga Projekti dhe procesin e zbatimit
Seksioni 11: Mbrojtja e Trashëgimisë Kulturore	Masat e zhvilluara për të siguruar mbrojtjen e trashëgimisë kulturore, duke përfshirë zhvillimin e një Plani të Menaxhimit të Burimeve Kulturore (PMBK)
Seksioni 12: Menaxhimi i ankesave	Qasja ndaj menaxhimit të ankesave, duke përfshirë një pasqyrë të Mekanizmit të Zgjidhjes së Ankesave
Seksioni 13: Korniza organizative	Kuadri organizativ për Projektin, duke përfshirë rolet dhe përgjegjësitë kryesore
Seksioni 14: Buxheti dhe plani	Një përmbledhje e planit dhe buxhetit të lidhur me planifikimin dhe zbatimin e LRP-së
Seksioni 15: Monitorimi dhe Vlerësimi	Qasja ndaj monitorimit dhe vlerësimit, duke përfshirë marrëveshjet për monitorimin e brendshëm dhe të jashtëm.
Seksioni 16: Menaxhimi i ndryshimit	Qasja ndaj rishikimit dhe përditësimit të kësaj LRP-je përmes procesit të zbatimit të projektit.

2 PËRSHKRIMI I PROJEKTIT

2.1 QËLLIMI I PROJEKTIT

Qeveria shqiptare po punon drejt një sektori energjetik të besueshëm dhe më të qëndrueshëm, zhvillimi i të cilit bazohet në shfrytëzimin e të gjitha opsioneve energjetike për të përmbushur kërkesat e Shqipërisë për energji dhe për të krijuar vlerë të shtuar për qytetarët shqiptarë, në përputhje me parimet e përgjegjësisë mjedisore, ekonomike dhe sociale.

Historikisht, prodhimi i energjisë elektrike ka qenë pothuajse ekskluzivisht përmes hidrocentraleve. Në vitin 2017 vendi kishte një kapacitet total të instaluar prej rreth 2100 MW, nga të cilat vetëm 100 MW prodhoheshin nga termocentralet. Në vitin 2017 konsumi vjetor i energjisë elektrike ishte rreth 7.1 TWh me një kërkesë maksimale prej 1.4 GW. Prandaj Shqipëria importon energji elektrike edhe nga vendet fqinje.

Shqipëria ka mesatarisht 360 ditë me diell në vende kyçe, dhe për këtë arsye prodhimi i energjisë nga impiantet fotovoltaike (PV) është një burim i rëndësishëm potencial i energjisë elektrike që do të ndihmojë në përmbushjen e objektivave të Strategjisë Kombëtare të Shqipërisë për Energjinë, dhe në veçanti do të ndihmojë për:

1. Diversifikimin e burimeve të energjisë
2. Zhvillimin e burimeve të brendshme të energjisë primare në mënyrë të qëndrueshme dhe konkurruese
3. Uljen e varësisë së Shqipërisë nga hidrocentralet dhe energjia elektrike e importuar
4. Rritjen e besueshmërisë dhe sigurisë së furnizimit me energji
5. Përmirësimin e efektivitetit të kostos së sistemeve të furnizimit me energji elektrike
6. Arritjen e objektivave për burimet e rinovueshme të energjisë dhe efikasitetin e energjisë
7. Arritjen e Objektivave të Kontributit të Përcaktuar Kombëtar (NDC) për reduktimin e emetimeve të gazeve serë (GHG).

2.2 Përbërësit kryesorë të projektit dhe karakteristikat kryesore

Projekti i Karavastasë përbëhet nga një park fotovoltaik 140 MW (Zona e parkut) dhe Linja ajrore e transmetimit 220 kV.

2.2.1 Parku PV

Toka e disponueshme për Projektin PV përbëhet nga 196 ha tokë shtetërore, me një shtrirje të propozuar të planvendosjes së Parkut PV që zë një sipërfaqe totale prej 185 ha. Pronësia e tokës së parkut PV do t'i kalojë Voltalia Albanie Sh.p.k (Shqipëri).

Projekti është projektuar si një park fotovoltaik horizontal gjurmues me aks 140 MW DC (rrymë direkte) që do të prodhojë 120 MW AC (rrymë alternative) në rrjet. Vetë parku përbëhet nga module diellore, sistemet e gjurmimit të moduleve, inverterët dhe transformatori/nënstacioni përforcues, që lejon lidhjen me OHL-në dhe në fund me rrjetin kombëtar, përmes nënstationit në Fier, afërsisht 20 km në juglindje.

Projekti do të kërkojë gjithashtu ngritjen e një ndërtese për sistemin e pajisjeve të Kontrollit Mbikëqyrës dhe Marrjes së të Dhënave (SCADA) për komandimin, kontrollin dhe mbrojtjen e Projektit. Kjo do të drejtohet nga teknikë të punësuar për kontrollin, funksionimin dhe mirëmbajtjen e Projektit.

Përveç komponentëve kryesorë të mësipërm, Zona e Impiantit do të përfshijë infrastrukturën e mëposhtme:


1. Kabllo (të groposura) në zonën e projektit
2. Sisteme kullimi

3. Masa rrethimi dhe sigurie
4. Rrugica aksesi
5. Objekte për ruajtjen e materialeve.

Gjatë punimeve të hershme dhe fazave të ndërtimit, do të nevojiten dy komplekse të përkohshme ndërtimi, duke përfshirë zyrat e kantierit, magazinimin e materialeve dhe pajisjeve etj., si dhe rrugë të përkohshme për të lehtësuar aksesin në kantierin e Zhvillimit. Kompleksi(et) e përkohshëm ndërtimor do të zënë afërsisht 2 ha secili dhe do të vendosen në kufijtë e kantierit të parkut PV, në parcela toke private. Për qiranë e përkohshme të tokës do të bihet dakord me pronarët e parcelave.

Figura 2.1 tregon gjurmën e zonës së impiantit, e rrethuar me gardh rrethues, ku tregohet edhe vendndodhja e nënstacionit.

FIGURA 2.1: PLANVENDOSJA E IMPIANTIT



Për të hyrë në kantier do të përdoren rrugët ekzistuese. Gjatë fazës së ndërtimit të kantierit, pjesë të gjurmës ekzistuese mund të kërkojnë zgjerim të përkohshëm dhe punime ndërtimi sipas rastit (p.sh., forcim të urës) që komponentët kryesorë të transportohen në kantier. Kjo do të kërkojë akses të përkohshëm në tokë dhe do të ndikojë në parcelat e tokës fqinje. Çdo humbje e përkohshme e aksesit dhe e kulturave bujqësore do të konsiderohet për kompensimin dhe rikuperimin e jetesës sipas zonave të gjurmës së projektit.

Rruga e hyrjes në Zonën e parkut, me zona të identifikuar potenciale për zgjerimin e rrugës / forcimin e urës, tregohet

Figura 2.2 më poshtë.

FIGURA 2.2: RRUGA E HYRJES NË KANTIERIN E PV



2.2.2 Linja ajrore e transmetimit (OHL)

Projekti i Energjisë Diellore të Karavastasë kërkon një linjë ajrore 220 kV (OHL) për të mundësuar transmetimin dhe lidhjen me rrjetin kombëtar. OHL-ja do të jetë afërsisht 19 km e gjatë, me 57 kulla (shih


Figura 2.3). Gjurma e secilës kullë do të jetë 10 m x 10 m, dhe toka e nevojshme për këto do të blihet përgjithmonë. Rrugët e hyrjes në kulla do të jenë të përkohshme gjatë ndërtimit dhe do të rezultojnë në një vlerësim prej 5mx5m tokë të përkohshme për parcelë.

OHL do të kalojë nëpër 725 parcela tokësore dhe do të përbëhet nga një e drejtë kalimi, dhe një rrugëdalje prej 25 m në të dyja anët e vijës qendrore. Aksesit i përkohshëm në tokë do të nevojitet në të djathtë e kalimit gjatë ndërtimit të OHL-së. Nuk parashikohen kufizime servituti në lidhje me të Drejtën e Kalimit.

Kullat për mbështetjen e OHL-së do të jenë prej çeliku të galvanizuar, të tipit grilë, të pajisura me gjashtë krahë kryq (tre në çdo anë, në planimetri vertikale), të përshtatshme për montimin e dy linjave të energjisë trefazore. Pjesa qendrore do të përbëhet nga një kullë çeliku e ndarë në disa boshte, sipas lartësisë së përgjithshme të strukturës.

Gjatë fazës së ndërtimit, do të nevojiten rrugë hyrëse për ndërtimin e shtyllave, si dhe akses i përkohshëm për instalimin e vetë OHL-së. Pas ndërtimit, pronësia e infrastrukturës së OHL-së do të transferohet nga Voltalia Albanie Sh.p.k tek Operatori i Sistemit të Transmetimit (OST).

FIGURA 2.3: RRUGA E LINJËS AJRORE



2.3 Fazat dhe aktivitetet e projektit

Projekti mund të ndahet në katër faza kryesore si më poshtë:

1. Mobilizimi/Para-ndërtimit: duke përfshirë përgatitjen e kantierit dhe mobilizimin e pajisjeve dhe materialeve në kantier
2. Ndërtimi dhe instalimi: duke përfshirë punimet e ndërtimit, punimet elektrike dhe instalimin e pajisjeve
3. Funkzionimi dhe mirëmbajtja: Funkzionimi i impiantit dhe mirëmbajtja rutinë
4. Çmontimi ose Zgjerimi: Çmontimi i pajisjeve dhe objekteve përkatëse dhe restaurimi i zonës, ose zgjatja e jetëgjatësisë përmes rinovimit të komponentëve.

2.3.1 Mobilizimi/Para Ndërtimit

Faza e mobilizimit përfshin transportimin e komponentëve të projektit, pajisjeve dhe materialeve në kantier, si dhe përgatitjen e kantierit që përfshin pastrimin, klasifikimin dhe nivelimin e vendit dhe ngritjen e objekteve në terren duke përfshirë një kompleks të përkohshëm ndërtimi.

Gjatë periudhës së përgatitjes së kantierit, fuqia punëtore e nevojshme për sigurinë e kantierit, punën manuale, punët civile, transportin e mallrave dhe shërbime të tjera të ngjashme me shumë gjasa do të bëhen nga grupi lokal i punës.

2.3.2 Ndërtimi & Instalimi

Faza e ndërtimit të kantierit do të përfshijë shumë aktivitete dhe faza, të tilla si:

1. Ndërtim/përmirësim të rrugëve hyrëse të brendshme dhe të jashtme
2. Nivelim toke
3. Rrethim të zonës së projektit
4. Instalim të njësive të energjisë PV
5. Vendosje të shtyllave për strukturën e montimit
6. Ndërtim të nënstacionit elektrik dhe themeleve
7. Gërmim, hapje kanalesh dhe shtrim kabllorësh
8. Instalim të gropës septike
9. Ndërtim objektësh
10. Ngritje të linjave ajrore të transmetimit HV
11. Testim dhe vënie në punë
12. Pastrim të zonës së projektit

Një pjesë e kantierit do të përdoret si zonë shtrimi ku do të vendosen strehëza, pajisje, objekte sanitare (portative) dhe kontejnerë.

Për të siguruar akses në kantier nga rruga publike e afërt do të duhet të përgatitet një rrugë e shkurtër akses në nivele që do të jenë të pranueshme për transportin e pajisjeve, materialeve dhe njerëzve për të shkuar dhe për të ardhur në zonën e projektit (përfshirë gërmuesit/ngarkuesit/buldozerët, vinçat dhe kamionët e transportit). Nevoja për hapje dhe mbushje gropash në lokacionet e moduleve PV, përgjatë rrugëve dhe në kantieret e nënstacionit/transformatorit, do të dihet vetëm pasi të ketë përfunduar projekti përfundimtar.

Ndërtimi i OHL-së do të ndërmerret sipas këtyre hapave:

1. Puna përgatitore:
 - Vendosja dhe finalizimi i vendndodhjes së kullave dhe gjurmës së OHL-së
 - Mobilizimi i makinerive inxhinierike në gjurmën e OHL-së
 - Ndërtimi i platformave për shtylla dhe shpërndarja e materialeve përgjatë gjurmës së OHL-së
2. Punime ndërtimi:
 - Shenjimi i themeleve, punimet e dheut dhe gërmimet
 - Hapja e themeleve dhe vendosja e pajisjeve të tokëzimit
 - Montimi, instalimi, shtrirja dhe fiksimi i shtyllave
3. Punimet e instalimit:
 - Shtrirja dhe lidhja e telave dhe kabllorëve, ngritja e tyre mbi shtylla, shtrirja dhe fiksimi në shtylla
 - Instalimi i amortizatorëve të dridhjeve, ndarësve në distancë dhe pikave të montimit.

Është parashikuar që gjatë fazës së ndërtimit të punësohen deri në 200 persona për ndërtimin e kantierit dhe të OHL-ve përkatëse. Kjo do të përfshinte rreth 20 inxhinierë me përvojë, 10 ekspertë dhe 150-180 punëtorë vendas të kualifikuar, gjysmë të kualifikuar dhe të pakualifikuar. Numri i punëtorëve në kantier do të rritet me kalimin e kohës derisa të arrihet kulmi i aktivitetit të ndërtimit dhe më pas të

fillojë të zvogëlohet ndërsa ndërtimi i afrohet përfundimit dhe Projekti hyn në fazën e vënies në punë. Nuk planifikohet të ketë asnjë akomodim të punëtorëve në zonën e projektit. Projekti do të synojë të punësojë punëtorë të pakualifikuar dhe të kualifikuar nga komunitetet përreth për ndërtim, aty ku është e mundur, kurse punëtorët që nuk janë të zonës do të vendosen brenda akomodimeve ekzistuese aty pranë. Po hartohet një Plan për Punësimin Lokal dhe Prokurimin.

2.3.3 Operimi & Mirëmbajtja

Për shkak të natyrës pajisjeve të impianteve diellore, nuk pritet që gjatë funksionimit të tyre të ketë emetime dhe sasia e mbetjeve që do të gjenerohen pritet të jetë shumë e kufizuar. Nuk do të operohet asnjë pajisje apo makineri e rëndësishme që gjeneron zhurmë dhe nevoja për ruajtjen e materialeve të rrezikshme në vend është e kufizuar.

Operacionet e përditshme të objektit do të përfshijnë si detyrat e zakonshme të mirëmbajtjes parandaluese dhe korrigjuese në vend, me qëllim që Parku PV të jetë në gjendje optimale pune, duke siguruar një jetëgjatësi të zgjatur të sistemit dhe përmbushje të kriteve të garancisë së prodhuesit (p.sh. pastrimi i moduleve PV). Mirëmbajtja korrigjuese do të ndërmerret sipas nevojës në rast mosfunksionimi, si riparime ose zëvendësim të pajisjeve të dëmtuara ose me defekt.

Pas përfundimit dhe vënies në punë, OHL-ja do t'i dorëzohet Operatorit Shtetëror të Sistemit të Transmetimit (Operatori i Sistemit të Transmetimit, OST) për të menaxhuar funksionimin dhe mirëmbajtjen. Duke marrë parasysh se linja OHL do të jetë nën kontroll të plotë nga OST, Voltalia nuk do e ketë të mundur të kompensojë ndikimet që mund të shkaktohen nga punimet e mirëmbajtjes së OST-së. Megjithatë, nëse personat e prekur duhet të ngrenë ankesa për dëmet në të mbjella të shkaktuara nga aktivitetet e mirëmbajtjes së OHL-së, Voltalia do i inkurajojë personat e prekur që të ngrenë ankesa tek OST. Në rastet kur personat e prekur nuk janë në gjendje të ngrenë ankesa pranë OST, mekanizmi i ankesave i Voltalias do jetë i hapur për këto ankesa dhe Voltalia do të mbështesë personat e prekur për ngritjen e ankesave pranë OST.

Përafërsisht 20 vende pune do të krijohen gjatë fazës së funksionimit, duke përfshirë fuqinë punëtore të kualifikuar dhe gjysmë të kualifikuar (si teknikë elektrikë dhe mekanikë) dhe punë të pakualifikuar (si pastruesit e moduleve dhe personeli i sigurisë). Përafërsisht 10 vende pune do të lidhen me Shërbimet e Shëndetit, Sigurisë dhe Mjedisit (HSES) në fillim të fazës së funksionimit, të cilat do të reduktohen me kalimin e kohës. Përafërsisht 10 vende pune (me kohë të plotë dhe me kohë të pjesëshme) do t'i kushtohen operimit dhe mirëmbajtjes së vazhdueshme.

2.3.4 Ndërprerja ose Zgjatja e aktivitetit

Projekti pritet të ketë një jetëgjatësi ekonomike prej 30 vjetësh dhe infrastruktura e parkut ose do të çaktivizohet ose do të zgjatet dhe do të përmirësohet (nëse merret një licencë e re) pasi të ketë mbaruar jetëgjatësinë e tij ekonomike.

Zgjerimi dhe përmirësimi i Projektit do të konsistonte në zëvendësimin e moduleve të vjetra PV me të reja, duke rritur fuqinë maksimale totale të centralit (një proces i quajtur "rifuqizim") ose duke shtuar fuqinë e centralit duke shtuar elementë të rinj si gjurmues, module PV ose transformatorë.

Nëse Projekti do të ndërpritej, atëherë zona e tij do të kthehet në gjendjen fillestare. Pritet që çmontimi të zgjasë nga 6 deri në 12 muaj dhe për këtë do të përgatitet paraprakisht një plan për çmontimin për të menaxhuar çdo ndikim të përkohshëm që vjen nga punimet e çmontimit.

2.4 Kalendari i ndërtimit të projektit

Ndërtimi i Projektit është planifikuar të fillojë në TM3të vitit 2022 dhe të jetë në funksionim të plotë në TM2 të vitit 2023. Kohëzgjatja e pritshme e periudhës së ndërtimit konsiston në 3 muaj përgatitje të

kantierit dhe 10 muaj ndërtim. Plani përfundimtar i ndërtimit do të specifikohet gjatë fazës së projektimit të detajuar.

TABELA 2.1: ORARI I PROJEKTIT DATAT KRYESORE

Faza e projektit	Kohëzgjatja e parashikuar	Gama e parashikuar e datave
Vendndodhja e parkut PV		
Lejet dhe miratimet	3 muaj	Tetor '20 - Maj '22
Punimet e hershme	2 muaj	Korrik'22 - Gusht '22
Faza e ndërtimit	11 muaj	Korrik '22 - Gusht '23
Testimi dhe vënia në punë	3muaj	Gusht '23 - Tetor '23
Linja e Transmentimit Ajror - OHL		
Lejet dhe miratimet	3 muaj	Gusht '22 - Tetor '22
Faza e ndërtimit	10 muaj	Shtator '22 - Gusht '23
Testimi dhe vënia në punë	2 muaj	Gusht '23 - Tetor '23

2.5 Veprimet për shmangien ose minimizimin e zhvendosjes

Vendndodhja e propozuar e parkut PV është përcaktuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë së Shqipërisë. Kjo ka avantazhin që toka është nën kontrollin e shtetit dhe nuk ka ndikim tek pronarët individualë. Gjithashtu, për shkak të cilësisë së dobët të tokës për bujqësi, në të nuk ka aktivitete bujqësore.

Ka kullotje informale dhe aktivitete sezonale blegtorie që zhvillohen në zonën e projektit, por jo aktivitete bujqësore. Për të minimizuar shqetësimet, do të sigurohet akses i vazhdueshëm për kullotje informale në zonat në afërsi të Parkut. Ndikimet mbi aktivitetet e kullotjes brenda parkut PV janë minimale. Veç kësaj, pas ndërtimit, do të lehtësohet edhe aksesin në vendin e parkut për kullotjen e deleve. Kjo është në përputhje me praktikën standarde, pasi kullotja e deleve përdoret zakonisht në vendet e impianteve PV për të mos lejuar që bari dhe bimët e tjera të pengojnë panelet diellore. Projekti do të angazhohet

me barinj të paraprakisht për të siguruar që aktivitetet e kullotjes të kryhen në mënyrë të sigurt. Prandaj, nuk do të ofrohet kompensim për aktivitetet e kullotjes.

Për shkak të gjendjes së keqe të rrugës në lindje të kufirit të Zonës së parkut, kjo zonë dhe rrethinat e saj përshkohen nga shtigje informale, të përdorura për të hyrë në zonën e bregdetit dhe në lagunë për aktivitete të vogla peshkimi dhe rekreative, dhe për disa aktivitete turistike. Si pjesë e zhvillimit të zonës së projektit, rruga ekzistuese do të rehabilitohet, duke ofruar akses më të mirë në bregdet dhe në lagunë, dhe duke shmangur ndikimet në zona të tjera të kullotave. Gjatë ndërtimit, do të sigurohet akses i vazhdueshëm për banorët ose vizitorët që mund të kenë kaluar më parë përmes Zonës së parkut për të shkuar në bregdet/lagunë.

Në përcaktimin e itinerarit të OHL-së, parimi kryesor i ndjekur ishte shmangia sa më shumë e mundshme e zonave të mëposhtme:


1. Zonat e populluara dhe të banuara
2. Zonat e pyllëzuara
3. Parqet dhe rezervatet natyrore
4. Peizazhe apo vende të veçanta me vlerë arkitektonike dhe historike
5. Zona gjeologjike të paqëndrueshme
6. Tokat bujqësore, veçanërisht ato me vreshta dhe pemëtore.

Rruga e propozuar është përzgjedhur në mënyrë specifike për të shmangur nevojën e çdo zhvendosjeje fizike. Itinerari gjithashtu shmang për aq sa është e mundur parcelat e tokës të mbjella me pemë shumëvjeçare, duke përfshirë pemishte dhe vreshta, si dhe do t'u duhej më shumë kohë për t'u rikuperuar pas çdo ndërprerjeje për shkak të ndërtimeve.

Itinerari është rafinuar disa herë për të reduktuar ndikimin e mundshëm në parcelat e tokës dhe në komunitetet e prekura.

Ndryshimi i parë i itinerarit rezultoi në një përsosje që reduktoi më tej numrin e parcelave të tokës bujqësore të ndikuara nga projekti, siç tregohet Figura 2.4 më poshtë.


FIGURA 2.4: ITINERARI I RISHIKUAR I OHL-SË PËR TË SHMANGUR NUMRIN E PARCELAVE TË NDIKUARA



Përpunime të mëtejshme po përqendrohen në vendndodhjen e shtyllave individuale – aty ku është e mundur, ato vendosen në kufijtë e parcelave të fermave. Kjo do të zvogëlojë ndikimet e blerjes së përhershme të tokës për shtyllat në përdorimin e parcelës së mbetur të fermës, duke përfshirë përdorimin efikas të makinerive bujqësore në parcela. Vendosja e shtyllave në kufi redukton gjithashtu rrezikun e krijimit të 'tokës jetime' (toka e mbetur që bëhet joekonomike si rezultat i infrastrukturës së projektit) sa më shumë që të jetë e mundur.

U bënë rregullime të tjera në gjurmën e përditësuar për të minimizuar ndikimet në parcelat me kultura shumëvjeçare në pjesën e fundit të gjurmës (veçanërisht në ullinj dhe vreshta), si dhe ndikimet në aktivitetet ekonomike të cilat mund të ndikoheshin gjatë periudhës së ndërtimit (p.sh., bizneset pranë rrugës së kalimit – 25 m në të dyja anët e Linjës së Transmetimit). Këto përshtatje konsistojnë në zhvendosjen e kullave, përshtatjen e rrugëve të kalimit (një rrugë kalimi më e ngushtë mund të dakordësohet me OST pas vlerësimit teknik) dhe projektimin e një linje ajrore në vend të kabllave nëntokësore në zonën afër nënstacionit të Fierit, e cila është e mbjellë kryesisht me bimë shumëvjeçare. Linja ajrore do të jetë më pak invazive ndaj tokës, duke rezultuar në prekjën e më pak kulturave bujqësore shumëvjeçare.

Figura 2.5: Itinerari i rishikuar i OHL-së në Nënstacion - duke shmangur numrin e parcelave të ndikuara dhe duke shkuar drejt OHL-së ndryshe nga kabllot nëntokësore



Së fundi, metodologjitë e ndërtimit që do të përdoren do të minimizojnë sa më shumë që të jetë e mundur ndikimin në kulturat bujqësore njëvjeçare dhe shumëvjeçare. Aktivitetet e ndërtimit të OHL-së, duke përfshirë 'vendosjen' e kablove ajrore, do të përfshijnë futjen dhe kalimin nëpër kulturat bujqësore nëpër parcela për një kohë minimale (afërsisht gjysmë dite), ndërsa ndikimet tek kulturat shumëvjeçare dhe tek pemët do të shmangen sa më shumë që të jetë e mundur.

2.6 Përmbledhje e Marrjes së Tokës dhe e Ndikimeve të Projektit

Projekti do të përfshijë marrjen e masave për shmangien dhe minimizimin e zhvendosjeve në fazën e projektimit të detajuar dhe të ndërtimit. Megjithatë, ndikimet kryesore të blerjes së tokës mund të vlerësohen me saktësi në këtë fazë dhe do të merren parasysh në zhvillimin e kësaj LRP-je për të adresuar të gjitha ndikimet.

Ndikimet kryesore të vlerësuara të tokës janë përmbledhur në Tabela 2.2.

TABELA 2.2: ZËNIA DHE NDIKIMET E PARASHIKUARA TË TOKËS NGA PROJEKTI

Faza e Projektit	Komponenti	Marrja e parashikuar e tokës	Parcelat e parashikuar të tokës	Kohëzgjatja	Ndikimet e mundshme
Ndërtimi	Zona e parkut	185 ha	21 parcela toke	Të përhershme	Ndikimet në kullotjen informale dhe në aktivitete të tjera; kufizimet e aksesit
	Kantieret e ndërtimit dhe zonat e shtrimit	4 ha	2 parcela toke	E përkohshme	Ndikimet në kullotjen informale; kufizimet e aksesit
	Rrugët e hyrjes në kantier	Mbeten për t'u përcaktuar	25 parcela toke	E përkohshme	Ndikimet në kullotje informale dhe aktivitete të tjera; kufizimet e aksesit; humbja e kulturave bujqësore
	Shtyllat e OHL	57 shtylla që zënë një sipërfaqe toke prej mesatarisht 10m x 10m	57 parcela toke	Të përhershme	Humbja e tokës; humbja e kulturave bujqësore dhe të ardhurave bujqësore
	Rrugët hyrëse të shtyllave të OHL	57 parcela toke për rrugët hyrëse (përlogaritja e marrjes së përkohshme të tokës 5m x 5m)	57 parcela toke	E përkohshme	Humbja e përkohshme e tokës, humbje e kulturave bujqësore dhe të ardhurave bujqësore; probleme për dheun
	Rrugët e hyrjes dhe Korridori i Ndërtimit të OHL-së	Përafërsisht. 17 ha	725 parcela toke*	E përkohshme	Humbja e kulturave bujqësore dhe të ardhurave bujqësore; problemet për dheun
Operacionet	E drejta e kalimit për tek OHL-ja	25 m rrugë kalimi në secilës anë të OHL-së	725 parcela toke*	Të përhershme (kufizime të pjesshme)	Kufizimet e servitutit në lidhje me përdorimet e lejuara në tokën urbane sa i përket të drejtës së kalimit dhe zonës në të cilën vlen kjo e drejtë kalimi.**

*634 parcela toke të inventarizuara në 21 dhjetor, dhe 32 parcela të reja toke të identifikuara për ndryshimin e gjurmës së OHL-së, dhe 50 parcela të reja toke të prekura nga rrugët e aksesit në OHL

** Projekti nuk do të aplikojë servitut mbi tokat bujqësore apo pyjet. Megjithatë, pronarët e tokave të cilët kanë tokë truall (tokë urbane) brenda korridorit 25 m në të dyja anët e linjës OHL në praktike mund të mos jenë në gjendje të ndërtojnë në këto toka në të ardhmen, pavarësisht se nuk do të aplikohet asnjë kufizim ligjor mbi këto toka. Në këto raste, do të paguhet kompensim sipas Normave të Servitutit për Tokën Urbane.

3 KUADRI INSTITUCIONAL & LIGJOR

Ky seksion përshkruan Kornizën Institucionale dhe Ligjore të Projektit. Kjo përfshin një përshkrim të institucioneve përkatëse dhe skicën e rregulloreve dhe politikave që do të rregullojnë planifikimin dhe zbatimin e projektit.

Praktikat më të mira kërkojnë që të identifikohe të gjitha ligjet e vendit pritës që janë në fuqi për blerjen e tokës. Përveç kësaj, kur legjislacioni kombëtar nuk plotëson kushtet e përcaktuara nga Standardet Ndërkombëtare të zbatueshme për Projektin, përkatësisht Politikën Sociale Mjedisore dhe Kërkesat e Performancës të BERZH-it, si dhe Standardet e Performancës dhe Politika e Qëndrueshme e IFC-së, propozuesi i projektit do të sigurojë që projekti të përmbushë Kërkesat e Performancës. Propozuesi do të identifikojë boshllëqet midis ligjit kombëtar dhe politikës së BERZH/IFC dhe do të propozojë një strategji për të adresuar ato boshllëqe, pa cenuar çështjet e sovranitetit kombëtar.

Prandaj, ky seksion i LRP përshkruan sa vijon:

- Kuadri Institucional Shqiptar
- Kuadri Ligjor Shqiptar
- Standardet dhe Udhëzimet Ndërkombëtare
- Politikën e Korporatës Voltalia
- Analiza Krahasuese e Ligjit Kombëtar dhe Kërkesave të BERZH/IFC.

3.1 Kuadri Institucional i Shqipërisë

Që nga Reforma Administrative Territoriale e vitit 2015, Shqipëria është e ndarë në dymbëdhjetë qarqe administrative, të cilat ndahen më tej në 12 rrethe, të cilat ndahen më tej në 61 bashki, Njësi Administrative dhe fshatra. Ka gjithsej 2980 fshatra ose komunitete në të gjithë vendin, të njohura më parë si lokalitete. Bashkitë janë niveli i parë i qeverisjes vendore, përgjegjëse për nevojat lokale dhe për zbatimin e ligjit.

Gjurma e Projektit mbulon një zonë që ndodhet në qarkun e Fierit brenda një bashkie – Fierit. Preken 5 Njësi Administrative – Libofshë, Qendër, Levan, Topojë, Ndërmenas – dhe 12 fshatra. Projekti i parkut PV do të zhvillohet në Njësitë Administrative Libofshë dhe Remas.

3.2 Kuadri Ligjor Shqiptar

3.2.1 Kushtetuta (Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë)

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë është ligji më i lartë dhe përmban të drejtat dhe liritë personale, politike, ekonomike, sociale dhe kulturore, organizimin e shtetit dhe pavarësinë e organeve shtetërore. Kushtetuta e Shqipërisë është përgjithësisht në përputhje me parimet e mbrojtjes së të drejtave të njeriut siç përmbahen në Deklaratën Universale të të Drejtave të Njeriut. Neni 41 garanton pronën private dhe parashikon shpronësimin e pronave vetëm në dobi të interesit publik dhe me kusht që të ketë një kompensim të drejtë.

3.2.2 Ligjet / Aktet përkatëse

Tabela 3.1 më poshtë përmbledhet legjislacioni kyç lidhur me blerjen dhe zhvendosjen e tokës, i zbatueshëm për LRP-në për Zonën e parkut PV.

TABELA 3.1: LEGJISLACIONI KRYESOR NË LIDHJE ME BLERJEN E TOKËS

Emri në shqip	Emri në anglisht	Komponentët kryesorë
Kodi Civil i Republikës Shqiptarë	Civil Code of the Republic of Albania	Të drejtat ligjore që lidhen me pasuritë e paluajtshme (si pronësia, servitutet dhe të drejtat e uzufuktit, qiraja etj.), duke përfshirë edhe modalitetet e fitimit të të drejtave. Të drejtat në pronë, pavarësisht nga natyra e tyre (pronësia, uzufukti) duhet të regjistrohen në Regjistrin Publik.
	Ligj Nr. 7501, datë 19.07.1991 "Për Tokën"	Toka bujqësore i jepet në pronësi ose përdorim personave vendas pa pagesë. Të gjitha tokat ishin shtetërore gjatë regjimit komunist dhe u rishpërndanë në vitin 1991 nëpërmjet këtij ligji. Ligji rregullon shpërndarjen e tokave shtetërore tek individët privatë. Në AMTP, parcela e tokës i jepet kryetarit të familjes bujqësore, por çdo anëtar i familjes që ishte gjallë në vitin 1991 ka pjesë të barabartë të tokës. Toka u shpërnda në raport me numrin e anëtarëve të familjes. Zakonisht, një familje do të merrte 4000 m ² tokë për person, por kjo varej nga densiteti i popullsisë në secilin rreth apo fshat. Në atë kohë, ngrihej një komision toke brenda Ministrisë së Bujqësisë, si edhe komisione të tokës në komitetet ekzekutive dhe këshillat e rretheve apo fshatrave për shpërndarjen e tokës. Neni 19 përmban edhe disa rregulla për shpronësimin.
Për Kadastrën	Law No. 111/2018 on the Cadaster	Agjencia e re Shtetërore e Kadastrës do të marrë përgjegjësitë e tre autoriteteve aktuale shtetërore: 1) Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, 2) Agjencia e Legalizimit, Urbanizimit dhe Integritimit të Ndërtimeve Informale dhe 3) Agjencia e Inventarizimit dhe Administrimit të Pronave Publike. Ligji i ri parashikon një Kadastër të re dixhitale e cila lehtëson procedurën e marrjes së informacionit të përditësuar në lidhje me pronat e paluajtshme në kohën e duhur.
Për kthimin dhe kompensimin e pronës dhe ndryshimet	Law No. 9235/2004 on the restitution and compensation of property & amendments	Rregullon çështjet e të drejtave pronësore që dalin nga shpronësimi, shtetëzimi ose konfiskimi; dhe procedurat për realizimin e kthimit dhe kompensimit të pronave dhe organeve administrative të ngarkuara për përfundimin e tij

Emri në shqip	Emri në anglisht	Komponentët kryesorë
Shumica e parcelave të vlerësuara kanë nivele të mira fertiliteti dhe një potencial të lartë për prodhim bujqësor. Gjithsej 257 parcela janë raportuar të kenë pjellori të mirë të tokës, pra pothuajse 65% e të gjitha parcelave të anketuara. Për më tepër, 60 parcela u identifikuan si me kushte superiore të pjellorisë (që përfaqësojnë 15% të totalit të parcelave të tokave të anketuara). U vu re se fermerët kujdesen shumë për këto toka, pasi mund të marrin rendimente të larta prej tyre. 26 parcela toke (që përfaqësojnë 6.5% të totalit të parcelave të tokave të anketuara) u konstatua të kenë nivele të moderuara ose mesatare të pjellorisë. Këto parcela zakonisht ndodhen pranë lumit dhe/ose brenda argjinaturave të lumit ose pranë zonës së kripur të Lagunës së Karavastasë. Disa fermerë po shtojnë sasi të konsiderueshme pleh organik në këto parcela, të marra nga kasollet e bagëtive. Këto parcela kanë potencial për përmirësimin e fertilitetit në një kohë të shkurtër.

Vetëm 3 parcela kishin një gjendje të keqe të pjellorisë së tokës bujqësore. Këto parcela ndodhen në afërsi të parkut PV, e cila ka cilësi të dobët dheu, pasi është një zonë e kripur afër Lagunës së Karavastasë. Këto 3 parcela përfaqësojnë vetëm 0.75% të rasteve.

4.3.7.3 Sistemet e kullimit dhe ujitjes në parcelat e tokës të prekura nga projekti

Nga totali i parcelave të vlerësuara të tokës, 84% kishin sistem kullimi. Për ato parcela të tokës që kanë sistem kullimi, vetëm tre sisteme (më pak se 1% e parcelave të tokës të anketuara) janë raportuar të jenë në gjendje të keqe dhe që nuk garantojnë shërbim adekuat për parcelat e tokës. Në këto parcela as bordi i kullimit dhe as fermerët nuk kishin ndërhyrë në pastrimin e kanaleve për të garantuar kullimin adekuat të parcelave.

Megjithatë, ndërsa sistemi i kullimit në parcelat individuale të tokës së prekur nga projekti raportohet të jetë adekuat, vlerësimi agronom vëren se funksionimi i përgjithshëm i sistemit të kullimit të zonës më të gjerë nuk është funksional dhe ka vazhdimisht mosfunksionime.

Nga totali i parcelave të vlerësuara të tokës, 69% kanë një formë të sistemit të ujitjes. Për ato parcela me sistem vaditjeje, në 30 raste (që përfaqësojnë 9.3% të rasteve), kanalet e ujitjes ishin në gjendje të keqe, duke rezultuar në mos vaditjen e parcelave, edhe nëse kishte ujë në afërsi. Megjithatë, 87% e rasteve kanë sistem vaditjeje funksionale, për shkak të punëve të rregullta të mirëmbajtjes nga fermerët, të cilët pastrojnë sistemet e ujitjes gjatë stinëve të shirave. 4% raportuan se kishin sisteme vaditëse funksionale, por jo të mirëmbajtura siç duhet.

4.3.8 Regjistri i Ndikimit Social të Projektit

Ndërsa një LRP ka të bëjë kryesisht me ndikimet në familjet e prekura drejtpërdrejt, një Regjistër i Ndikimit Social të Rrugës ("RSIR") është zhvilluar për të siguruar që të identifikohet dhe të zbutet edhe çdo ndikim përtej gjurmës së projektit (p.sh. humbja e aksesit). Gjatë ndërtimit, humbja e aksesit në zonat përtej gjurmës së projektit mund të ndikojë në zonat bujqësore, në blegtori, në familje, biznese, etj. Në të njëjtën kohë, RSIR ka lejuar identifikimin e çështjeve të mundshme të shëndetit dhe sigurisë së komunitetit të cilat duhet të zbuten si pjesë e planifikimit të ekzekutimit të ndërtimit, si dhe dëmtimet e mundshme të strukturave për shkak të ndikimeve të ndërtimit (p.sh., dridhjet).

Një vlerësim fillestar me bazë dokumentacionin për Zonën e parkut dhe linjën ajrore OHL-në duke përdorur imazhe satelitore identifikoi ndikime të mundshme, të cilat më pas u verifikuan përmes

vërtetimit në terren. Ndikimet e konfirmuara u vlerësuan dhe iu nënshtruan një vlerësimi rreziku, duke identifikuar masat që rekomandohen të merren për zbutjen e risqeve të identikuara për të adresuar dhe menaxhuar ndikimet.

RSIR do të përdoret për të kryerjen e një vlerësimi ndërfunksional dhe për menaxhimin e ndikimeve të rëndësishme sociale në menaxhimin e tokës, çështjeve sociale, mjedisore dhe të trashëgimisë kulturore dhe menaxhimit të ndërtimit. Në regjistër do të mbahen kufizimet e zbatueshme specifike për zonën e projektit dhe masat zbutëse të lidhura me to, të cilat do të zhvillohen më tej për të mbështetur procesin e sigurimit të pajtueshmërisë. Regjistri do të përdoret për të ndihmuar Kontraktorin e Ndërtimit ose EPC (Inxhinieri, Prokurim dhe Ndërtim) në zbatimin e angazhimeve sociale dhe për të shërbyer si mjete për të siguruar mbikëqyrjen e zbatimit.

Regjistri do të jetë një dokument i gjallë gjatë periudhës së ndërtimit, i përditësuar në baza javore, nga Punonjësi përgjegjës për Çështjet Sociale dhe Koordinatorët për Marrëdhënien me Komunitetin (CLO) (përditësimi i informacionit dhe veprimeve sipas nevojës).

4.4 Data e ndërprerjes së të drejtës së kompensimit

Qëllimi i datës së ndërprerjes së të drejtës së kompensimit është që të regjistrohen të gjitha familjet e prekura që përdorin tokën në një moment të caktuar kohor, në mënyrë që të zhvillohen masat zbutëse dhe të parandalohen zhvillimet e mëtejshëm spekulative në pritje të përfitimeve nga ky projekt. Është e detyrueshme që data e ndërprerjes së të drejtës së kompensimit të jetë e mirë-dokumentuar dhe e shpërndarë në të gjithë komunitetin e prekur.

Kërkohet që data e afatit të së drejtës së kompensimit të komunikohet qartë si pjesë e komunikimit të projektit, për të shmangur fluksin dhe për të përcaktuar përshtatshmërinë për çdo masë zbutëse, duke përfshirë programet e jetesës ose prioritetet lokale të punësimit. Personat që zënë toka në zonën e Projektit pas afatit të së drejtës së kompensimit nuk do të kenë të drejtë për ndihmë apo kompensim.

Data e përfundimit të së drejtës për projektin ka përkuar me anketat socio-ekonomike dhe të asetëve. Projekti ka marrë masat që kjo t'u shpjegohet qartë familjeve në kohën e anketës socio-ekonomike me secilën familje. Megjithatë, në përputhje me procesin kombëtar të shpronësimit, çdo kulturë bujqësore e mbjellë në tokë bujqësore deri në fillimin e procesit të shpronësimit do të ketë të drejtën e kompensimit. Gjithashtu, në të vërtetë, kur ndodh hyrja në tokë, kulturat bujqësore ekzistuese në tokë në momentin e hyrjes do të vlerësohen për qëllime kompensimi, duke përfshirë edhe sasinë e kulturave të prekura bujqësore.

4.5 Sondazhe të Mëtejshme

Siç u përmend më lart, informacioni shtesë i kërkuar nga Regjistrat Kadastralë të Fierit dhe Lushnjës mund të rezultojë në identifikimin e pronarëve të tjerë të tokës – kjo mund të përfshijë parcela të identikuara më parë si tokë shtetërore dhe parcela për të cilat nuk ekzistonte më parë asnjë informacion për pronësinë.

Ndryshimet e Projektit të Detajuar kanë rezultuar në identifikimin e pronarëve dhe përdoruesve të rinj.

Gjithashtu, është e mundur që gjatë procedurave të hyrjes në tokë para ndërtimit, mund të ketë persona që mund të paraqiten duke pretenduar pronësinë e tokave ose të drejtat e përdorimit të tyre.

Në të dyja rastet, do të kërkohet informacion mbi anketimin socio-ekonomik të familjeve, veçanërisht për të identifikuar çdo cënueshmëri të mundshme të ekonomive familjare, ndërkohë që të dhënat socio-ekonomike mund të informojnë më tej zhvillimin e programit të kompensimit dhe të jetesës. Në rastin e familjeve që pretendojnë pronësi, këto kërkesa do të hetohen njëkohësisht.

Një pyetësor 'i shpejtë' i anketimit socio-ekonomik do të zhvillohet për të mbledhur këto të dhëna në kohën e hyrjes në tokë.

4.6 Ruajtja dhe analiza e të dhënave bazë

Shkalla e projektit dhe kërkesat informative kërkojnë ruajtjen e sigurt të një sasive të madhe të dhënash në përputhje me kërkesat e mbrojtjes së të dhënave. Të dhënat duhet gjithashtu të analizohen për të zhvilluar programe zbutëse dhe për të përcaktuar dhe për të paguar kompensimin.

Të dhënat do të vendosen në një bazë të dhënash të integruar të projektit (SPSS) që do të zhvillohet për ruajtjen dhe analizën efektive të të gjitha të dhënave bazë. Baza e të dhënave do të përmbajë të gjitha detajet e studimit bazë brenda një sistemi të sigurt, duke lejuar analizën efektive të të dhënave. Të dhënat do të lidhen gjithashtu me një sistem hartash, i cili do të përfshijë të gjitha tokat e Zonës së Projektit. Privatësia e të dhënave do të sigurohet.

Baza e të dhënave do të përdoret për të ndihmuar në analizën e të dhënave të anketës, vlerësimin e aseteve për kompensim, pagesën e kompensimit, regjistrimin, daljen nga toka dhe monitorimin dhe vlerësimin e projektit në të ardhmen.

5 ANGAZHIMI I PALËVE TË INTERESUARA

Ky seksion përshkruan rregulloret kombëtare dhe ndërkombëtare që drejtojnë qasjen për t'u angazhuar me palët e interesuara të projektit në Shqipëri. Ai identifikon grupet kryesore të palëve të interesuara dhe përshkruan metodat e përdorura për t'u konsultuar me ta. Ai gjithashtu përshkruan strategjinë e planifikuar të angazhimit në vazhdim. Ky kapitull i referohet aktiviteteve të angazhimit të palëve të interesuara që lidhen veçanërisht me aksesin në tokë dhe masat e restaurimit të mjeteve të jetesës. Ai duhet të lexohet në lidhje me planin e përgjithshëm të angazhimit të palëve të interesuara të projektit.

5.1 Praktika më e mirë ndërkombëtare

Standardet ndërkombëtare theksojnë rëndësinë e identifikimit të palëve kryesore të interesit dhe sigurimin e planifikimit të angazhimit, konsultimit dhe dhënies së informacionit të projektit në kohën e duhur, relevante dhe të kuptueshme. Informacioni duhet të jetë i aksesueshëm për të gjithë, duke përfshirë çdo segment të popullsisë që mund të konsiderohet i cënueshëm ose i marginalizuar. Ai inkurajon propozuesit e projektit të përdorin metoda të angazhimit që janë të përshtatshme kulturalisht dhe pa manipulime, ndërhyrje, shtrëngime dhe frikësime.

Shqipëria ka ratifikuar disa rregullore në lidhje me aksesin në informacion dhe pjesëmarrjen e komunitetit në vendimmarrje. Niveli dhe natyra e 'pjesëmarrjes' nuk është përcaktuar qartë në legjislacion, por sugjeron që anëtarët e komuniteteve lokale duhet të punojnë në partneritet me autoritetet vendore për të arritur një rezultat optimal në vendimmarrjen lokale dhe zhvillimin e politikave.

5.2 Qëllimi & Objektivat e Angazhimit të Palëve të Interesit

Qëllimi i përgjithshëm i Angazhimit të Palëve të Interesit është të përmirësojë dhe të lehtësojë vendimmarrjen dhe të krijojë një atmosferë mirëkuptimi që përfshin në mënyrë aktive individë, grupe dhe organizata që mund të ndikojnë ose të ndikohen nga zhvillimi i projektit. Ai gjithashtu synon të identifikojë veprimet që Projekti duhet të ndërmarrë për të siguruar që është marrë një qasje në kohë, konsistente, gjithëpërfshirëse, e koordinuar dhe kulturalisht e përshtatshme për konsultimin dhe zbulimin e projektit.

Planifikimi efektiv kërkon konsultime të rregullta me një gamë të gjerë aktorësh të projektit. Konsultimi i hershëm ndihmon në menaxhimin e pritjeve të publikut në lidhje me ndikimet e projektit dhe përfitimet e parashikuara. Konsultimet e mëvonshme ofrojnë mundësi për Propozuesin e Projektit dhe përfaqësuesit e popullsisë të prekura për të negociuar paketat e kompensimit, kërkesat e përshtatshmërisë, ndihmën dhe kohën e aktivitetit.

Objektivat specifike të Angazhimit të Palëve të Interesit janë:

- Të punuarit ngushtë me departamentet kryesore qeveritare, organizatat e tjera, përfaqësuesit e komunitetit dhe komunitetet në një mënyrë të koordinuar për të rritur pjesëmarrjen
- Angazhimi i vazhdueshëm me të gjitha palët e interesuara përmes dhënies së informacionit, konsultimit dhe pjesëmarrjes në monitorimin e aktiviteteve të projektit për të ndërtuar marrëdhënie pozitive, për të minimizuar rreziqet dhe për të maksimizuar mundësitë për zhvillim social. Kjo përfshin komunitetet dhe autoritetet lokale
- Përfshirja e palëve të interesuara në vlerësimin dhe monitorimin e LRP-së së Projektit
- Reagimi në mënyrë efektive dhe efikase ndaj shqetësimeve dhe ankesave të palëve të interesuara bazuar në angazhimin e dyanshëm dhe mekanizmin e ankesave të projektit
- Ofrimi i përditësimeve periodike mbi ndryshimet në zhvillim të dizajnit të projektit dhe zhvillimet dhe çështjet e tjera nëpërmjet mekanizmave të vendosur të komunikimit të përshtatshëm dhe të aksesueshëm për palët e interesuara lokale, kombëtare dhe ndërkombëtare.

5.3 Identifikimi dhe analiza e palëve të interesuara

5.3.1 Identifikimi i grupit të palëve të interesuara

Projekti ka një sërë palësh të interesuara, njerëz, agjenci dhe organizata që mund të ndikohen drejtpërdrejt ose tërthorazi (pozitivisht ose negativisht) nga zhvendosja e projektit ose që mund të ndikojnë në projekt (pozitivisht ose negativisht). Për të zhvilluar një program efektiv të përfshirjes së palëve të interesuara, është e nevojshme të identifikohen grupet e ndryshme të palëve të interesuara, pasi mund të kërkohen metoda të ndryshme komunikimi për grupe të ndryshme. Përveç kësaj, shqetësimet kryesore ka të ngjarë të ndryshojnë midis grupeve të ndryshme të palëve të interesuara.

Tabela 5.1 paraqet një identifikim dhe analizë të palëve të interesuara të palëve kryesore të interesit me rëndësi për LRP.

TABELA 5.1: PALËT KRYESORE TË INTERESIT PËR PROJEKTIN LRP

Palët e interesuara	Interesi dhe roli në projekt	Analiza e palëve të interesuara	
		Ndikimi në projekt	Ndikimi i projektit tek palët e interesuara
Niveli kombëtar			
Ministria e Infrastrukturs dhe Energjisë (MIE)	Ministria mbikëqyr procesin e shpronësimit për interes publik në favor të një subjekti privat kur investimet janë në interes publik, siç është sektori i energjisë. Ministria do t'ia kalojë gjithashtu tokën shtetërore Voltalia-s për qëllimin e zhvillimit të Projektit 140 MW të Karavastasë (parku PV).	E lartë	E lartë
Agjencia Shtetërore e Shpronësimit (ASHSH)	ASHSH është një agjenci kombëtare, nën mbikëqyrjen e MIE, dhe ka kompetencat e mëposhtme në lidhje me procesin e shpronësimit: (i) planifikimin dhe trajtimin e shpronësimeve; (ii) llogaritjen e vlerës së shpronësimit për çdo pronë objekt shpronësimi; (iii) mbikëqyrjen e procesit të shpronësimit; (iv) mbajtjen e bazës së të dhënave të shpronësimit; (v) të drejtën për negociata me subjektet e shpronësimit në lidhje me vlerën e negociatave dhe kushtet e pagesës së shpronësimit	E lartë	E lartë
Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural (MBZHR)	Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural (MBZHR) është përgjegjëse për menaxhimin e burimeve ujore, ujitjen, kullimin dhe mbrojtjen nga përmbytjet. Ministria koordinon prioritetet ndërmjet qëllimeve të ndryshme dhe përdoruesve të ndryshëm të burimeve ujore. Ministria është gjithashtu përgjegjëse për vlerësimin teknik dhe për llogaritjen e aseteve që janë objekt shpronësimi (përfshirë kulturat bujqësore dhe tokat).	E lartë	E lartë

Palët e interesuara	Interesi dhe roli në projekt	Analiza e palëve të interesuara	
		Ndikimi në projekt	Ndikimi i projektit tek palët e interesuara
Ministria e Kulturës	Kjo Ministri siguron mbrojtjen dhe ruajtjen e trashëgimisë kulturore kombëtare. Ajo do të informohet në rast të zbulimeve të rastësishme gjatë aktiviteteve të ndërtimit.	E mesme	E ulët
Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit (AKPT)	Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit (AKPT) është një institucion publik përgjegjës për planifikimin hapësinor dhe urban, hapa kyç në procesin e zhvillimit të projekteve të infrastrukturës, në kuadër të MIE.	E ulët	E ulët
Agjencia Kombëtare e Kompensimit dhe Kthimit të Pronave	Ndryshimi i sistemit politik që përjetoj Shqipëria në fillim të vitit 1991 i hapi rrugën një game të gjerë procesesh privatizimi kombëtare të pronave shtetërore dhe të përbashkëta. Procesi i ri i transformimit kërkonte krijimin e pronësisë private, duke marrë si referencë bazë katër kategoritë kryesore të përdorimit të tokës dhe pronës, si pronat e banimit, fushat bujqësore, ndërtesat dhe tokat industriale ose tokat për shërbime, si dhe pronat që duhet t'u kthehen pronarëve të tyre të dokumentuar ligjërisht para vitit 1945. Nga viti 2006, Agjencia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave (AKKP) është autoriteti përgjegjës për menaxhimin e procesit të kthimit dhe kompensimit në Shqipëri.	E ulët	E mesme
Ministria e Turizmit dhe Mjedisit	Ministria e Turizmit dhe Mjedisit është institucioni përgjegjës për mbrojtjen e mjedisit	E lartë	E lartë
Agjencia Kombëtare e Mjedisit	Është përgjegjëse për monitorimin se si kompania zbaton kërkesat e Deklaratës Mjedisore. Nëse shoqëria nuk i zbaton në mënyrë korrekte, atëherë AKM jep penalitete në bazë të ligjit.	E lartë	E lartë
Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura	AKZM është përgjegjëse për zonën e mbrojtur, për biodiversitetin dhe speciet e rrezikuara	E lartë	E lartë
Nivel rajonal dhe lokal			
Prefektura e Qarkut Fier	Raportimi i shqetësimeve/opinioneve kryesore në Qeveri. Roli në lehtësimin e angazhimit publik	E ulët	E mesme
Këshilli i Qarkut Fier	Raportimi i shqetësimeve/opinioneve kryesore në Qeveri. Roli në lehtësimin e angazhimit publik	E ulët	E mesme

Palët e interesuara	Interesi dhe roli në projekt	Analiza e palëve të interesuara	
		Ndikimi në projekt	Ndikimi i projektit tek palët e interesuara
Drejtoria Rajonale e Mjedisit	Mbikëqyrja dhe zbatimi i procesit të konsultimit publik. Certifikimi i procedurës së konsultimit publik.	E ulët	E ulët
Drejtoria Rajonale e Bujqësisë	Autoriteti përgjegjës për përpunimin dhe zbatimin e programeve të lidhura me bujqësinë dhe përdorimin e tokës	E ulët	E ulët
Agjencia e Zhvillimit Bujqësor dhe Rural	Agjencia shtetërore kombëtare synon të mbështesë sipërmarrësit shqiptarë në sektorin e bujqësisë dhe ushqimit, duke e përgatitur institucionin për të përfituar nga financimi i BE-së dhe donatorëve të tjerë.	E ulët	E ulët
Njësitë Administrative Libofshë dhe Remas, Bashkia Fier	Roli në lehtësimin e angazhimit publik dhe procesit të dëgjimit.	E mesme	E mesme
Kryetar i Bashkisë Fier	Përfaqësues i zgjedhur i komunitetit, që i raporton shqetësimet/mendimet kryesore në Qeveri. Roli në lehtësimin e angazhimit publik dhe procesit të dëgjimit.	E mesme	E mesme
Kryetar i Bashkisë Divjakë	Përfaqësues i zgjedhur i komunitetit, që i raporton shqetësimet/mendimet kryesore në Qeveri. Roli në lehtësimin e angazhimit publik dhe procesit të dëgjimit.	E mesme	E mesme
Komunitetet Lokale dhe PAH			
Familjet e prekura drejtpërdrejt	Ata që humbin tokën përgjithmonë ose përkohësisht, ose humbasin aksesin në tokë ose në kulturat bujqësore ekzistuese dhe në burimet natyrore	E mesme	E lartë
Persona/Grupe Vulnerabël	Grupet vulnerabël mund të preken nga Projekti për shkak të paaftësisë së tyre fizike, pozitës sociale ose ekonomike, arsimit të kufizuar, mungesës së punësimit ose aksesit në tokë. Praktikrat dhe mjetet e duhura të angazhimit do të miratohen për të siguruar	E mesme	E lartë

Palët e interesuara	Interesi dhe roli në projekt	Analiza e palëve të interesuara	
		Ndikimi në projekt	Ndikimi i projektit tek palët e interesuara
	akses adekuat në informacion dhe pjesëmarrje.		
Përdoruesit e tokës që do të blihet	Kullotësit dhe fermerët që përdorin tokën në gjurmën e projektit do të ndikohen nga ndërtimi i Parkut PV dhe rrugëve hyrëse, dhe nga infrastruktura përkatëse	E lartë	E lartë
Tjetër			
OJQ-të	OJQ-të me interes të drejtpërdrejtë në Projekt, dhe aspektet e tij sociale dhe mjedisore dhe që mund të ndikojnë drejtpërdrejt ose përmes opinionit publik mbi Projektin. OJQ-të mund të kenë gjithashtu të dhëna ose njohuri të dobishme për çështjet lokale dhe kombëtare të ngritura nga Projekti. OJQ-të ndërkombëtare përfshijnë organizata me bazë brenda dhe jashtë Shqipërisë me interes për Projektin. Ato përfshijnë OJQ ndërkombëtare, organizata shumëpalëshe dhe dypalëshe.	E mesme	E mesme
Udhëheqësit dhe Grupet Lokale (p.sh. fermerët, shoqatat e grave...)	Organizatat me interes të drejtpërdrejtë në Projekt, dhe në aspektet e tij sociale dhe mjedisore që mund të ndikojnë drejtpërdrejt ose përmes opinionit publik mbi Projektin. Organizata të tilla mund të kenë gjithashtu të dhëna dhe njohuri të dobishme dhe potencialisht mund të bëhen partnere të Projektit në fusha me interes të përbashkët, siç është zbatimi i investimeve komunitare sipas rastit.	E mesme	E lartë
Media	Mediat janë në gjendje të ndikojnë në opinionin publik dhe mund të jenë të dobishme për të shpërndarë informacionin e projektit	E mesme	E mesme

5.3.2 Identifikimi i grave dhe grupeve vulnerabël

Procesi i planifikimit merr në konsideratë situatën e grave dhe të rinjve dhe e përshtat procesin e angazhimit si të nevojshëm për të siguruar që gratë të kenë një rol në vendimmarrje.

Kjo përfshin identifikimin e:

1. Mjeteve të grave për gjenerimin e të ardhurave dhe mjetet e jetesës, duke përfshirë aktivitetet informale të tilla si grumbullimi i burimeve natyrore
2. Rrjeteve sociale dhe ekonomike të grave, duke përfshirë lidhjet e zgjeruara familjare, dhe,
3. Pronësisë së grave mbi tokën dhe kulturat e prekura, për t'i kompensuar ato në mënyrë të përshtatshme.

Statusi i gruas në Shqipëri mbetet disi i marginalizuar. Çështja parësore me të cilën përballen gratë rurale është mungesa e fuqizimit ekonomik, që rezulton nga zakonet tradicionale, dhe qasja e kufizuar në punësim dhe mundësitë e gjenerimit të të ardhurave, mungesa e trajnimit të aftësive dhe një shkëputje e përgjithshme nga zhvillimi ekonomik.

Njohuritë e tyre të thella për çështje të tilla si menaxhimi i tokës, burimet ujore dhe siguria ushqimore i bëjnë gratë kontribuese thelbësore në një proces konsultimi. Ato mund të ofrojnë informacion të vlefshëm për studimet e specializuara dhe shpesh janë në një pozicion të mirë për të identifikuar nevojat dhe prioritetet e komunitetit që mund të mbështeten nga programet e zhvillimit social.

Hapat e mëposhtëm specifikë po ndërmerren për të promovuar pjesëmarrjen e barabartë dhe kuptimplotë të grave:

1. Ngjarjet konsultative si takimet janë të planifikuara për të marrë në konsideratë kërkesat e ndryshme për kohën e grave, si puna e të tjera, kujdesi për fëmijët dhe përgatitja e vakteve ushqimore.
2. Profilët sociale bazë të përpiluara si pjesë e procesit të zhvendosjes ekonomike përfshijnë një analizë të dinamikës gjinore dhe pabarazisë ndërmjet pjesëmarrjes së burrave dhe grave në ekonominë lokale dhe të rrethit/rajonit. Ky informacion përdoret si bazë për planifikim të mëtejshëm për përfshirjen dhe plotësimin e nevojave të pjesëtareve femra të komunitetit
3. Gjatë monitorimit të efekteve të konsultimit të vazhdueshëm me komunitetin, të dhënat mblidhen dhe regjistrohen të ndara sipas gjinisë, në mënyrë që të sigurohet një pasqyrë e ndikimeve të ndryshme të Projektit tek gratë dhe burrat.

5.4 Angazhimi i palëve të interesuara deri më sot

Ky seksion ofron një përmbledhje të aktiviteteve të angazhimit të palëve të interesuara të ndërmarra deri më tani. Pjesëmarrja e komunitetit dhe kontributit në lidhje me projektet e deritanishme është bërë përmes mekanizmave:

5.4.1 Takimet Publike

Në përputhje me legjislacionin kombëtar të VNM-së, u organizua një seancë dëgjimore publike për të prezantuar procesin e VNMS palëve të interesuara. Ftesa me 30 kopje të përmbledhjes joteknike të VNMS-së u vunë në dispozicion të komuniteteve vendore dhe iu dërguan bashkisë Divjakë, Fierit dhe Autoritetit Rajonal të Mjedisit (ARM). E njëjta ftesë me 10 kopje të përmbledhjes joteknike të VNMS-së u është dërguar Njësive Administrative (NJA) Remas, Libofshë, Topojë, Dërmenas dhe Qendër. Postera me informacione për dëgjesat publike dhe detajet e kontaktit u vendosën në fshatrat pranë vendit të parkut PV dhe përgjatë gjurmës së linjës së transmetimit. Gjithashtu, një njoftim u botua në shtypin vendor dhe kombëtar dhe u shpërnda në radio dhe televizion për 20 ditë rresht. Për palët e interesuara që nuk mund të ishin të pranishme në dëgjimin publik, u nda një link për të mundësuar pjesëmarrjen online.

5.4.2 Takimet Konsultative

Takimet konsultative u organizuan si gjatë fazës së fushëveprimit ashtu edhe në fazën VNMS të Projektit për t'u ofruar palëve të interesuara informacion bazë rreth projektit të propozuar dhe për t'u dhënë palëve të interesuara mundësinë për të ngritur çështje dhe/ose shqetësime. Ftesat për palët e interesuara u dërguan me postë dhe me e-mail. Të gjitha letrat e njoftimit iu shpërndanë grupeve të aktorëve kryesorë të identifikuar. Forma të tjera të njoftimeve të përdorura për konsultime përfshinin vendosjen e posterave dhe shpërndarjen e fletëpalosjeve në fshatrat dhe vendbanimet e prekura.

Për draft raportin e fushëveprimit, u organizua një takim konsultimi online për të diskutuar çështjet përkatëse në lidhje me zbulimin e raportit të fushëveprimit dhe gjetjet paraprake. Gjithsej 7 pjesëmarrës duke përfshirë; 1 në nivel kombëtar, 2 në nivel rajonal dhe lokal dhe 4 OJQ. Të gjitha palët e interesuara

të identifikuar në fazën e parë të angazhimit u njoftuan përmes e-mailit për publikimin e raportit të fushëveprimit dhe më pas për konsultimin online pas periudhës 30 ditore të publikimit. Përveç kësaj, postera dhe fletushka u përdorën për të informuar komunitetet lokale. Raporti i fushëveprimit u bë i disponueshëm në faqen e internetit të projektit dhe iu dorëzua zyrtarisht secilës prej NjA-ve të përshkuara nga projekti.

U zhvilluan këto takimet në vend:

1. Në periudhën 21 – 25 Shtator 2020 janë realizuar gjithsej 16 takime me pjesëmarrjen e 53 zyrtarëve me autoritetet kombëtare, rajonale dhe lokale.
2. Në Tetor 2020, angazhimi me komunitetet lokale u krye përmes takimeve “ad-hoc” me më shumë se 30 anëtarë të komunitetit në fshatrat Ndërmenas dhe Hasturkas.
3. Në Shkurt 2021, u krye angazhimi me komunitetet lokale që jetojnë përgjatë gjurmës së linjës së transmetimit (pas konfirmimit të shtrirjes së itinerarit).

5.4.3 Anketa socio-ekonomike VNMS

Një anketë socio-ekonomike u ndërмор gjithashtu për të mbledhur informacionin bazë përkatës socio-ekonomik dhe për t'u angazhuar me palët e interesuara. Ekipi shpërndau fletëpalosje për 364 familje të intervistuar gjatë anketës socio-ekonomike.

Sipas anketës socio-ekonomike, problemet më të mëdha me të cilat përballen familjet që banojnë në zonë lidhen me problemet e papunësisë dhe çështjet ekonomike, si dhe me infrastrukturën dhe shërbimet publike, si aksesimi në ujë dhe pijshëm dhe kanalizime, si dhe ofrimi i dobët i shërbimeve shëndetësore.

5.4.4 Takimet në Kuadër të Publikimit të VNMS-së

Bazuar në kërkesat e Politikave Mjedisore dhe Sociale të IFC-së dhe BERZH në lidhje me publikimin e VNMS-së, një seri takimesh u zhvilluan në zonën e projektit për të informuar publikun në lidhje me ndikimet dhe masat zbutëse të prezantuar në raportin përfundimtar të VNMS-së. Në secilin fshat të prekur u vendosën postera të paktën 2 javë përpara datës së takimit duke njoftuar rreth arsyes së takimit, vendndodhjen dhe ambientin e takimit si edhe datën dhe orën e takimit. Gjithashtu, u vendosën postera në çdo zyrë të Njësive Administrative si edhe në ambientet ku do të zhvillohej takimi.

Të gjithë kryetarët e fshatrave të prekur u takuan gjatë kësaj periudhe dhe u ftuan bashkë me popullsinë vendase që të merrnin pjesë në takim. Gjithashtu, gjatë periudhës 2 javore para takimit, telefonata shtesë u kryen me kryetarët e fshatrave si edhe drejtues të tjerë të komuniteteve, si administratorët e Njësive Administrative, duke i ftuar ata të rifreskonin ftesën për komunitetin lokal për pjesëmarrje në takim.

Takimet u zhvilluan në datat dhe ambientet e mëposhtme:

- Takimi me fshatrat Ndërnënas, Hastukas dhe Karavasta e Re u mbajt në mjediset e Shkollës së Ndërnënasit në datën 22 Qershor 2022 ora 10:00.
- Takimi me fshatrat Seman, Seman i Ri dhe Gjokalli u mbajt në mjediset e Qendrës Komunitare në fshatin Seman më 22 Qershor 2022 ora 14:00.
- Takimi me fshatrat Zhupan, Vadhizë, Çlirim dhe Drizë u mbajt në mjediset e Njësive Administrative Qendër më 23 Qershor 2022 ora 10:00.
- Takimi me fshatrat Sulaj, Dërmenas dhe Radostinë u mbajt në mjediset e Njësive Administrative Dërmenas në 23 Qershor ora 14:00
- Takimi me fshatin Peshtan i Ri u mbajt në qendër të fshatit në 24 Qershor ora 11:00.

Përveç VNMS-së, ekipi i Voltalias gjithashtu prezantoi dokumentet e Ekosistemit, LRP-së GLAC-ut si edhe parimet e tyre kryesore.

5.4.5 Angazhimi i palëve të interesuara në lidhje me LRP

Angazhimi i gjerë i palëve të interesuara u ndërmor si pjesë e aktiviteteve të lidhura me LRP në terren, veçanërisht gjatë zbatimit të anketave bazë dhe zhvillimit të Regjistrit të Ndikimit Social të Rrugës.

Angazhimi i palëve të interesuara në lidhje me LRP-në filloi në shtator 2021 dhe është ende në vazhdim në zonën e gjurmës së projektit, pasi ndryshimi i rrugës së projektit ka kërkuar rilevimin e parcelave shtesë të tokës. Figura 5.1 paraqet një përmbledhje të angazhimit në vend të kryer deri më sot:

FIGURA 5.1: ANGAZHIMI I PËRGJITHSHËM NË VEND DERI MË SOT*



Burimi: SRA, 2022

Angazhimi i palëve të interesuara në lidhje me LRP-në përbëhet nga disa angazhime me familjet e prekura nga Projekti, të prekura drejtpërdrejt dhe tërthorazi nga Projekti i Karavastasë:

1. Regjistri i Ndikimit Social të Projektit përfshin angazhimin e palëve të interesuara me familjet në rrethinat ngjitur me kantierin e centralit PV dhe OHL-së që mund të ndikohen potencialisht nga Projekti i Karavastasë (p.sh., kufizime të mundshme të shkurtra të përkohshme të aksesit në tokë gjatë ndërtimit)
2. Inventarizimi Bazë i LRP-së u angazhua me Familjet e Ndikuara nga Projekti, parcelat e tokës së cilave do të ndikohen drejtpërdrejt nga Projekti (blerja e përhershme e tokës dhe ndërprerja e proceseve të ndryshme të tokës) të udhëhequra nga Planet specifike të Komunikimit.

Për më tepër, angazhimi i palëve të interesuara në lidhje me LRP përfshin vendosjen e posterave informues në fshatrat afër gjurmës së Projektit, shpërndarjen e formularëve të Mekanizmit të Adresimit të Ankesave dhe angazhimin me punonjësit e Njësisë Administrative, kryepleqtë e fshatrave, fqinjët dhe grupet dhe banorët e tjerë (p.sh. të moshuarit).

Këto aktivitete përshkruhen më tej në nënseksionet më poshtë.

5.4.5.1 Planet e komunikimit

Planet e komunikimit u zhvilluan për të udhëhequr aktivitetet kyçe të angazhimit të jashtëm, të tilla si ekzekutimi i anketave bazë. Për anketat bazë, u zhvilluan planet e mëposhtme të komunikimit:

1. Një Plan i Përgjithshëm i Komunikimit për të udhëhequr angazhimin në lidhje me anketat bazë, i cili përfshinte mesazhe kyçe mbi përmbledhjen e projektit, hartimin, procesin, ndikimet, marrëveshjet vullnetare/procedurat e shpronësimit, ndikimet përkatëse dhe rëndësinë e anketave bazë. Plani i Komunikimit përfshinte udhëzime për angazhimin me palët e

interesuara, të cilat u ndoqën nga ekipet e anketimit gjatë kryerjes së anketave socio-ekonomike dhe të aseteve.

2. Planet Shtesë të Komunikimit që synojnë PAH që refuzon të kryejë anketën socio-ekonomike. Në rastet kur PAH refuzojnë ta kryejnë anketën socio-ekonomike, Planet shtesë të Komunikimit përfshinin mesazhe kyçe shtesë mbi procesin e projektit, rëndësinë e anketave bazë dhe marrëveshjeve vullnetare, si dhe përgjigjet për Pyetjet e Bëra të Shpeshta (FAQ) të identifikuar deri më sot.

5.4.5.2 Angazhimi në lidhje me anketat bazë

Angazhimi si pjesë e anketave bazë të lidhura me LRP-në u krye duke filluar në Tetor 2021 dhe po vazhdon për anketimin e parcelave të reja të identifikuar në bazë të ndryshimeve të projektimit/gjurmës. Takimet me PAH për të mbledhur të dhëna socio-ekonomike fillojnë me një prezantim të projektit, procesin dhe qëllimin e anketës, dhe përfshijnë diskutime për të mbledhur informacionin bazë të të dhënave për të informuar LRP-në. Familjet kanë gjithashtu një mundësi për të bërë pyetje rreth Projektit dhe ekipet e anketimit udhëhiqen nga FAQ. Kur PAH-të refuzojnë të kryejnë anketat socio-ekonomike, ato ri-kontaktohen në fazat e mëvonshme nga personeli i lartë, duke ndjekur një plan specifik komunikimi (5.4.5.1 Planet e komunikimit).

Gjithashtu, në mënyrë periodike është ndërmarrë angazhimi me punonjësit e Njesisë Administrative, kryepletqë, fqinjët dhe grupet e tjera (p.sh. të moshuarit). Këto angazhime janë kritike në rritjen e ndërgjegjësimit të përgjithshëm për Projektin dhe në verifikimin e informacionit të pronësisë për disa nga parcelat e prekura nga Projekti. Në këto angazhime, jepen informacione të përditësuara për hartimin, procesin, orarin dhe ndikimet e projektit.

5.4.5.3 Postera informuese për projektin

Në tetor 2021 u vendosën postera në fshatrat kryesore ku u kryen anketat socio-ekonomike: Adriatik, Çlirim, Ndërmenas, Radostinë, Drize, Peshtan i Vogël, Seman, Seman i Ri, Sulaj, Vadizë dhe Zhupan. Posterat ofrojnë një përshkrim të shkurtër të Projektit dhe një linjë direkte telefonike dhe e-mail për të kontaktuar drejtpërdrejt Projektin në rast pyetjesh, komentesh dhe ankesash. Figura 5.2 tregon posterin e vendosur në projektin e fshatrave në afërsi të zonës së projektit

FIGURA 5.2: POSTERI I VOLTALIA-S I VENDOSUR NË PROJEKTIN E FSHATRAVE PRANË

Burimi: Voltalia, 2021

5.4.5.4 Ndërgjegjësimi për Mekanizmin e Ankesave

Fillimi i anketave bazë të LRP-së në Tetor 2021 përkoi me Ndërgjegjësimin për Mekanizmin e Ankesave. Mjetet me të cilat informacioni i lidhur me Mekanizmin e Ankesave u vihej në dispozicion të të gjitha palëve të interesuara dhe të prekura për të bërë një ankesë, shqetësim, sugjerim ose pyetje ishte e trefishtë:

1. Postera me një numër kontakti dhe një adresë e-maili për të kontaktuar Projektin (shih seksionin 5.4.5.3 Postera informuese për projektin)
2. Dorëzimi i një formulari të Mekanizmit të Ankesës për të gjithë PAH-të të cilëve iu kërkua t'i përgjigjeshin pyetësorit socio-ekonomik dhe të gjitha palëve të tjera të interesuara
3. Prezantimi dhe shpjegimi verbal i procesit, dhe dhënia e numrit të kontaktit dhe adresës së e-mailit ku mund të kontaktohet projekti, jo vetëm për PAH të anketuar, por edhe për kryetarët e fshatit, fqinjët dhe banorët e tjerë (p.sh. pleqtë).

Deri më sot, Voltalia është kontaktuar nga 4 AP përmes Mekanizmit të Ankesave, kryesisht për të kërkuar më shumë informacion rreth Projektit dhe, në një rast, për të informuar Projektin se një familje ishte pronare e një prej parcelave të prekura dhe dëshironte të kryente anketat socio-ekonomike dhe të aseteve. Përveç kësaj, zgjidhja e ankesave të lidhura me LRP-në ndërmerret nga ekipet e studimit bazë në terren sipas nevojës.

5.4.5.5 Regjistri i Ndikimit Social të Projektit

Siç përkthehet në seksion 4.3.8 nga totali i parcelave të vlerësuara të tokës, 84% kishin sistem kullimi. Për ato parcela të tokës që kanë sistem kullimi, vetëm tre sisteme (më pak se 1% e parcelave të tokës të anketuara) janë raportuar të jenë në gjendje të keqe dhe që nuk garantojnë shërbim adekuat për parcelat e tokës. Në këto parcela as bordi i kullimit dhe as fermerët nuk kishin ndërhyrë në pastrimin e kanaleve për të garantuar kullimin adekuat të parcelave.

Megjithatë, megjithëse sistemi i kullimit në parcelat individuale të tokës të prekura nga projekti raportohet të jetë adekuat, vlerësimi agronom vëren se funksionimi i përgjithshëm i sistemit të kullimit të zonës më të gjerë nuk është funksional dhe ka vazhdimisht probleme.

Nga totali i parcelave të vlerësuara të tokës, 69% kanë një formë të sistemit të ujitjes. Për ato parcela me sistem vaditjeje, në 30 raste (që përfaqësojnë 9.3% të rasteve), kanalet e ujitjes ishin në gjendje të keqe, duke rezultuar në mos vaditjen e parcelave, edhe nëse kishte ujë në afërsi. Megjithatë, 87% e rasteve kanë sistem vaditjeje funksionale, për shkak të punëve të rregullta të mirëmbajtjes nga fermerët, të cilët pastrojnë sistemet e ujitjes gjatë stinëve të shirave. 4% raportuan se kishin sisteme vaditëse funksionale, por jo të mirëmbajtura siç duhet.

Regjistri i Ndikimit Social të Rrugës (RSIR) u zhvillua për të siguruar që çdo ndikim përtej gjurmës së projektit (p.sh. humbja e aksesit) të identifikohet dhe të zbutet. RSIR përfshinte një vlerësim fillestar të bazuar në dokumentacion të Zonës së parkut dhe OHL-së duke përdorur imazhe satelitore, e ndjekur nga verifikimi përmes vërtetimit në terren. Aktivitetet e verifikimit në terren u kombinuan me angazhimet fillestare me PAH-të afër gjurmës së projektit për ndikimet e mundshme.

Figura 5.3 tregon aktivitetet lidhur me angazhimin e palëve të interesuara të kryera në terren gjatë verifikimit në terren të RSIR.

FIGURA 5.3: ANGAZHIMI I PALËVE TË INTERESUARA ME FAMILJET E PREKURA NGA PROJEKTI GJATË VËRTETIMIT NË TERREN TË RSIR



Burimi: SRA, 2021

5.5 Aktivitetet e ardhshme për angazhimin e palëve të interesuara

Angazhimi i palëve të interesuara për të gjitha çështjet që lidhen me zhvendosjen do të vazhdojë të ndodhë përmes një sërë procesesh dhe aktiviteteve, siç diskutohet më poshtë.

5.5.1 Informimi dhe/ose takime me palët kryesore të interesuara

1. Informacioni dhe/ose informimet mbi Projektin do t'u ofrohen rregullisht sa vijon:
2. Ministrive/Agjencive Kombëtare:
 - Operatori i Sistemit të Transmetimit (OST)
 - Agjencia Shtetërore e Shpronësimit (ASHSH)
 - Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë
 - Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural
 - Ministria e Kulturës
 - Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit
 - Agjencia Kombëtare e Kompensimit dhe Kthimit të Pronave
 - Agjencia Kombëtare e Mjedisit
 - Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura.
3. OJQ ndërkombëtare, kombëtare dhe lokale mjedisore dhe të të drejtave të njeriut
4. Media ndërkombëtare, kombëtare, rajonale dhe lokale
5. Institucionet, Zyrtarët dhe Agjencitë Rajonale dhe Lokale

- Prefektura e Qarkut Fier
- Këshilli i Qarkut Fier
- Drejtoria Rajonale e Bujqësisë
- Drejtoria Rajonale e Mjedisit
- Agjencia e Zhvillimit Bujqësor dhe Rural
- Njësia Administrative Fier
- Njësia Administrative Libofshe
- Kryetar i Bashkisë Fier
- Kryetar i Bashkisë Divjakë

6. Udhëheqësit dhe Grupet Lokale.

Informacionet fillestare mund të sigurohen përmes takimeve formale me palët e interesuara në të gjitha nivelet. Më pas, informimet e rregullta do të vazhdojnë nëpërmjet takimeve të rregullta, ose përmes korrespondencës me shkrim, sipas preferencës ose të përshtatshme për secilin grup të palëve të interesuara.

Kjo qasje siguron që palët kryesore të interesit të qeverisë të ndihen të informuar dhe të përfshirë në zhvillimin e projektit, dhe më të prirur drejt një bashkëpunimi më të ngushtë. Do të vihen në dispozicion gjithashtu kopje të konferencave zyrtare.

I gjithë informacioni dhe/ose informimet për palët kryesore të interesuara do të bëhen duke ndjekur dispozitat e kufizimeve të COVID-19, në përputhje me seksionin 4.2.1 të Planit të Angazhimit të Palëve të Interesit (PSA) i zhvilluar si pjesë e procesit të VNMS.

5.5.2 Planet e komunikimit

Planet e komunikimit për të udhëhequr aktivitetet kyçe të angazhimit të jashtëm do të vazhdojnë të zhvillohen siç kërkohet, në lidhje me momentet kryesore të Projektit, të tilla si publikimi i LRP-së dhe Udhëzuesi për blerjen dhe kompensimin e tokës (GLAC), procesi i Marrëveshjes Vullnetare, Shpronësimit, Marrëveshjeve të Kompensimit të Projektit, dhe Hyrja në tokë dhe ndërtimi. Planet e komunikimit mund të zhvillohen gjithashtu për të ndërmarrë angazhime specifike me një grup të caktuar të palëve të interesuara për çështje specifike sipas nevojës.

Ekipi i Koordinatorëve për Marrëdhëniet me Komunitetin i Voltalia-s do të udhëheqë zhvillimin dhe zbatimin e Planeve të Komunikimit, të mbështetur nga Menaxhimi i Voltalia-s sipas nevojës.

5.5.3 Udhëzues për blerjen dhe kompensimin e tokës

Një GLAC është përgatitur për të shpjeguar qasjen e projektit për aksesin dhe blerjen e tokës, dhe qasjen ndaj kompensimit. Ai është zhvilluar në një mënyrë për ta bërë procesin e aksesit dhe blerjes së tokës të kuptueshëm dhe të aksesueshëm për të gjithë palët e interesuara, veçanërisht familjet e prekura. Kjo do të përfshijë, ndër aspekte të tjera, sa vijon:

1. Informacioni i projektit dhe arsyetimi për zbatimin
2. Ndikimet e projektit
3. Hapat kyç dhe koha për procesin e kompensimit
4. Parimet e kompensimit për përdoruesit e tokës
5. Metodologjitë e vlerësimit dhe kompensimi për llojin e përdorimit të tokës
6. Përgjigjet për pyetjet e bëra më shpesh (FAQ)
7. Pasqyrë e mekanizmave të ankesave.

Përveç vizitave fillestare në familje me qëllim publikimin dhe shpjegimin e GLAC, do të kryhen vizita shtesë tek të gjitha familjet e prekura drejtpërdrejt nga projekti për t'iu shpjeguar ndryshimet dhe

përmirësimet në procesin e kompensimit, të zhvilluara për shkak të pamundësisë së familjeve për të siguruar dokumentacionin e pronësisë (sic diskutohet në Seksionin 9 më poshtë).

5.5.4 Plani i Rikuperimit të Jetesës

Plani Paraprak i Rikuperimit të Jetesës u publikua gjerësisht paralelisht me publikimin e VNMS-së. Si pjesë e zhvillimit të LRP-së, parashikohen tri faza kyçe, duke përfshirë zhvillimin e LRP-ve Paraprake, të Ndërmjetme dhe Përfundimtare. Nxitja për zhvillimin e këtyre dokumenteve, niveli i detajimit, si edhe shtrirja e gjerë në kohë diskutohen në Seksionin 15. Si e tillë, LRP-ja është një 'dokument i gjallë' i cili përditësohet me kalimin e kohës, dhe nuk është thjesht një dokumentacion që shërben si bazë për miratime të vendimeve nga ekipi menaxhues apo palët e jashtme.

Projekti do të zhvillojë masat e duhura për rikuperimin e jetesës, këshillim dhe monitorim për të siguruar rikuperimin e jetesës në kohën sa më të shpejtë të mundshme. Pas ndërtimit, zbatimi i Planit të Rikuperimit të Jetesës do të jetë një mekanizëm kyç për angazhimin e vazhdueshëm me familjet e prekura.

5.6 Kalendari i Angazhimit të Palëve të Interesit

Kalendari i Angazhimit të Palëve të Interesit që mbulon periudhën e zhvillimit të LRP-së, marrëveshjeve vullnetare dhe shpronësimit, dhe ndërtimit të projektit, është paraqitur më poshtë, duke përfshirë metodologjitë dhe forumet që do të përdoren. Ky kalendar do të rishikohet periodikisht për efektivitetin dhe do të përshtatet sipas nevojave të projektit dhe fazave të zhvillimit.

TABELA 5.2: KALENDARI I ANGAZHIMIT TË PALËVE TË INTERESIT

Metodologjia dhe Grupi i Palëve të Interesit	Formati	Frekuenca
Konsultime		
Takim informues për OST (përfshirë prezantimin e matricës së kompensimit, GLAC, LRP, etj.)	Takime sistematike dhe korrespondencë me shkrim	Gjatë projektimit – takime “ad-hoc” Gjatë ndërtimit – sipas nevojës; Gjatë fazës së operimit – sipas nevojës
Agjencia Shtetërore e Shpronësimit (ASHSH) (duke përfshirë edhe paraqitjen e matricës së kompensimit)	Korrespondencë me shkrim sipas nevojës	Sipas nevojës
Informim për Ministritë/Agjencitë: <ul style="list-style-type: none"> Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural Ministria e Kulturës Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit Agjencia Kombëtare e Kompensimit dhe Kthimit të Pronave 	Takimi zyrtar i pasuar nga korrespondenca me shkrim	Çdo tremujor
Informim për Institucionet, Zyrtarët dhe Agjencitë Rajonale dhe Lokale:	Takimi zyrtar i pasuar nga	Çdo tremujor

Metodologjia dhe Grupi i Palëve të Interesit	Formati	Frekuenca
<ul style="list-style-type: none"> • Prefektura e Qarkut Fier • Këshilli i Qarkut Fier • Drejtoria Rajonale e Bujqësisë • Drejtoria Rajonale e Mjedisit • Agjencia e Zhvillimit Bujqësor dhe Rural • Njësia Administrative Fier • Njësia Administrative Libofshe • Kryetar i Bashkisë Fier • Kryetar i Bashkisë Divjakë 	korrespondenca me shkrim	
Takim informues për mediat rajonale	Takimi zyrtar i pasuar nga korrespondenca me shkrim	Çdo tremujor
Fokus grupe me grupe të individëve të interesit duke përfshirë Grupet e Shoqërisë Civile (OJQ), Biznesin, Grupet e Grave	Takimi zyrtar i pasuar nga korrespondenca me shkrim	Çdo tremujor
Shpërndarja e Informacionit dhe Zgjidhja e Ankesave		
Bërja e ditur e GLAC për Departamentet dhe Agjencitë Rajonale dhe Komunale	Takime formale	Prill 2022
Prezantimi i GLAC për PAH	Vizita në familje	Maj - Qershor 2022
Angazhimi me PAH që kanë një ankesë në projekt nëse është e nevojshme	Takime “ad-hoc”	“Ad-hoc”
Angazhim me PAH, toka e të cilëve nevojitet për studime gjeologjike bazë në terren	Takime “ad-hoc”	“Ad-hoc”
Marrëveshjet Vullnetare Familjare, Marrëveshjet e Kompensimit të Projektit, & Nënshkrimi		
Takimi ballë për ballë me PAH (kryefamiljarët dhe bashkëshortet) për t'u paraqitur Ofertën e Kompensimit	Vizitë në familje	Një vizitë e vetme
Vizita të mëtejshme në PAH (me kryefamiljarët dhe me bashkëshortet e tyre) për nënshkrimin e marrëveshjes vullnetare ose Marrëveshjes së Kompensimit të Projektit. Angazhim i zgjeruar për PAH vulnerabël që janë identifikuar	Vizita në familje (2-4 takime, sipas nevojës)	Dyjavore dhe javore (një herë të vetme)
Hyrja në Tokë dhe Dalja prej saj		

Metodologjia dhe Grupi i Palëve të Interesit	Formati	Frekuenca
Angazhimi i menaxherit të ndërtimit dhe CLO me PAH për të nënshkruar Protokollet e hyrjes në Tokë	Vizitë në familje	Gjatë ndërtimit sipas nevojës
Angazhimi i Menaxherit të ndërtimit, Agronomit dhe CLO-së me PAH për të nënshkruar Formularin e Rikthimit të Tokës në Gjendjen e Mëparshme dhe Daljes nga Toka	Vizitë në familje	Gjatë ndërtimit / pas ndërtimit sipas nevojës
Shpërndarja e Informacionit dhe Zgjidhja e Ankesave		
Tabela informacioni në çdo fshat në lidhje me: punësimin, trajnimin, çështjet e sigurisë dhe kalendarin e ndërtimit	Tabela e shpalljeve publike	Sipas nevojës
Vizitat e planifikuara nga Koordinatorët për Marrëdhëniet me Komunitetin (CLO) në çdo fshat	Takimi fillestar dhe vizitat nga CLO(të) në çdo fshat	Çdo javë ose sipas nevojës
Programet për mjetet e jetesës dhe për personat vulnerabël		
Programet e Jetesës dhe Vulnerabilitetit: informacion mbi përshtatshmërinë, llojet e programeve dhe kalendarit	Vizita në familje si pjesë e procesit të nënshkrimit të marrëveshjes	Sipas nevojës

6 IDENTIFIKIMI I NDIKIMEVE TË PROJEKTIT

6.1 Përpjekjet për të shmangur ose minimizuar ndikimet e projektit

Siç përmendet në këtë seksion, një sërë masash janë marrë deri më sot për të shmangur ose minimizuar ndikimet e projektit.

Vendndodhja e propozuar e Parkut të PV është përcaktuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë së Shqipërisë. Kjo ka avantazhin që toka është nën kontrollin e shtetit dhe nuk ka ndikim tek pronarët individualë të tokave.

Ka kullotje informale dhe aktivitete sezonale blegtorie që zhvillohen në zonën e projektit, por jo aktivitete bujqësore. Për të minimizuar shqetësimet, do të sigurohet akses i vazhdueshëm për kullotje informale në zonat në afërsi të Parkut. Pas ndërtimit, do të lehtësohet edhe akses i vazhdueshëm në vendin e parkut për kullotjen e deleve. Kjo është në përputhje me praktikën standarde, pasi kullotja e deleve përdoret zakonisht në vendet e parkut PV për të mos lejuar që bari dhe bimët e tjera të pengojnë panelet diellore. Projekti do të angazhohet me barinj të paraprakisht për të siguruar që aktivitetet e kullotjeve të kryhen në mënyrë të sigurt.

Për shkak të gjendjes së keqe të rrugës në lindje të kufirit të Zonës së Parkut, zona dhe rrethinat e saj përshkohen nga shtigje informale, të cilat përdoren për të hyrë në zonën e bregdetit dhe në lagunë për aktivitete të vogla peshkimi dhe rekreative. Si pjesë e zhvillimit të zonës së projektit, rruga ekzistuese do të rehabilitohet, duke ofruar akses më të mirë në bregdet dhe në lagunë, dhe duke shmangur ndikimet në zona të tjera të kullotave. Gjatë ndërtimit, do të sigurohet akses i vazhdueshëm për banorët ose vizitorët që mund të kenë kaluar më parë përmes Zonës së parkut për të shkuar në bregdet/lagunë.

Në përcaktimin e itinerarit të OHL-së, parimi kryesor i ndjekur ishte shmangia sa më shumë e mundshme e zonave të mëposhtme:

1. Zonat e populluara dhe të banuara
2. Zonat e pyllëzuara
3. Parqet dhe rezervatet natyrore
4. Peizazhe apo vende të veçanta me vlerë arkitektonike dhe historike
5. Zona gjeologjike të paqëndrueshme
6. Tokat bujqësore, veçanërisht ato me vreshta dhe pemëtores.

Rruga e propozuar është përzgjedhur në mënyrë specifike për të shmangur nevojën e çdo zhvendosjeje fizike. Itinerari gjithashtu shmang për aq sa është e mundur parcelat e tokës të mbjella me pemë shumëvjeçare, duke përfshirë pemishte dhe vreshta, si dhe do t'u duhej më shumë kohë për t'u rikuperuar pas çdo ndërprerjeje për shkak të ndërtimeve.

Zgjedhja e mëtejshme e rrugës ka rezultuar në një përsosje të itinerarit për të reduktuar më tej numrin e parcelave të tokës bujqësore të ndikuara nga projekti.

Përmirësime të mëtejshme të gjurmës përfundimtare përqendrohen në vendndodhjen e shtyllave individuale - aty ku është e mundur, këto janë duke u vendosur në kufirin / skajin e parcelave të fermave. Kjo do të zvogëlojë ndikimet e blerjes së përhershme të tokës për shtyllat në përdorimin e parcelës së mbetur të fermës, duke përfshirë përdorimin efikas të makinerive bujqësore në parcela. Vendosja e shtyllave në kufi redukton gjithashtu rrezikun e krijimit të 'tokës jetime' (toka e mbetur që bëhet joekonomike si rezultat i infrastrukturës së projektit) sa më shumë që të jetë e mundur.

Së fundi, metodologjitë e ndërtimit të përdorura do të minimizojnë ndikimin në kulturat bujqësore njëvjeçare dhe shumëvjeçare. Aktivitetet e ndërtimit të OHL-së, duke përfshirë 'vendosjen' e përcjellësve ajrore, do të përfshijnë futjen dhe kalimin nëpër kulturat bujqësore nëpër parcela për një kohë minimale (afërsisht gjysmë dite), ndërsa ndikimet tek kulturat shumëvjeçare dhe tek pemët do të shmangen sa më shumë që të jetë e mundur.

6.2 Identifikimi i ndikimeve të projektit

Identifikimi i ndikimeve të projektit është bazuar në:

1. Të dhënat bazë të mbledhura si pjesë e Vlerësimit të Ndikimit Mjedisor dhe Social (VNMS)
2. Vlerësimet e vendndodhjes të ndërmarrja si pjesë e VNMS dhe LRP
3. Mbështetja e Aseteve (Ferma e Tokës dhe Kulturat Bujqësore) - Për të përcaktuar shkallën e ndikimeve në parcelat e fermave dhe në kulturat bujqësore
4. Studimi socio-ekonomik i familjeve - Për familjet e prekura drejtpërdrejt, për të krijuar të dhëna bazë për zhvillimin e masave të përshtatshme zbutëse, identifikimin e familjeve potenciale të cënueshme dhe për të ndihmuar monitorimin dhe vlerësimin efektiv të ndikimeve dhe masave zbutëse
5. Regjistri i Ndikimit Social të Rrugës (RSIR) – për të ekzaminuar nëse do të ketë ndonjë ndikim në familjet, fermat ose bizneset përtej gjurmës së projektit si rezultat i humbjes së aksesit ose shqetësimeve të tjera gjatë periudhës së ndërtimit, dhe për të lejuar marrjen e masave zbutëse dhe kompensuese sipas nevojës
6. Angazhimi i palëve të interesuara i përqendruar në qasjen në tokë - i cili lejon ndërveprim shtesë me familjet e prekura në fazat kyçe dhe një mundësi për të mbledhur komente mbi ndikimet e mundshme dhe shqetësimet e palëve të interesuara. Kjo përfshinte angazhimin si pjesë e procedurave të anketimit dhe do të vazhdojë me zhvillimin dhe shpërndarjen e Udhëzuesit për Blerjen dhe Kompensimin e Tokës, dhe angazhimet e përgjithshme të përditshme përmes punës së Oficerëve Ndërlidhës me Komunitetin dhe funksionimit të Mekanizmit të Ankesave.

Siç u përmend në këtë seksion, shtrirja e ndikimeve të drejtpërdrejta të aksesit në tokë që rrjedhin nga komponentë të ndryshëm të projektit janë përmbledhur në Tabelën 7.1 më poshtë.

TABELA 6.1: NDIKIMET E HYRJES NË TOKË

Faza e Projektit	Komponenti	Marrja e parashikuar e tokës	Parcelat e parashikuara të tokës	Kohëzgjatja	Ndikimet e mundshme
Ndërtimi	Zona e Parkut	185 ha	21 parcela toke	Të përhershme	Ndikimet në kullotje informale dhe në aktivitete të tjera; kufizimet e aksesit
	Kantieret e ndërtimit dhe zonat e shtrimit	4 ha	2 parcela toke	E përkohshme	Ndikimet në kullotjen informale; kufizimet e aksesit

Faza e Projektit	Komponenti	Marrja e parashikuar e tokës	Parcelat e parashikuara të tokës	Kohëzgjatja	Ndikimet e mundshme
	Rrugët e hyrjes në kantier	Mbeten për t'u përcaktuar	25 parcela toke	E përkohshme	Ndikimet në kullotje informale dhe aktivitete të tjera; kufizimet e aksesit; humbja e kulturave bujqësore
	Shtyllat e OHL	57 shtylla që zënë një sipërfaqe toke prej mesatarisht 10m x 10m	57 parcela toke	Të përhershme	Humbja e tokës; humbja e kulturave bujqësore dhe të ardhurave bujqësore
	Rrugët hyrëse të shtyllave të OHL	57 parcela toke për rrugët hyrëse (përlllogaritja e marrjes së përkohshme të tokës 5m x 5m)	57 parcela toke	E përkohshme	Humbja e përkohshme e tokës, humbje e kulturave bujqësore dhe të ardhurave bujqësore; probleme për dheun
	Rrugët e hyrjes dhe Korridori i Ndërtimit të OHL-së	Përafërsisht. 17 ha	725 parcela toke*	E përkohshme	Humbja e kulturave bujqësore dhe të ardhurave bujqësore; problemet për dheun
Operacionet	E drejta e kalimit për tek OHL-ja	25 m rrugë kalimi në secilës anë të OHL-së	725 parcela toke*	Të përhershme (kufizime të pjesshme)	Kufizimet e servitutit në lidhje me përdorimet e lejuara në tokën urbane sa i përket të drejtës së kalimit dhe zonës në të cilën vlen kjo e drejtë kalimi.**

*634 parcela toke të inventarizuara në 21 dhjetor, dhe 32 parcela të reja toke të identifikuar për ndryshimin e gjurmës së OHL-së, dhe 50 parcela të reja toke të prekura nga rrugët e aksesit në OHL

**Projekti nuk do të aplikojë servitut mbi tokat bujqësore apo pyjet. Megjithatë, pronarët e tokave të cilët kanë tokë truall (tokë urbane) brenda korridorit 25 m në të dyja anët e linjës OHL në praktike mund të mos jenë në gjendje të ndërtojnë në këto toka në të ardhmen, pavarësisht se nuk do të aplikohet asnjë kufizim ligjor mbi këto toka. Në këto raste, do të paguhet kompensim sipas Normave të Servitutit për Tokën Urbane.

Bazuar në angazhimet e palëve të interesuara, analizën e të dhënave dhe karakteristikat e projektit, vlerësimi i ndikimeve është konsideruar më poshtë.

TABELA 6.2 VLERËSIMI I NDIKIMEVE

Pala e interesit	Vlerësimi i Ndikimit		
	Burimet e ndikimit	Ndikimi i identifikuar	Masat zbutëse të propozuara
Komponenti i projektit: Vendi i Parkut			
Pronarët e tokave	<p>E gjithë toka që lidhet me zonën e parkut është në pronësi të shtetit dhe nuk ka qenë më parë në duar private apo e shpronësuar.</p> <p>Përdorimi i parcelave private për kampe të përkohshme ndërtimi/zona shtrirjeje do të merret me qira për një periudhë të vlerësuar prej një viti - toka aktualisht nuk përdoret përveçse për kullotje informale</p>	<p>Asnjë ndikim nga blerja e parkut.</p> <p>(Megjithatë, shih edhe komentet më poshtë për ndikimet tek fermerët/barinjët e blegtorët)</p>	Asnjë
Fermerët	Nuk ka fermerë që kultivojnë kultura bujqësore në tokën e prekur nga zona e parkut.	Asnjë ndikim nga blerja e parkut.	Asnjë
Blegtorët/barinjët	<p>Zona e parkut përdoret në mënyrë informale për kullotjen e deleve. E gjithë zona e Parkut PV nuk është ideale për kullotje, për shkak të vegjetacionit të rralluar. Siç vërehet në Vlerësimin e Shërbimeve të Ekosistemit të Projektit, brenda 5 km nga lokacioni, parkut PV mbulon ~12% të tokës kullotëse të aksesueshme/të pakultivuar, e cila është e një cilësie të ngjashme ose më të mirë.</p>	<p>Furnizimi i tokës kullotëse do të ndikohet në një masë shumë të vogël pasi kullotja e bollshme alternative e aksesueshme është e disponueshme dhe nuk do të ndikohet funksionalisht nga Projekti. Më tej, do të ketë mundësi për të hyrë në zonën e parkut gjatë operacioneve për kullotje - toka brenda zonës së parkut mund të ofrojë kullotje edhe</p>	Ndikimi i adresuar përmes masave të menaxhimit të ndërtimit

Pala e interesit	Vlerësimi i Ndikimit		
	Burimet e ndikimit	Ndikimi i identifikuar	Masat zbutëse të propozuara
		më të mirë nga mbrojtja dhe përdorim më periodik. Toka e parkut PV përfshin edhe gjurmët që përdoren për të hyrë në tokën e kullotës në zonën përreth. Gjatë ndërtimit dhe operimit do të sigurohet akses alternativ për të shmangur ndikimet.	
Peshkatarët	Peshkatarët përdorin shtigje informale nëpër shkurre të zonës së projektit dhe zonave përreth për të hyrë në bregdet dhe në lagunë. Rruga në lindje të zonës së parkut është në gjendje të keqe dhe i pengon automjetet të përdorin këtë rrugë, për rrjedhojë ato përdorin shtigje informale për të dalë në bregdet.	Si pjesë e zhvillimit të projektit, përmirësimet në rrugë duhet të përmirësojnë aksesin në bregdet/lagunë, duke reduktuar njëkohësisht ndikimet në shkurre nga përdorimi i shtigjeve informale.	Ndikimi i adresuar përmes zhvillimit të projektit / përmirësimeve të aksesit, duke rezultuar në përfitime neto
Komponenti i projektit: Rrugët e hyrjes në kantier			
Pronarët e tokave	Aty ku rrugët hyrëse që çojnë në lokacionin e parkut kërkojnë përdorimin e tokës private (p.sh. zgjerimin e rrugës për të lehtësuar trafikun e ndërtimit dhe punimet e ndërtimit të tilla si forcimi i urave) do të duhet të adresohet ndikimi i humbjes së përkohshme të tokës. Kjo mund të përcaktohet vetëm kur Kontraktori i Ndërtimit ose EPC ndërmer projektimin e detajuar të hyrjes në kantier.	Si rezultat i zhvillimit të rrugëve të hyrjes në zonën e parkut, pronarët e tokave jashtë gjurmës së projektit mund të humbasin përkohësisht aksesin në tokat e tyre dhe mund të ndikohen nga humbja e kulturave bujqësore. Kontraktori i ndërtimit ose EPC do të marrin masa për të siguruar akses të vazhdueshëm në të gjitha tokat jashtë gjurmës së projektit gjatë ndërtimit.	Humbja e përkohshme e tokës dhe kompensimi i humbjes së kulturave bujqësore në lidhje me rrugët hyrëse do të merren parasysh në Kornizën e Kompensimit të Projektit.
Fermerët	Aty ku aksesit (qoftë i përkohshëm ose i përhershëm) që të çon në vendin e parkut kërkon	Si rezultat i zhvillimit të rrugëve të hyrjes në zonën e parkut, fermerët jashtë	Kompensimi i të korrave në lidhje me rrugët hyrëse do të merret

Pala e interesit	Vlerësimi i Ndikimit		
	Burimet e ndikimit	Ndikimi i identifikuar	Masat zbutëse të propozuara
	përdorimin e tokës shtesë private ose shtetërore (p.sh. zgjerimi i rrugës për të lehtësuar trafikun e ndërtimit), humbja e çdo kulture të ndikuar do të duhet të adresohet.	gjurmës së projektit mund të humbasin aksesin në tokat e tyre. Kontraktori i Ndërtimit ose EPC do të marrin masa për të siguruar akses të vazhdueshëm në të gjitha tokat jashtë gjurmës së projektit.	parasysh në Kornizën e Kompensimit të Projektit.
Komponenti i projektit: shtyllat e OHL-së dhe rrugët hyrëse			
Pronarët e tokave (përfshirë mbajtësit e certifikatës AMTP pa regjistrim zyrtar)	Pronarët e tokave do të ndikohen nga humbja e përhershme e tokës. Ku është e mundur, shtyllat do të vendosen në skajin e parcelave të tokës për të minimizuar shqetësimet në praktikën bujqësore dhe për të minimizuar potencialin për tokë jetime (në disa raste një sipërfaqe toke midis marrjes së përhershme të tokës dhe skajit të parcelës mund të bëhet joekonomike për bujqësi për shkak të madhësisë dhe/ose formës së mbetur).	Pronarët e tokave do të ndikohen nga humbja e përhershme e tokës për shkak të marrjes së tokës për shtyllat (10 m x 10 m). Ato gjithashtu mund të ndikohen nga toka jetime.	Toka e përhershme merr kompensim (përfshirë tokën jetime aty ku është e aplikueshme) për t'u marrë parasysh në Kornizën e Kompensimit të Projektit
Fermerët (si pronarët dhe përdoruesit e tokës)	Fermerët do të ndikohen nga një humbje e mundshme e kulturave bujqësore (njëvjeçare dhe shumëvjeçare) në lidhje me marrjen e përhershme të tokës për shtylla, dhe humbje të kulturave bujqësore që lidhen me aksesin e përkohshëm të tokës gjatë ndërtimit. Qasja e përkohshme në tokë mund të përfshijë rrugë hyrëse të përkohshme në vendndodhjet e shtyllave. Si rezultat i zhvillimit të rrugëve hyrëse në lokacionet e shtyllave, fermerët jashtë gjurmës së projektit mund të humbasin përkohësisht aksesin në tokat e tyre. Kontraktori i Ndërtimit ose	Pronarët do të ndikohen përkohësisht gjatë aksesit në tokë për aktivitetet ndërtimore. Pronarët dhe përdoruesit e tokave potencialisht do të ndikohen nga humbja e të korrave (vjetore dhe shumëvjeçare)	Qasja e përhershme dhe e përkohshme në tokë dhe humbja e mëvonshme e kulturave bujqësore duhet të merren parasysh në Kornizën e Kompensimit të Projektit

Pala e interesit	Vlerësimi i Ndikimit		
	Burimet e ndikimit	Ndikimi i identifikuar	Masat zbutëse të propozuara
	EPC do të marrin masa për të siguruar akses të vazhdueshëm në të gjitha tokat jashtë gjurmës së projektit.		
Komponenti i projektit: Rrugët e hyrjes dhe rrugët e kalimit në OHL			
Fermerët (si pronarët dhe përdoruesit e tokës)	Fermerët do të ndikohen nga një humbje e mundshme e kulturave bujqësore (njëvjeçare dhe shumëvjeçare) në lidhje me aksesin e përkohshëm të tokës gjatë ndërtimit. Qasja e përkohshme në tokë do të përfshijë rrugë të përkohshme aksesi në të djathtën e rrugës së kalimit, dhe akses në të djathtën e kalimit për lidhjen e linjave të energjisë ndërmjet shtyllave. Kjo do të ndikojë në një pjesë të rrugës së djathtë 8m përgjatë gjurmës së OHL. Qasja në tokë në çdo parcelë do të zgjasë më pak se një ditë. Si rezultat i zhvillimit të rrugëve të hyrjes në të Rrugën e Kalimit, fermerët jashtë gjurmës së projektit mund të humbasin përkohësisht aksesin në tokat e tyre. Kontraktori i Ndërtimit ose EPC do të marrin masa për të siguruar akses të vazhdueshëm në të gjitha tokat jashtë gjurmës së projektit.	Pronarët dhe përdoruesit e tokave potencialisht do të ndikohen nga humbja e të korrave (vjetore dhe shumëvjeçare)	Qasja e përhershme dhe e përkohshme në tokë dhe humbja e mëvonshme e kulturave bujqësore duhet të merren parasysh në Kornizën e Kompensimit të Projektit
Komponenti i projektit: Kufizimet e rrugës së kalimit të OHL			
Pronarët e parcelave të tokës urbane	Projekti nuk do të aplikojë kufizime ligjore të servitutit tek tokat.	Në praktikë, pronarët e tokave që kanë tokë truall (e klasifikuar si tokë urbane) brenda 25 m nga korridori i OHL-së (në secilën anë) mund ta kenë të pamundur ta përdorin	Pjesa e tokës që ndodhet brenda korridorit 25 m nga të dyja anët e OHL-së do të kompensohen sipas "Vlerave të Projektit për Servitutit Urban".

Pala e interesit	Vlerësimi i Ndikimit		
	Burimet e ndikimit	Ndikimi i identifikuar	Masat zbutëse të propozuara
		tokën për ndërtim në të ardhmen.	

7 KUADRI I KOMPENSIMIT

7.1 Konsideratat kryesore dhe praktikat më të mira ndërkombëtare

Korniza e Kompensimit, sipas standardeve ndërkombëtare, duhet të specifikojë të gjitha format e të drejtave të pronësisë ose përdorimit të aseteve në mesin e popullatës së prekur nga projekti dhe strategjinë e projektit për kompensimin e tyre për humbjen e pjesshme ose të plotë të këtyre aseteve.

Prandaj, ky seksion përshkruan Kornizën e Kompensimit për Projektin. Kuadri i Kompensimit është rafinuar përmes konsultimeve të gjera me palët e interesuara, duke përfshirë autoritetet përkatëse qeveritare, institucionet ndërkombëtare të financimit dhe familjet e prekura, duke kulmuar në zhvillimin e një *matrice* përfundimtare të pranueshmërisë dhe të drejtave që përshkruan pranueshmërinë dhe të drejtat e familjeve të prekura nga projekti (PAH) në lidhje me kompensimin dhe ndihma të tjera. Kjo përmbledhet gjithashtu në *Udhëzuesin për Blerjen dhe Kompensimin e Tokës (GLAC)*, i cili u paraqitet të gjitha familjeve të prekura drejtpërdrejt.

Sipas standardeve në fuqi, nga propozuesi i projektit kërkohet të kompensojë dhe/ose të ndihmojë njerëzit e prekur nga zhvendosja ekonomike. Personat e prekur përfshijnë:

1. Ata që kanë të drejta formale ligjore mbi tokën ose pasurinë
2. Ata që nuk kanë të drejta formale ligjore mbi tokën ose asetet, por kanë pretendime për tokën ose asetet që njihen ose që mund të njihen sipas ligjit kombëtar
3. Ata që nuk kanë asnjë të drejtë ligjore ose pretendim të njohur për tokën ose asetet që zënë ose përdorin tokën.

Opsionet e të drejtës që u ofrohen njerëzve të prekur bazohen në angazhimet dhe konsultimet e palëve të interesuara, analizën e anketave socio-ekonomike dhe të aseteve, dhe në vlerësimin e ndikimeve.

Kuadri i Kompensimit, sipas standardeve ndërkombëtare, specifikon të gjitha format e të drejtave të përdorimit të popullsisë së prekur nga blerja e tokës për ndërtimin e Projektit dhe strategjinë e projektit për kompensimin e tyre për kufizimin e pjesshëm ose të plotë / humbjen e aseteve / aksesin në tokë.

7.2 Objektivat e Kornizës së Kompensimit

Objektivat kryesore të Kornizës së Kompensimit janë:

1. Sigurimi i një baze gjithëpërfshirëse për angazhimin me palët e interesuara në të gjitha aspektet e kompensimit dhe zbutjes në lidhje me projektin
2. Sigurimi i një baze për angazhim të hapur dhe transparent për të siguruar marrëveshje vullnetare mbi vlerat e kompensimit dhe ndihmën e lidhur me familjet e prekura, me shpronësimin e përdorur vetëm si mjetin e fundit
3. Përcaktimin e politikave dhe procedurave të kompensimit në mënyrë gjithëpërfshirëse
4. Ofrimi i njerëzve dhe familjeve të prekura nga Projekti kompensim të drejtë dhe në kohë të mjaftueshme për të kompensuar të gjitha humbjet

5. Rikuperimi dhe mundësisht përmirësimi i jetesës dhe mirëqenies së njerëzve dhe familjeve të prekura nga Projekti në mënyrë që ata të jenë të barabartë ose më mirë se përpara ndikimit të Projektit.

7.3 Parimet e Kompensimit

- 1) Voltalia synon të arrijë marrëveshje vullnetare me personat dhe familjet e prekura, me shpronësimin që shfrytëzohet vetëm kur është e nevojshme – në praktikë për shkak të vështirësisë së familjeve në sigurimin e dokumentacionit të nevojshëm për marrëveshjet e shitjes së tokës, do të ndiqet procesi i shpronësimit në pjesën dërrmuese të rasteve. Në këto raste, Voltalia do hyjë në Marrëveshje Kompensimi me familjet në mënyrë që të paguajë në avancë vlerën e plotë të kompensimit (shiko Parimin 3 më poshtë). Kompensimi do të jetë në vlerën e plotë të zëvendësimit, pa zhvlerësim apo amortizim, dhe duke marrë parasysh të gjitha kostot e transaksionit.
- 2) Në rastet kur do të shfrytëzohet procesi i shpronësimit për familjet që kanë hyrë në marrëveshje vullnetare, Voltalia do të paguajë shumën e plotë të kompensimit para hyrjes në tokë, pavarësisht pagesave që familja mund të përfitojë nga procesi i shpronësimit. Procedurat e shpronësimit nisen para fillimit të ndërtimit;
- 3) Për familjet që refuzojnë procesin e marrëveshjeve vullnetare, Voltalia do vërë në dispozicion shumën shtesë që i shtohet vlerës së shpronësimit në mënyrë që të sigurohet vlera e plotë e kompensimit për familjen;
- 4) Veç kompensimit për asetet, masa të tjera për mbështetjen e jetesës do të zhvillohen sipas nevojës, në mënyrë që të sigurohet restaurim efektiv dhe në kohë i parcelës; dhe
- 5) Familjet e identifikuara si të cenueshme do të kenë të drejtë për mbështetje kalimtare shtesë.

Parimet kryesore që duhen miratuar nga projekti në lidhje me kompensimin për ndikimet e ndryshme të identifikuara janë të detajuara më poshtë.

7.3.1 Blerja e Përhershme e Tokës

Përvetësimi i përhershëm i tokës do të kërkohet në lidhje me Zonën e Parkut PV (185 Ha) dhe bazat për instalimin e shtyllave (57 shtylla me një bazë 10m x 10m).

Parku PV: Pjesa më e madhe e tokës së përhershme do të kërkohet për zbatimin e Parkut PV (185 ha). Toka e nevojshme për ndërtimin e parkut PV është tokë shtetërore. Sipas marrëveshjes kontraktuale, toka për Parkun PV do të transferohet nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë të Voltalia me qëllim ndërtimin e Parkut PV.

Në zhvillimin e rrugëve të hyrjes në kantierin e parkut, do të përdoren sa më shumë të jetë e mundur rrugët ekzistuese. Në disa raste, mund të kërkohet zgjerimi i rrugës, gjë që mund të rezultojë në marrjen e përhershme të tokës për familjet që nuk ndikohen drejtpërdrejt nga gjurmët e projektit, por që më pas do të ndikohen nga zhvillimi i rrugëve hyrëse. Këto zona, nëse ka, do të identifikohen nga Kontraktori i Ndërtimit ose EPC gjatë projektimit të detajuar të ndërtimit dhe planifikimit të ekzekutimit, dhe çdo marrje e tokës do të ndjekë parimet e projektit.

Instalimi i shtyllave: Instalimi i 57 shtyllave me bazament 10m x 10m do të kërkojë që toka të fitohet përgjithmonë (të paktën për të gjitha fazën e ndërtimit dhe të funksionimit). Do të ndërmerret një proces i blerjes së tokës me anë të të cilit Projekti do të marrë tokë nga pronarët aktualë dhe do të ndryshojë statusin e tyre përgjithmonë.

Për procesin e kompensimit të përmendur më sipër, do të ndiqen parimet e mëposhtme:

1. Kompensimi do të paguhet për tokën sipas 'Normës së Blerjes së Tokës së Projektit'
2. Kompensimi do të paguhet për çdo kulturë bujqësore ekzistuese sipas 'Normave të Projektit për Kulturat Bujqësore'

3. Rikuperimi i të gjitha parcelave të fermave pas ndërtimit sipas kushteve paraprahe të projektit
4. Familjet e prekura që kanë të drejtën e çdo mase rikuperimi të jetesës, të zhvilluara për të siguruar restaurim dhe shfrytëzim efektiv të parcelave të fermave të prekura.

7.3.2 Marrja e Përkohshme e Tokës

Përvetësimi i përkohshëm i tokës do të kërkohet në lidhje me dy parcelat private në kufirin e Parkut PV, të cilat do të përdoren përkohësisht për kampe ndërtimi / zona shtrimi (4 ha). Pronarët e dy parcelave të tokës aktualisht janë duke u angazhuar nga Projekti.

Do të respektohen këto parime:

1. Kompensimi do të paguhet për tokën në shkallën prej 12.5% të Normës së Blerjes së Tokës së Projektit, e paguar çdo vit, për një minimum prej një viti
2. Kompensimi do të paguhet për çdo kulturë bujqësore ekzistuese sipas 'Normave të Projektit për Kulturat Bujqësore'
3. Rikuperimi i të gjitha parcelave të fermave pas ndërtimit sipas kushteve paraprahe të projektit
4. Familjet e prekura që kanë të drejtën e çdo mase rikuperimi të jetesës, të zhvilluara për të siguruar restaurim dhe shfrytëzim efektiv të parcelave të fermave të prekura.
5. Asnjë parcelë e prekur nga linja OHL nuk përfshihet në këtë kategori.

7.3.3 Aksesi i përkohshëm në tokë

Aksesi i përkohshëm në tokë ndryshon nga blerja e përkohshme e tokës, pasi lidhet me aksesin në tokë gjatë ndërtimit të parkut dhe OHL-së. Çdo përdorim i rrugëve të hyrjes dhe e drejta e kalimit për ndërtimin e OHL-së në përgjithësi do të jetë me kohëzgjatje afërsisht një ditore në çdo parcelë. Aty ku aktivitetet e ndërtimit (p.sh. në lidhje me shtyllat) çojnë në një kohëzgjatje prej më shumë se dy muajsh, do të zbatohen masat për blerjen e përkohshme të tokës.

Për ndërtimin e kantierit, zgjerimi i rrugës dhe forcimi i urës në lidhje me rrugët hyrëse mund të kërkojnë akses të përkohshëm në tokë. Aty ku aktivitetet e ndërtimit rezultojnë në një kohëzgjatje prej më shumë se dy muajsh, do të zbatohen masat e përkohshme për marrjen e tokës.

Aksesi i përkohshëm në tokë do të kërkohet në lidhje me:

1. Rrugët hyrëse të përkohshme në parkun PV gjatë ndërtimit
2. Rrugët e aksesit të përkohshëm në shtyllat për ndërtim
3. Rrugët e aksesit të përkohshëm dhe një korridor ndërtimi në anën e djathtë të kalimit për lidhjen e kablove ndërmjet shtyllave të linjës ajrore (OHL).

Do të respektohen këto parime:

1. Do të paguhet kompensim në masën 12.5% të Normës së Projektit për Blerjen e Tokës, në raport me kohëzgjatjen e përdorimit të tokës gjatë ndërtimit (nga hyrja në tokë deri në daljen nga toka)
2. Kompensimi do të paguhet për çdo kulturë bujqësore ekzistuese sipas 'Normave të Projektit për Kulturat Bujqësore'
3. Rikuperimi i të gjitha parcelave të fermave pas ndërtimit sipas kushteve paraprahe të projektit
4. Familjet e prekura që kanë të drejtën e çdo mase rikuperimi të jetesës, të zhvilluara për të siguruar restaurim dhe shfrytëzim efektiv të parcelave të fermave të prekura.

7.3.4 Toka jetime

Projekti do të vlerësojë rastet e tokave jetime si gjatë anketimeve para ndërtimit ashtu edhe gjatë ndërtimit të projektit. Kriteret për të vlerësuar nëse toka është jetime do të përfshijnë:

1. Sipërfaqen dhe natyrën e pjesës së tokës potencialisht jetime
2. Teknikat tipike bujqësore të përdorura (p.sh. përdorimin e makinerive)

3. Mendimin e ekspertëve të agronomëve të projektit për qëndrueshmërinë e tokës potencialisht jetimore.

Toka jetime mund të shkaktohet nga Blerja e Përherhshme/Përkohshme e Tokës (shih nënseksionet më poshtë).

7.3.4.1 Blerja e Përherhshme e Tokës

Kur blerja e përherhshme e tokës rezulton në një pjesë të parcelës së tokës që konsiderohet joekonomike, projekti do të kompensojë tokën e mbetur që konsiderohet joekonomike sipas parimeve të Blerjes së Përherhshme të Tokës më sipër (seksioni 7.3.1 Blerja e Përherhshme e Tokës).

Parashikohet që blerja e përherhshme e tokës për shtylla, do të lejojë që aktivitetet bujqësore të vazhdojnë në parcelat e fermave të prekura. Megjithatë, mund të ketë raste kur një pjesë e tokës (p.sh., midis bazës së shtyllës dhe kufirit të fermës) mund të ndahet nga pjesa e mbetur e parcelës së fermës dhe të konsiderohet joekonomike për t'u kultivuar. Prandaj, kjo tokë do të konsiderohet 'tokë jetime'.

7.3.4.2 Marrja e Përkohshme e Tokës

Toka mund të jetë 'jetime' përkohësisht – për shembull kur blerja e përkohshme e një parcele ferme për punime ndërtimore kufizon aksesin në parcelat e tjera të fermës. Kur blerja e përkohshme e tokës rezulton në ndonjë pjesë të parcelës së tokës që konsiderohet joekonomike ose e paaksesueshme, projekti do të kompensojë tokën e mbetur që konsiderohet joekonomike sipas parimeve të Blerjes së Përkohshme të Tokës më sipër (shih seksionin 7.3.2 Marrja e Përkohshme e Tokës

Përvetësimi i përkohshëm i tokës do të kërkohet në lidhje me dy parcelat private në kufirin e Parkut PV, të cilat do të përdoren përkohësisht për kampe ndërtimi / zona shtrimi (4 ha). Pronarët e dy parcelave të tokës aktualisht janë duke u angazhuar nga Projekti.

Do të respektohen këto parime:

Kompensimi do të paguhet për tokën në shkallën prej 12.5% të Normës së Blerjes së Tokës së Projektit, e paguar çdo vit, për një minimum prej një viti

Kompensimi do të paguhet për çdo kulturë bujqësore ekzistuese sipas 'Normave të Projektit për Kulturat Bujqësore'

Rikuperimi i të gjitha parcelave të fermave pas ndërtimit sipas kushteve paraprake të projektit

Familjet e prekura që kanë të drejtën e çdo mase rikuperimi të jetesës, të zhvilluara për të siguruar restaurim dhe shfrytëzim efektiv të parcelave të fermave të prekura.

Asnjë parcelë e prekur nga linja OHL nuk përfshihet në këtë kategori.

Aksesi i përkohshëm në tokë

Përvetësimi i përkohshëm i tokës do të kërkohet në lidhje me dy parcelat private në kufirin e Parkut PV, të cilat do të përdoren përkohësisht për kampe ndërtimi / zona shtrimi (4 ha). Pronarët e dy parcelave të tokës aktualisht janë duke u angazhuar nga Projekti.

Do të respektohen këto parime:

1. Kompensimi do të paguhet për tokën në shkallën prej 12.5% të Normës së Blerjes së Tokës së Projektit, e paguar çdo vit, për një minimum prej një viti
2. Kompensimi do të paguhet për çdo kulturë bujqësore ekzistuese sipas 'Normave të Projektit për Kulturat Bujqësore'
3. Rikuperimi i të gjitha parcelave të fermave pas ndërtimit sipas kushteve paraprake të projektit

4. Familjet e prekura që kanë të drejtën e çdo mase rikuperimi të jetesës, të zhvilluara për të siguruar restaurim dhe shfrytëzim efektiv të parcelave të fermave të prekura.

7.3.5 Kufizimet e servitutit

Projekti nuk do të aplikojë servitut mbi tokat bujqësore apo pyjet. Megjithatë, pronarët e tokave të cilët kanë tokë truall (tokë urbane) brenda korridorit 25 m në të dyja anët e linjës OHL në praktike mund të mos jenë në gjendje të ndërtojnë në këto toka në të ardhmen, pavarësisht se nuk do të aplikohet asnjë kufizim ligjor mbi këto toka. Në këto raste, do të paguhet kompensim sipas Normave të Servitutit për Tokën Urbane.

Do të respektohen këto parime:

- Çdo tokë urbane do të kompensohet në një përqindje të caktuar të vlerës së përgjithshme të tokës - 'Vlerat e Servitutit Urban të Projektit'
- Familjet e prekura që kanë të drejtën e çdo mase rikuperimi të jetesës, të zhvilluara për të siguruar restaurim dhe shfrytëzim efektiv të parcelave të fermave të prekura.

7.4 Studimi i vlerave të kompensimit

Sipas praktikave më të mira ndërkombëtare, të gjitha asetet e prekura duhet të zëvendësohen me vlerën e zëvendësimit. Projekti ka ndërmarrë një Studim të Vlerave të Kompensimit (SVK) për të përcaktuar vlerat e duhura të kompensimit në lidhje me të gjitha asetet e prekura, duke përfshirë përcaktimin e:

1. Normës së Blerjes së Tokës të Projektit
2. Normat e Projektit për Kulturat Bujqësore
3. Projekt Vlerat e Servitutit Urban.

Metodologjia e përdorur ishte si më poshtë:

Hapi 1: Identifikimi i vlerave ekzistuese që aplikohen aktualisht:

1. Identifikimi dhe marrja e informacioneve mbi vlerat e kompensimit nga Agjencitë Qeveritare Shqiptare të përfshira në aktivitetet e blerjes së tokës
2. Statistikat zyrtare të identifikuara nga burimet përkatëse të studimit për qëllime të llogaritjeve
3. Rishikimi dhe krahasimi i metodologjive të përdorura dhe nëse ato mund të arrijnë vlerën e tregut dhe koston e plotë të zëvendësimit
4. Rishikimi i parimeve përkatëse kombëtare për kategorizimin e tokës
5. Identifikimi dhe rishikimi i vlerave ekzistuese të kompensimit në zonën e projektit (si vlerat e tregut ashtu edhe vlerësimet e qeverisë)
6. Marrja në konsideratë e nënvlerësimit të transaksioneve (p.sh., për arsye tatimore)
7. Rishikimi i vlerave kundrejt kërkesave kombëtare dhe standardeve ndërkombëtare
8. Identifikimi dhe rishikimi i normave zyrtare të inflacionit dhe këmbimeve lekë/euro për pesë vitet e fundit
9. Identifikimi dhe rishikimi i statistikave zyrtare të disponueshme për çmimet e prodhimeve bujqësore.

Hapi 2: Zhvillimi i normave dhe vlerave të zëvendësimit për asetet e prekura:

1. Zhvillimi i një kategorizimi të përshtatshëm të bazuar profesionalisht i tokës bujqësore të prekur (duke përdorur kritere të tilla si arë/kullotë, e ujitur/e thatë, lloji i tokës, etj.), bazuar në klasifikimet zyrtare të tokës sipas potencialit prodhues
2. Zhvillimi i një kategorizimi të tokës jo-bujqësore të prekur duke përdorur kategoritë përkatëse të planifikimit hapësinor (banesore urbane, banesore jurbane, industriale, etj.)
3. Zhvillimi i një kategorizimi gjeografik të tokës në lidhje me vlerësimin
4. Përgatitja e një matrice duke kryqëzuar kategoritë

5. Llogaritja e vlerës aktuale të zëvendësimit për secilën nga nën-kategoritë në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe kërkesat kombëtare
6. Marrja e transaksioneve referuese të agjencive qeveritare përkatëse për secilën nga nën-kategoritë dhe çmimet përkatëse për metër katror dhe vendosja e një vlere tregu për secilën nga nën-kategoritë e tokës
7. Kostot e vlerësuara të transaksionit (kostoja e regjistrimit dhe çdo taksë, tarifë, e drejtë, etj.) të cilat mund të jenë shtesë ndaj vlerës së tokës)
8. Përcaktimi i metodologjisë dhe vlerave të kompensimit për blerjen e përhershme të tokës dhe kompensimin e të korrave
9. Propozimi i një formule përditësimi duke marrë parasysh inflacionin e fundit dhe atë të ardhshëm.

Hapi 3: Zhvillimi i Matricës së Detajuar të Kompensimit.

7.5 Matrica e vlerave të kompensimit

Matrica rezultante e Kompensimit për Projektin është përmbledhur më poshtë. Ajo është paraqitur gjithashtu edhe në Udhëzuesin për Blerjen dhe Kompensimin e Tokës (GLAC) që do t'u jepet të gjitha familjeve që preken drejtpërdrejt nga projekti.

TABELA 7.1: MATRICA E KOMPENSIMIT

Lloji i Ndikimit	Lloji i kompensimit
1. Blerja e përhershme e tokës	Për pronarin e tokës (përfshirë zotëruesit e një Akti të Marrjes së Tokës në Pronësi (AMTP) pa regjistrim): Kërkohet blerja e tokës me Normën e Marrjes së Tokës së Projektit. Kompensimi për çdo aset fiks të prekur me vlerën e plotë të zëvendësimit (p.sh., strukturat e ujitjes, kullimit, barakat, pusët etj.)
	Për përdoruesit e tokës: Kompensimi për humbjen e kulturave bujqësore me vlerën e plotë të zëvendësimit
2. Blerja e Përkohshme e Tokës	Për pronarin e tokës (përfshirë edhe ata që kanë një certifikatë AMTP (Akti i Marrjes së Tokës në Pronësi), por që nuk e kanë të regjistruar): Kompensim për tokën në masën 12.5% të Normës së Projektit për Blerjen e Tokës, e paguar çdo vit.
	Për përdoruesit e tokës: Kompensimi për humbjen e kulturave bujqësore me vlerën e plotë të zëvendësimit
3. Akses i përkohshëm në tokë	Për pronarin (përfshirë mbajtësit e Aktit të Marrjes së Tokës në Pronësi "AMTP"): Kompensim për tokën në masën 12.5% të Normës së Projektit për Marrjen e Tokës, në raport me periudhën e përdorimit të tokës gjatë ndërtimit (nga hyrja në toke deri në daljen nga toka).
	Për përdoruesit e tokës: Kompensimi për humbjen e kulturave bujqësore me vlerën e plotë të zëvendësimit
4. Toka jetime	I nënshtrohet shqyrtimit rast pas rasti të opinionit prej ekspertit të agronomëve të projektit. Kur aksesit në tokë përkon në kthimin e një pjese të parcelës së tokës në një tokë si joekonomike, projekti do të kompensojë tokën e mbetur që konsiderohet joekonomike sipas parimeve të ndryshme.
5. Kufizimet e servitutit***	Toka Urbane Formale: 90% e Normës së Blerjes së Tokës së Projektit

--	--

Projekti nuk do të aplikojë servitut mbi tokat bujqësore apo pyjet. Megjithatë, pronarët e tokave të cilët kanë tokë truall (tokë urbane) brenda korridorit 25 m në të dyja anët e linjës OHL në praktike mund të mos jenë në gjendje të ndërtojnë në këto toka në të ardhmen, pavarësisht se nuk do të aplikohet asnjë kufizim ligjor mbi këto toka. Në këto raste, do të paguhet kompensim sipas Normave të Servitutit për Tokën Urbane

7.5.1 Përcaktimi i vlerave të zëvendësimit për parcelat e prekura

Kategoritë e ndryshme të tokave u përcaktuan si më poshtë:

1. Tokë urbane formale/joformale: Tokë që përdoret përgjithësisht për banim, për qëllime komerciale ose për industri të lehtë. Toka urbane informale përdoret për të njëjtat qëllime, por nuk quhet formalisht tokë 'urbane'
2. Tokë bujqësore: Tokë e përdorur për bujqësi. Kulturat bujqësore mund të jenë njëvjeçare ose shumëvjeçare (pemët). Kulturat bujqësore mundet gjithashtu të ujiten ose jo. Toka e prekur ndahet në 5 kategori të ndryshme.
3. Tokë pyjore: E gjithë toka e klasifikuar zyrtarisht si Tokë Pyjore, e cila mund të jetë në pronësi shtetërore ose private.
4. Tokë kullotë: Toka që nuk është në përgjithësi e përshtatshme për bujqësi, por që përdoret më mirë për kullotë.

Vlerat e të korrave u përcaktuan si më poshtë: Kompensimi bazohet në vlerën e plotë të zëvendësimit. Kontribuesit kryesorë të vlerës së plotë të zëvendësimit janë:

1. Rendimenti bujqësor
2. Dendësia e kultivimit
3. Çmimet e prodhuesve
4. Kostot e prodhimit
5. Të tjera (p.sh., subvencione)

Vlera e zëvendësimit llogaritet si: Të ardhura (rendimenti, çmimi i tregut, subvencionet etj.) + shpenzimet (kostot e transaksionit) = vlera e plotë e zëvendësimit.

Faktorët që ndikojnë në kompensimin për kulturat njëvjeçare përfshijnë: llojin e kulturës, rendimentin, çmimin e tregut, kostot e prodhimit, të tjera (p.sh., subvencionet). Faktorët që ndikojnë në kompensimin për kulturat shumëvjeçare (pemët) përfshijnë: llojin e kulturës/pemës, rendimentin, moshën e pemës, prodhimin/ciklin jetësor të pemës, çmimin e tregut, fitimin, kostot e prodhimit, të tjera (p.sh. subvencionet).

Projekti do të rimbursojë familjet e prekura nga projekti për çdo subvencion që humbet si rezultat i aktiviteteve të Projektit. Shuma specifike që mund të jepet do të trajtohet rast pas rasti.

7.5.2 Tabelat e Detajuara të Vlerave të Kompensimit

GLAC paraqet tabelat e plota të Vlerave të Kompensimit, të cilat i bashkëngjiten gjithashtu LRP-së si **Shtojca A**. Kjo përfshin:

1. Normat e Blerjes së Projektit për Tokën Bujqësore
2. Tarifat e blerjes së projektit për tokën urbane formale/joformale
3. Tarifat e Servitutit të Projektit për Tokën Urbane Formale/Informale
4. Normat vjetore të kulturave bujqësore të projektit
5. Normat e kulturave shumëvjeçare të projektit.

7.6 Kuadri i pranueshmërisë: Identifikimi i grupeve të pranueshme

PAH-të kanë të drejtë për kompensim dhe ndihma të tjera nëse kanë një "interes legjitim" në "asetet e paluajtshme" të Zonës së Projektit që janë aty në vend (p.sh., të krijuara, në rastin e kulturave bujqësore; ose të ndërtuara, në rastin e ndërtesave dhe strukturave të tjera) brenda datës kur kanë të drejtë të kërkojnë kompensim.

"Interesi legjitim" në asetet e paluajtshme në nivel familjar zakonisht mbahet nga një anëtar i vetëm: kryefamiljari. Nëpërmjet praktikës tradicionale dhe familjare, kryefamiljari është zakonisht mashkulli më i moshuar i familjes. Megjithatë, në shumicën e rasteve, interesi legjitim mbahet bashkërisht, p.sh., nga kryefamiljari dhe bashkëshorti/ja e tij/saj, ose me anëtarët e tjerë të familjes së gjerë. Nëse kryefamiljari vdes, Projekti do të kërkojë që anëtarët e tjerë të familjes të identifikojnë trashëgimtarin përmes një vendimi gjyqësor përpara se të paguhet kompensimi.

Vini re se "Interesi legjitim" nuk është sinonim me pronësinë. Edhe ata persona/familje/komunitete të prekura nga Projekti që nuk kanë të drejtë ligjore ose pretendime të njohura për asetet që ata posedojnë konsiderohen se e kanë të drejtën për ndihmë. Ka të ngjarë që të ketë raste kur PAH mund të mos kenë prova të pronësisë së tokës. Në Shqipëri është e zakonshme që toka të identifikohet si tokë shtetërore, por pronësia të pretendohet nga një familje që nuk ka përfunduar procesin e regjistrimit të pronësisë. Projekti do të zhvillojë një sistem ku raste të tilla do të hetohen dhe kërkuesi do të ndihmohet në marrjen e dokumenteve të nevojshme të pronësisë, ndërkohë që kompensimi mbahet në ruajtje. Kur një përdorues i tokës pretendon pronësinë e kulturave bujqësore, kjo do të konfirmohet me çdo pronar toke (nëse është tokë private), parcela fqinje dhe drejtues lokalë, si p.sh. me kryeplakun.

Inventari i aseteve të paluajtshme, i mbështetur nga të dhënat socio-ekonomike të familjeve, përbën bazën për kompensimin e PAH-ve. Asetet e paluajtshme që mbillen (në rastin e të korrave) ose të ndërtuara (në rastin e ndërtesave) *pas datës së ndërprerjes së të drejtës* nuk përfshihen në llogaritjet e kompensimit.

7.7 Matrica e pranueshmërisë dhe të drejtës

Përveç Matricës së Kompensimit, Projekti ka krijuar edhe një Matricë të plotë të Kriteve të Kompensimit, për të pasqyruar gamën e plotë të familjes që ka prekur një projekt, që përfshin masat e rikuperimit të jetesës si edhe mbështetje kalimtare për familjet e cënueshme.

Matrica e pranueshmërisë dhe e drejta identifikon:

1. Të gjitha kategoritë e personave të prekur
2. Të gjitha llojet e humbjeve që lidhen me secilën kategori
3. Të gjitha llojet e kompensimit dhe asistencës për të cilën ka të drejtë secila kategori.

Matrica e Pranueshmërisë dhe e të Drejtave është pjesë e kësaj LRP dhe paraqitet si Tabela 7.2 më poshtë.

TABELA 7.2: MATRICA E PRANUESHMËRISË DHE TË DREJTËS

Kategoria e Ndikimit	Kategoria e PAH	Paketa	Rregullat e kompensimit
Blerja e Përhershme e Tokës	Pronarët e tokave (duke përfshirë edhe ata që kanë një AMTP, por që nuk e kanë të	Kompensimi për tokën e prekur sipas Normës së Projektit për Blerja e Tokës Nëse është edhe përdorues i tokës, kompensimi për kulturat bujqësore ekzistuese sipas normës së projektit për kulturat bujqësore. Nëse është edhe përdorues i tokës, pronari ka të drejtën edhe të përfitimit nga programet për mjetet e jetesës	Duhet të ketë qenë pronar deri në datën e ndërprerjes së përfitimit nga këto programe

Kategoria e Ndikimit	Kategoria e PAH	Paketa	Rregullat e kompensimit
	regjistruar tokën zyrtarisht)		
	Përdoruesit e tokës (nëse nuk janë pronarë të tokës)	Kompensimi për kulturat bujqësore ekzistuese me tarifat e projektit për kulturat bujqësore Për të përfituar nga Planet e Rikuperimit të Jetesës	Duhet të jetë pjesë në kohën e protokollit të hyrjes në tokë
Marrja e Përkohshme e Tokës	Pronarët e tokave (duke përfshirë edhe ata që kanë një AMTP, por që nuk e kanë të regjistruar tokën zyrtarisht)	Kompensimi për tokën e prekur në shkallën 12.5% të Normës së Projektit për Blerjen e Tokës, e paguar çdo vit Nëse është edhe përdorues i tokës, kompensimi për kulturat bujqësore ekzistuese sipas normës së projektit për kulturat bujqësore. Nëse është edhe përdorues i tokës, pronari ka të drejtën edhe të përfitimit nga programet për mjetet e jetesës	Duhet të ketë qenë pronar deri në datën e ndërprerjes së përfitimit nga këto programe
	Përdoruesit e tokës (nëse nuk janë pronarë të tokës)	Kompensimi për kulturat bujqësore ekzistuese me tarifat e projektit për kulturat bujqësore Për të përfituar nga Programet e Jetesës	Duhet të jetë pjesë në kohën e protokollit të hyrjes në tokë
Aksesi i përkohshëm në tokë	Pronarët e tokave	Kompensim për tokën në masën 12.5% të Normës së Projektit për Marrjen e Tokës, në raport me periudhën e përdorimit të tokës gjatë ndërtimit (nga hyrja në toke deri në daljen nga toka). Rikthimi i tokës në gjendjen e mëparshme pas ndërtimit. Nëse është edhe përdorues i tokës, kompensimi për kulturat bujqësore ekzistuese sipas normës së projektit për kulturat bujqësore. Nëse është edhe përdorues i tokës, pronari ka të drejtën edhe të përfitimit nga programet për mjetet e jetesës	Duhet të ketë qenë pronar deri në datën e ndërprerjes së përfitimit nga këto programe
	Përdoruesit e tokës (nëse nuk janë pronarë të tokës)	Kompensimi për kulturat bujqësore ekzistuese me tarifat e projektit për kulturat bujqësore Për të përfituar nga Programet e Jetesës	Duhet të ketë përmbajtje në kohën e inventarizimit

Kategoria e Ndikimit	Kategoria e PAH	Paketa	Rregullat e kompensimit
Kufizimet e servitutit	Pronarët e tokave	Kompensimi për çdo kufizim të përdorimit me Normën e Projektit për Kufizimin e Servitutit	Duhet të ketë qenë pronar deri në datën e ndërprerjes së përfitimit nga këto programe
Toka jetime	Pronarët e tokave	Kompensohet me normën e blerjes së tokës të projektit, rasteve kur kufizimet e shërbimit në tokën jetime, më pas kompensohen në bazë të vlerave të shërbimit të projektit.	Toka jetime përcaktohet rast pas rasti

8 PROCESI I AKSESIT DHE BLERJES SË TOKËS

8.1 Hapat kyç


Bazuar në Kornizën e Kompensimit dhe duke pasur parasysh rregulloret kombëtare të shpronësimit dhe standardet ndërkombëtare dhe praktikatat më të mira, janë ndjekur këta hapa në procesin së tokës në kuadrin e këtij Projekti.

1. Përgatitja e Dosjeve Familjare
2. Përgatitja & Prezantimi i Ofertave
3. Procesi i Marrëveshjes Vullnetare me Familjet
4. Procedurat e shpronësimit
5. Marrëveshjet e Kompensimit
6. Pagesa e Kompensimit
7. Hyrja në Tokë
8. Dalja nga Toka & Kthimi te pronari

Vini re se Voltalia do të mbështesë dhe lehtësojë procesin e blerjes së tokës për OST-në. Voltalia do të udhëheqë Procesin e Marrëveshjes Vullnetare. Përveç kësaj, do të mbështetet edhe Procesi i Shpronësimit për t'u siguruar që OST të blejë tokën për Projektin. Voltalia do të drejtojë vlerësimin dhe pagesën e kompensimit për llogari të OST-së, por të gjitha dokumentet e transaksionit për transferimin e pronësisë së tokës do të mbahen nga OST.

Hapat kryesorë për blerjen e tokës dhe aksesin e përkohshëm janë prezantuar në formë grafike dhe diskutohen më poshtë.

Grafiku i mëposhtëm përshkruan hapat e Marrjes së Përhershme të Tokës (vendndodhjet e shtyllave).




Projekti ka bërë përpjekjet më të mira për t'u angazhuar me pronarë të paidentifikuar ose që mungojnë përpara dhe gjatë Procesit të Marrëveshjes Vullnetare. Në rast të një konflikti në identifikimin e pronarëve ose përdoruesve, kryhet një proces verifikimi dhe çdo pagesë e kompensimit do të mbahet në ruajtje në pritje të përcaktimit të pronësisë së tokës ose aseteve (kulturave bujqësore). Pasi të shterohet Procesi i Marrëveshjes Vullnetare (kur të përmbyllen të gjitha marrëveshjet vullnetare që kanë

dokumentacionin e nevojshëm), dhe ka evidencë të mjaftueshme që vërteton se familja nuk është në gjendje të sigurojë dokumentacionin e nevojshëm në kohë, do të ndiqet Procesi i Shpronësimit për ata që kanë refuzuar marrëveshjet vullnetare, ata që janë të pidentifikuar dhe/ose mungojnë, dhe ata të cilët janë në gjendje të sigurojnë dokumentacionin e kërkuar të pronësisë apo dokumente të tjera mbështetëse për përmbylljen e marrëveshjeve vullnetare.

Në bazë të eksperiencës së deritanishme me procesin e Marrëveshjeve Vullnetare, ka shumë të ngjarë që pothuajse të gjitha familjet të mos jenë në gjendje të sigurojnë dokumentacion të mjaftueshëm që kërkohet për Marrëveshjen Vullnetare. Voltalia u angazhua me familjet dhe i mbështeti ato në marrjen e dokumentacionit të nevojshëm për marrëveshjet vullnetare, por pas pothuajse dy muajsh asnjë familje nuk arriti të siguronte dokumentacionin e nevojshëm. Si rrjedhojë, do të përdoret procesi i shpronësimit për të gjitha parcelat që preken nga marrja e përhershme e tokës. Projekti do i njoftojë ato familje që janë subjekt i procesit të marrëveshjeve vullnetare por me dokumentacion të pamjaftueshëm të pronësisë, se për to do të ndiqet procesi i shpronësimit. Kjo është kritike për të shmangur vonesa në marrjen e lejeve dhe licencave për ndërtimin e projektit. Megjithatë, në mënyrë që të mos disavantazhohen familjet që janë subjekt i procesit të marrëveshjeve vullnetare, Voltalia do të ndërmarrë Marrëveshje Kompensimi me këto familje. Kjo marrëveshje merr përsipër pagesën e shumës së plotë të kompensimit për marrjen e përhershme të tokës, në përputhje me Normat e Projektit. Kjo shpjegohet më tej më poshtë.

Hapat kyç të aksesimit të përkohshëm të tokës (akses i makinerive dhe njerëzve në vendndodhjet e shtyllave, dhe aksesimi i korridorit të OHL për shtrirjen e telave) është i ndryshëm pasi nuk do jetë i nevojshëm sigurimi i dokumentacionit për të pasur të drejtën e kompensimit të të mbjellave sipas normave të Projektit. Kryetari i familjes bujqësore do të nënshkruajë marrëveshjet e kompensimit. Grafiku më poshtë përshkruan hapat e Aksesimit të Përkohshëm të Tokës:



Aksesimi i Përkohshëm i Tokës do të arrihet nëpërmjet një Deklarate Kompensimi për pronarin ashtu edhe për përdoruesin e tokës, dhe Marrja në Përdorim të Përkohshëm të tokës (“shpronësimi i përkohshëm”) do të përdoret kur të jetë i nevojshëm shpronësimi i përkohshëm i tokës.

Si për marrjen e përhershme të tokës ashtu edhe për aksesimin e përkohshëm, do të sigurohet një llogari bankare në mënyrë që pronarët e pidentifikuar apo që mungojnë të kenë mundësi të pretendojnë shumën e kompensimit brenda 5 viteve nga fillimi i ndërtimit. Në rastet kur pronarët prezantohen brenda kësaj periudhe dhe arrihet të verifikohet se ata janë pronarët e ligjshëm të tokës, atëherë do të kryhet pagesa e kompensimit nga kjo llogari bankare.

Së fundmi, marrja e përkohshme e tokës i referohet marrjes së përkohshme me qira të tokës gjatë periudhës së ndërtimit për të paktën një vit. Projekti do të marrë me qira gjatë fazës së ndërtimit dy parcela toke ngjitur me Parkun PV. Projekti do hyjë në një marrëveshje qiraje me pronarin sipas Normave të Projektit.

8.2 Përgatitja e Dosjeve Familjare

Projekti do të përgatisë Dosjet e Familjeve, bazuar në informacionin e mbledhur në anketat e aseteve (toka, ferma dhe të korrat) dhe anketat socio-ekonomike, dhe vlerat e kompensimit bazuar në Matricën e Kompensimit.

Dosjet e familjeve do të përfshijnë informacionin e mëposhtëm për çdo familje:

1. Pronari dhe bashkëshortja (ose çdo anëtare tjetër femër përfaqësuese e familjes)

2. Harta e rilevimit kadastral
3. Harta e tokës së prekur (për blerje të përhershme të tokës)
4. Inventari i asetëve (toka, ferma dhe të korrat)
5. Vlerësimi agronomik para projektit
6. Detajet e ofertës së kompensimit, në lidhje me blerjen e përhershme të tokës, marrjen e përkohshme të tokës, ose aksesimin e përkohshëm në tokë, humbjen e kulturave bujqësore/pemëve sipas rastit; dhe
7. E drejta e përfitimit për programe specifike të mjeteve të jetesës.

Kini parasysh se Dosjet e Familjeve do të përfshijnë vlerat e detajuara të kompensimit për blerjen e përhershme të tokës, bazuar në sipërfaqen e tokës që do të blihet. Çdo kompensim për të korrat do të jetë tregues. Kompensimi përfundimtar i të korrave do të llogaritet si pjesë e procesit të daljes nga toka dhe rikthimit të tokës, kur dihet ndikimi përfundimtar në të mbjellat (bazuar në atë që është mbjellë në kohën e ndërtimit dhe shtrirjen e ndikimeve).

8.3 Përgatitja & Prezantimi i Ofertave

Detajet e ofertës së kompensimit për familje, së bashku me masat shtesë të ndihmës, do t'i paraqiten familjes së prekur nga projekti me shkrim. Aty ku është e mundur, kjo do të paraqitet si pjesë e një takimi ballë për ballë me familjen (kryefamiljari dhe bashkëshorti, ose çdo anëtare tjetër femër e familjes), në mënyrë që të sigurohet një proces gjithëpërfshirës i marrëveshjes vullnetare (shih më poshtë) krahas procedurave të shpronësimit që duhen ndjekur. Aty ku nuk është e mundur takimi ballë për ballë, do të tentohet kontakti me telefon. Nëse kjo nuk arrihet, oferta do t'i dërgohet familjes së prekur nga Projekti me postë, duke e informuar në detaje edhe për hapat e radhës.

Procesi i prezantimit të ofertave do të bëhet duke respektuar ndjeshmërinë gjinore, duke u siguruar që bashkëshortët dhe çdo anëtare tjetër femër e familjes të jenë mjaft të angazhuar.

8.4 Procesi i Marrëveshjes Vullnetare me Familjet

Procesi i angazhimit të palëve të interesuara i detajuar në seksion 6, do të sigurojë që familjet e prekura të jenë sensibilizuar dhe informuar në lidhje me procesin e aksesit dhe blerjes së tokës, duke përfshirë udhëzuesin për blerjen dhe kompensimin e tokës (GLAC), përpara përgatitjes dhe lëshimit të Ofertave.

Gjatë lëshimit të ofertës për PAH, procesi do të shpjgohet plotësisht dhe do të ketë një mundësi fillestare që PAH të kërkojë sqarime për çdo aspekt. Pas kësaj, për blerjen e përhershme të tokës, PAH-ve do t'u jepet një periudhë prej dy javësh për të shqyrtuar ofertën, për të kërkuar sqarime të mëtejshme dhe/ose për të kërkuar këshilla ligjore. Një linjë telefonike e dedikuar dhe Zyrtari Ndërlidhës i Komunitetit të Projektit (CLO), do të jenë në dispozicion për t'iu përgjigjur pyetjeve. Çështjet gjinore dhe shqetësimet e grave do të vëzhgohen gjatë gjithë këtij procesi.

Pas periudhës dy javore, do të bëhet një vizitë e mëtejshme në PAH. Nëse PAH është i kënaqur me ofertën, ajo nënshkruhet në prani të një dëshmitari. Nëse PAH nuk është i kënaqur, mund të zhvillohen diskutime të mëtejshme dhe të ofrohen sqarime. Pas kësaj, PAH do t'i jepet një javë tjetër për të shqyrtuar ofertën.

Pas shqyrtimit të mëtejshëm nga PAH, nëse ata nuk dëshirojnë të nënshkruajnë ofertën, do të nënshkruhet një procesverbal mosmarrëveshjeje dhe procesi i negociatave do të konsiderohet i pasuksesshëm dhe do të ndiqen procedurat e shpronësimit. Këto procedura do t'i shpjgohen plotësisht PAH, siç përshkruhet në Seksionin 8.5 më poshtë.

Projekti do të bëjë përpjekjet më të mira që Letra e Ofertës të nënshkruhet si nga kryefamiljari ashtu edhe nga bashkëshorti/bashkëshortja (ose një përfaqësuese femër e familjes), duke garantuar një proces transparent brenda njësisë familjare, dhe që bashkëshortja apo një përfaqësuese femër e familjes të luajë një rol domethënës në vendimmarrjen përfundimtare. Pasi FPP-ja të nënshkruajë

Letrën e Ofertës, projekti do të këshillojë PAH mbi dokumentacionin e kërkuar për të përgatitur nënshkrimin e marrëveshjes së qirasë, apo transferimin e pronësisë. Do të përzgjidhen noterë vendas për të ndihmuar në nënshkrimin e kontratave.

Aty ku PAH nuk është në gjendje të sigurojë dokumentacionin e nevojshëm (p.sh. dokumentet e pronësisë), Projekti do të ndihmojë në gjetjen e dokumenteve të pronësisë kur ato ekzistojnë, ose do të ndihmojë me procesin e regjistrimit. Kur nuk ka prova të mjaftueshme të pronësisë, mund të jetë e nevojshme të ndiqet procedura e shpronësimit dhe të mbahet kompensimi në ruajtje derisa çështja të zgjidhet.

Në bazë të eksperiencës së deritanishme me procesin e Marrëveshjeve Vullnetare, ka shumë të ngjarë që pothuajse të gjitha familjet të mos jenë në gjendje të sigurojnë dokumentacion të mjaftueshëm që kërkohet për Marrëveshjen Vullnetare. Voltalia u angazhua me familjet dhe i mbështeti ato në marrjen e dokumentacionit të nevojshëm për marrëveshjet vullnetare, por pas pothuajse dy muajsh asnjë familje nuk arriti të siguronte dokumentacionin e nevojshëm. Si rrjedhojë, do të përdoret procesi i shpronësimit për të gjitha parcelat që preken nga marrja e përhershme e tokës. Projekti do i njoftojë ato familje që janë subjekt i procesit të marrëveshjeve vullnetare por me dokumentacion të pamjaftueshëm të pronësisë, se për to do të ndiqet procesi i shpronësimit. Kjo është kritike për të shmangur vonesa në marrjen e lejeve dhe licencave për ndërtimin e projektit. Megjithatë, në mënyrë që të mos disavantazohen familjet që janë subjekt i procesit të marrëveshjeve vullnetare, Voltalia do të ndërmarrë Marrëveshje Kompensimi me këto familje, siç detajohet në seksionin 8.6 më poshtë.

8.5 Procedurat e shpronësimit

Siç u përmend më lart, nëse PAH mungon ose është i paidentifikuar, refuzon një marrëveshje vullnetare, apo Voltalia dhe familja nuk janë në gjendje të sigurojnë dokumentet e nevojshëm të pronësisë në kohë, do të ndiqen procedurat e shpronësimit, siç përshkruhet në këtë seksionin.

Gjithashtu, Voltalia do të vërë në dispozicion të Agjencisë Shtetërore të Shpronësimit të gjithë dokumentacionin e pronësisë për të lehtësuar procesin e shpronësimit.

Menaxhimi i propozuar i procesit të negociatave në përputhje me procesin e shpronësimit të mandatuar ligjërisht, është përshkruar më poshtë.

TABELA 8.1: PROCESI I NEGOCIMIT DHE SHPRONËSIMIT

Procesi i Marrëveshjes Vullnetare	Procesi i shpronësimit
Hapi 1: Angazhimi i palëve të interesuara me PAH për t'i informuar ata për aksesin dhe procesin e blerjes së tokës përpara fillimit të procedurave të shpronësimit (përfshirë GLAC)	Nuk ka filluar
Hapi 2: Takime përditësuese me PAH për t'i informuar për procedurat e afërta të shpronësimit dhe çfarë të presin (p.sh. letrën e shpronësimit, plus vizitën nga personeli i projektit)	Hapi 1: Kërkesa për shpronësim e paraqitur nga OST në ASHSH (nën mbikëqyrjen e Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë)
	Hapi 2: ASHSH merr <u>dosjen nga Departamenti i Shpronësimit të OST-së ("Aplikanti")</u>

Procesi i Marrëveshjes Vullnetare	Procesi i shpronësimit
	<p>Hapi 3: ASHSH krijon një Komision të Posaçëm Shpronësimi dhe përcakton vlerën e kompensimit që do t'u paguhet personave të prekur</p>
<p>Hapi 3: Vizita fillestare në PAH me letrën e ofertës, duke përfshirë detajet e masave shtesë të ndihmës dhe shpjegimin e procesit</p> <p>Hapi 4: Të paktën dy takime vijuese me PAH-të dhe diskutime të vazhdueshme, me synimin për të siguruar marrëveshje të negociuar</p>	<p>Hapi 4: Nëse plotëson kriteret, ASHSH miraton Planin e Shpronësimit dhe njofton OST-në dhe pronarët e tokave. Pronarët e tokave kanë dy mundësi: 1) Marrëveshje vullnetare. Pronari i tokës dhe ASHSH kanë 10 ditë kohë për të nënshkruar një marrëveshje (në çdo rast jo më vonë se 30 ditë) 2) Nuk bie dakord për marrëveshje vullnetare. Të tretët e interesuar mund të paraqesin kërkesë brenda 15 ditëve nga botimi në Fletoren Zyrtare (një veprim i tillë juridik nuk pezullon procesin e shpronësimit)</p>

Procesi i Marrëveshjes Vullnetare	Procesi i shpronësimit
<p>Hapi 5: Nënshkrimi i procesverbalit të mosmarrëveshjes dhe procedurat e shpronësimit të ndjekura në rast mosmarrëveshjeje</p> <p>Nëse FPP-ja mungon ose është i paidentifikuar, ose familja dhe Voltalia nuk janë në gjendje të sigurojnë dokumentet e nevojshme të pronësisë në kohë, atëherë do të ndiqen procedurat e shpronësimit.</p>	<p>Hapi 5: Projektvendimi i shpronësimit mund t'i dërgohet Këshillit të Ministrave vetëm pas kalimit të një afati 30 ditor nga momenti i njoftimit të shpronësimit tek pronarët dhe botimi i shpronësimit në Fletoren Zyrtare.</p> <p>Hapi 6: Pas miratimit, Këshilli i Ministrave e transferon dhe e regjistron pronësinë në Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme (ZRPP). Marrëveshjet e kompensimit të nënshkuara me pronarin e tokës duhet të vendosen pas publikimit të vendimit nga KM. Pagesa e kompensimit do të sigurohet në një llogari ruajtjeje deri në transferimin efektiv të pronave (pas marrëveshjes ndërmjet OST-së dhe pronarit të tokës).</p> <p>OST do të nënshkruajë marrëveshjen për kalimin e pronave/titujve të pronësisë pasi OST të bëhet pronare e tokave</p>

8.6 Marrëveshjet e Kompensimit

Për të gjitha familjet që janë subjekt i procesit të marrëveshjes vullnetare të cilat nuk mund të sigurojnë dokumentacionin e nevojshëm për përmbylljen e kontratave dhe që duhet të kalojnë në procedurat e shpronësimit, Voltalia do të hyjë në një Marrëveshje Kompensimi të Projektit. Kjo marrëveshje merr për sipër t'i ofrojë familjeve shumën e plotë të kompensimit për blerjen e përhershme të tokës.

Çertifikata e Pronësisë do të jetë dokumenti i preferuar për nënshkrimin e marrëveshjeve të kompensimit, dhe projekti do të bëjë përpjekjet më të mira në mbështetjen e familjeve për marrjen e dokumentit para hyrjes në tokë. Megjithatë, në mënyrë që të sigurohet kompensimi para ndikimit real, projekti mund të vendosë që të kërkojë vetëm një AMTP dhe dokumente të tjera mbështetëse që vërtetojnë pronarin e ligjshëm të tokës në momentin e hyrjes në tokë.

Për Aksesimin e Përkohshëm të Tokës dhe kompensimin e të mbjellave, do të nënshkruhet një Deklaratë Kompensimi. Për kompensimin e të mbjellave nuk do të kërkohet dokument zyrtar nga përdoruesi, ndërsa për pronarin do të kërkohet të paktën një AMTP.

Ashtu si me Letrën e Ofertës më sipër, Projekti do të bëjë përpjekjet më të mira që Marrëveshja e Kompensimit të Projektit dhe Deklarata e Kompensimit të nënshkruhen si nga kryefamiljari ashtu edhe nga bashkëshortja (ose një përfaqësuese femër e familjes), duke garantuar një proces transparent brenda njësisë familjare. Si pjesë e nënshkrimit, familja do të marrë përgjegjësinë ligjore në sigurimin e ndarjes së shumës së kompensimit sipas strukturës së pronësisë së familjes dhe të drejtat e anëtarëve të familjes mbi tokën.

Pavarësisht Marrëveshjes së Kompensimit të Projektit, të gjitha familjet do të kenë të drejtë të përfitojnë edhe pagesat e shpronësimit pas përfundimit të procesit të shpronësimit dhe nëse sigurojnë

dokumentet e nevojshme të pronësisë. Voltalia do vazhdojë t'i mbështesë familjet ku është e mundur në marrjen e dokumenteve të nevojshme.

Projekti ka bërë ndryshime në projektimin e linjës OHL për të minimizuar ndikimet aq sa është e mundur, por akoma ka familje që refuzojnë bashkëpunimin. Ato familje që kanë refuzuar të hyjnë në Marrëveshje Vullnetare mund të shfrytëzojnë mundësinë që të hyjnë në Marrëveshje Kompensimi me Projektin. Pas vendimit të shpronësimit nga qeveria, Voltalia do i informojë familjet refuzuese rreth hapave të mëtejshëm dhe do i ri-ftojë ato që të pretendojnë shumën e kompensimit të projektit. Shpronësimi i përkohshëm do të përdoret në rastet kur pronari kundërshton aksesimin e tokës.

Gjithashtu, Voltalia do të vërë në dispozicion të Agjencisë Shtetërore të Shpronësimit të gjithë dokumentacionin e pronësisë për të lehtësuar procesin e shpronësimit.

8.7 Pagesa e Kompensimit

Pagesa do të bëhet sa më të shpejtë që të jetë e mundur pasi të arrihet një marrëveshje (Marrëveshje Vullnetare ose Marrëveshje Kompensimi për Blerjen e Përhershme të Tokës, Deklaratë Kompensimi për Aksesimin e Përkohshëm të Tokës dhe kompensimin e të mbjellave, dhe Marrëveshje Qiraje për Marrjen e Përkohshme të Tokës) para hyrjes në tokë dhe aktiviteteve të ndërtimit. Do të përcaktohet një korridor ndërtimi gjatë Hyrjes në Tokë, duke lejuar kështu pagesën e qerasë së tokës dhe kompensimin e të mbjellave përpara ndërtimit. Në rastet kur ka dëme aksidentale apo të paparashikuara të të mbjellave, pagesa do të kryhet pas Daljes nga Toka dhe Dorëzimi. Aktivitetet e ndërtimit nuk pritet të shkaktojnë ndikime të dukshme në pemët frutore. Prandaj, korridori i ndërtimit nuk do të aplikohet për bimët shumëvjeçare, dhe kompensimi do të kryhet pas daljes nga toka duke u bazuar në ndikimet reale mbi pemët.

Kompensimi për blerjen e përhershme të tokës do të paguhet me një këst në Lek në llogarinë bankare të përcaktuar nga Familja e prekur nga projekti dhe e identifikuar në marrëveshjet e kompensimit. Kjo llogari bankare duhet të jetë një llogari e përbashkët bankare, duke përfshirë edhe bashkëshorten ose përfaqësuesen femër të familjes. Në rast se përfituesit nuk kanë një llogari bankare, ata do të mbështeten në hapjen e një llogarie të përbashkët bankare për kryefamiljarin dhe bashkëshorten, ose anëtarin femër të familjes. Kur vlerat e kompensimit nuk janë të konsiderueshme (p.sh. në rastet e qirasë së tokës që preket nga linja OHL apo kompensimi i të mbjellave) dhe/ose familja nuk dëshiron të operojë një llogari bankare, mund të lëshohet një çek në emër të kryefamiljarit dhe bashkëshortes, që tregon se kompensimi në para duhet të drejtohet për aktivitete të ndërlidhura, dhe se kjo do të jetë subjekt i monitorimit nga Projekti.

Pronarit të tokës do t'i kërkohet që të lirojë, ose ta vërë tokën në dispozicion, një javë pas pagesës. Pas kësaj periudhe, Projekti do të ketë të drejtën të hyjë në tokë nëse është e nevojshme.

Në rastin e Aksesimin e Përkohshëm të Tokës dhe Marrjes së Përkohshme të Tokës, Vlerësimi Agronomik Para Projektit bashkë me vlerësimet e Hyrjes në Tokë, do të përdoret për të rënë dakord me pronarin dhe bashkëshorten (ose përfaqësuesen femër të familjes) për gjendjen bazë të tokës përpara fillimit të punës. Kompensimi i kulturave bujqësore do të llogaritet si pjesë e procesit të daljes nga toka dhe dorëzimit të saj te pronari. Kompensimi për kulturat bujqësore do të paguhet me një këst në Lek në llogarinë bankare të përcaktuar nga Familja e prekur nga projekti dhe e identifikuar në marrëveshjet e kompensimit. Kjo llogari bankare duhet të jetë një llogari e përbashkët bankare, duke përfshirë edhe bashkëshorten ose përfaqësuesen femër të familjes.

8.8 Hyrja në Tokë

Si pjesë e Protokollit të hyrjes në tokë që do të ndiqet nga Kontraktori i Ndërtimit (EPC), pronari/përdoruesi i tokës do të nënshkruajë një formular për hyrjen në tokë përpara fillimit të ndërtimit. Kjo do të përfshijë detajet e pronarit të tokës dhe të përdoruesit të saj, një regjistrim të kulturave bujqësore ekzistuese në zonën e prekur (korridori i ndërtimit) dhe çdo aset tjetër të prekur nga projekti,

i cili do të kompensohet sipas normave të Projektit. Formulari i hyrjes në tokë do të shoqërohet me fotografi. Formulari do të nënshkruhet nga pronari dhe/ose përdoruesi i tokës, kontraktori dhe përfaqësuesi i Voltalia, normalisht Koordinatori për Marrëdhëniet me Komunitetin. Një kopje e formularit të hyrjes në tokë do t'i jepet pronarit/përdoruesit të tokës.

Aty ku pronarët dhe përdoruesit e tokave identifikohen vetëm për herë të parë gjatë hyrjes në tokë, do të ndërmerret gjithashtu një studim i shpejtë socio-ekonomik i familjeve. Në rast konflikti në identifikimin e pronarëve ose përdoruesve, do të kryhet një proces verifikimi me dëshmitarë (pronarët/përdoruesit e parcelave fqinje, kryepleqtë e fshatrave, etj.). Çdo pagesë për kompensim do të mbahet në ruajtje në pritje të përcaktimit të pronësisë së tokës ose aseteve (kulturave bujqësore).

Në rastet e tokave private ku si pronarët ashtu edhe përdoruesit mungojnë ose janë të paidentifikuar, formulari i Hyrjes në Tokë do të nënshkruhet nga Kontraktori, një përfaqësues i Voltalias dhe mundësisht një dëshmitar. Vlera e kompensimit do të mbahet në ruajtje në një llogari bankare në pritje të prezantimit të pronarit/përdoruesit të tokës apo aseteve të prekura (të mbjellat).

8.9 Dalja nga Toka & Dorëzimi te Pronari

Si pjesë e Protokollit të Daljes nga Toka që do të ndiqet nga Kontraktori i Ndërtimit (EPC), pronari/përdoruesi i tokës do të nënshkruajë një formular për rikthimin e tokës në gjendjen e mëparshme dhe për daljen nga toka. Ky formular do të përfshijë një regjistër të llojit dhe sasisë përfundimtare të kulturave bujqësore dhe aseteve të tjera të prekura. Ndikimet shtesë apo aksidentale në të mbjellat që ndodhin pas Hyrjes në Tokë do të kompensohen sipas normave të projektit.

Pronari i tokës / fermeri do të konfirmojë që toka është rikthyer në kushtet e para projektit. Një objektivi kryesor do të jetë kthimi i tokës në kushtet para projektit dhe sigurimi i kthimit në kohë të tokës tek pronari i tokës. Rikthimi i tokës në kushtet e mëparshme do të verifikohet si nga inxhinierët e projektit ashtu edhe nga agronomi i projektit, sipas kriterëve të përcaktuara. Kur kërkohen punë shtesë, këto do t'i raportohen përsëri kontraktuesit.

Pasi të përfundojë rikthimi i tokës në kushtet e mëparshme, Projekti do të nënshkruajë Formularin e Rikthimit të Tokës në Kushtet e Mëparshme dhe Daljes nga Toka me pronarin/përdoruesin e tokës. Formulari do të nënshkruhet nga pronari dhe/ose përdoruesi i tokës, kontraktori dhe përfaqësuesi i Voltalia, normalisht Koordinatori për Marrëdhëniet me Komunitetin. Një kopje e Formularit të Rikthimit të Tokës në Gjendjen e Mëparshme dhe Daljes nga Toka do t'i jepet pronarit/përdoruesit të tokës.

9 PLANI I RIKUPERIMIT TË JETESËS

9.1 Masat për rikuperimin e jetesës

Duke pasur parasysh llojet e ndikimeve të identifikuar të projektit, ndikimin e projektit tek jetesa pritet të jetë i lehtë, duke pasur parasysh:

1. shtrirjen e kufizuar të blerjes së përhershme të tokës
2. natyrën e përkohshme dhe shumë të shkurtër të aksesit të përkohshëm në tokë gjatë ndërtimit.

Megjithatë, kur ka një ndikim të rëndësishëm në çdo parcelë ferme të prekur, ose kur familja mund të jetë vulnerabël, mund të kërkohet ndihmë shtesë për të siguruar kthimin në kohë në bujqësi dhe rikuperimin efektiv të produktivitetit. Më tej, Projekti do të përpiqet të marrë masa që aty ku një pjesë e parcelave të fermës është e ndikuar nga blerja e përhershme e tokës, parcela e mbetur të rikuperohet në mënyrë që të prodhohet në nivelet e para projektit.

Për të arritur sa më sipër, masat e Projektit për rikuperimin e jetesës fokusohen tek:

1. Rikthimi i parcelës në gjendjen e mëparshme (shih nënseksionin 9.1.1 Rikthimi i parcelës në gjendjen e mëparshme)
2. Këshilla bujqësore dhe inpute shtesë 'sipas nevojës' (Shih nënseksionin 9.1.2 Këshilla dhe inpute bujqësore)
3. Monitorimi i Bujqësisë (shih nënseksionin 9.1.3 Monitorimi Bujqësor dhe Vizitat Përmbyllëse)
4. Asistenca Tranzicionale për Familjet në nevojë (Shih seksionin 9.2 Vështirësitë e përkohshme dhe familjet vulnerabël).

9.1.1 Rikthimi i parcelës në gjendjen e mëparshme

Pas zënies së përkohshme të tokës gjatë ndërtimit, një objekt kyç do të jetë kthimi i tokës në kushtet para projektit dhe sigurimi i kthimit në kohë të tokës tek pronari i tokës.

Kontraktori i ndërtimit do të sigurojë që të ndërmerren aktivitetet e mëposhtme pas ndërtimit:

1. kthimi i kontureve origjinale
2. dheu i sipërm që është hequr dhe ruajtur veçmas, të vendoset përsëri në tokat e prekura
3. rindërtimi i infrastrukturës së kullimit të tokës, rrugëve të dëmtuara të aksesit dhe/ose rrjeteve dhe objekteve të tjera, të cilat janë dëmtuar ose zhvendosur gjatë ndërtimit.

Një agronom i Projektit do të këshillojë kontraktorin e ndërtimit për rikthimin e gjërave në gjendjen e mëparshme, bazuar në karakteristikat e parcelës, duke ditur se rikthimi efektiv i parcelës në gjendjen e mëparshme është çelësi për rivendosjen në kohë të aktiviteteve bujqësore dhe produktivitetit. Rikthimi i tokës në kushtet e mëparshme do të verifikohet si nga inxhinierët e projektit ashtu edhe nga agronomi i projektit, sipas kritereve të përcaktuara. Aty ku kërkohen punë shtesë, këto i raportohen kontraktuesit. Pasi të përfundojë rikthimi në gjendjen e mëparshme, Projekti do të nënshkruajë një Formular për Rikthimin dhe Dorëzimin e Tokës te pronari i saj.

9.1.2 Këshilla dhe inpute bujqësore

Pas rikthimit të tokës në gjendjen e mëparshme, agronomët e projektit do të ndërmarrin vizita pasuese tek çdo fermer për t'i këshilluar mbi metodat bujqësore për të siguruar rikthimin e produktivitetit dhe, në rastin më të mirë, për të bërë edhe përmirësime. Kjo mund të përfshijë këshilla në lidhje me praktikën e rekomanduara agronomike, p.sh. plugimin dhe mbjelljen e kulturave bujqësore specifike për të nxitur rikuperimin e tokës.

Në disa raste, rekomandimet e agronomit mund të përfshijnë sigurimin e inputeve si plehurat. Në raste të tilla, inputet do të sigurohen nga Projekti. Megjithatë, këto do të sigurohen vetëm në bazë të kërkesave të vlerësuara agronomike, dhe jo si një e drejtë e përgjithshme. Këshillat bujqësore dhe inputet e kërkuara do të marrin në konsideratë teknikat bujqësore të përdorura tashmë nga fermerët (shih seksionin ku raportohet se pothuajse të gjithë fermerët përdorin tashmë pesticide, plehra dhe farëra të përmirësuara për aktivitetet e tyre bujqësore).

9.1.3 Monitorimi Bujqësor dhe Vizitat Përmbyllëse

Për ato parcela të identifikuar se kërkojnë inpute ose veprime shtesë, një vizitë vijuese do të bëhet nga agronomët e projektit pas afërsisht 6 muajsh. Kjo vizitë do të përdoret për të konfirmuar se produktiviteti është rikthyer dhe për të ofruar çdo këshillë të mëtejshme agronomike.

9.2 Vështirësitë e përkohshme dhe familjet vulnerabël

Standardet Ndërkombëtare i përkufizojnë grupet vulnerabël si njerëz të cilët, për shkak të identitetit gjinor, përkatësisë etnike, moshës, paaftësisë, disavantazhit ekonomik ose statusit social mund të ndikohen më negativisht nga ndikimet e projektit sesa të tjerët dhe të cilët mund të jenë të kufizuar në aftësinë e tyre për të pretenduar ose për të pasur përfitime nga projekti. Individët dhe/ose grupet vulnerabël mund të përfshijnë edhe njerëz që jetojnë nën kufirin e varfërisë, personat pa tokë, të moshuarit, familjet që kanë kryefamiljar gratë apo fëmijët, refugjatët, personat e zhvendosur brenda vendit, pakicat etnike, komunitetet e varura nga burimet natyrore ose persona të tjerë të zhvendosur që mund të mos jenë të mbrojtur sipas ligjit kombëtar dhe/ose ndërkombëtar. Grupe të tilla vulnerabël duhet të identifikohen herët në procesin e projektit. Projekti duhet të ndërmarrë veprimet e nevojshme për të siguruar që grupet vulnerabël të mos jenë në disavantazh në proces, të jenë plotësisht të informuar dhe të ndërgjegjshëm për të drejtat e tyre dhe të jenë në gjendje të përfitojnë në mënyrë të barabartë nga mundësitë dhe përfitimet e Projektit.

9.2.1 Përcaktimi i cënueshmërisë

Cënueshmëria mund të shihet në kontekstin e dy fazave:

1. Cënueshmëri para-ekzistuese
2. Cënueshmëria e vështirësive tranzicionale, e shkaktuar nga zhvendosja ekonomike e lidhur me projektin.

Cënueshmëria paraekzistuese është cënueshmëria që ndodh, me ose pa zhvillimin e projektit, ndërsa cënueshmëria tranzicionale e vështirësive ndodh si rezultat i pamundësisë së atyre që preken drejtpërdrejt nga Projekti të përshtaten me kushtet e reja për shkak të tronditjes ose stresit në lidhje me aktivitetet e projektit.

Projekti është shumë i interesuar për shmangien ose zbutjen e cënueshmërisë së shkaktuar prej tij. Përveç kësaj, është e rëndësishme të qenit të vetëdijshëm për dobësitë para-ekzistuese. Këto familje mund të jenë më pak në gjendje për t'u përballur me goditjet e zhvendosjes, ose mund të kenë nevojë për ndihmë shtesë për t'u angazhuar në mënyrë efektive me Projektin, për të kuptuar të drejtat e tyre dhe për të marrë ndihmën e mundshme.

Blerja e pavullnetshme e tokës dhe zhvendosja ekonomike, nëse nuk menaxhohet mirë, mund të rrisë varfërimin, duke qenë se këto familje janë veçanërisht të ndjeshme ndaj efekteve negative të aktiviteteve të Projektit. Rreziqet kryesore që çojnë në varfërim si rezultat i drejtpërdrejtë i procesit të aksesit dhe zhvendosjes së tokës janë:

1. Të mbeturit pa tokë – humbja e pazëvendësueshme e aseteve të tokës, duke përfshirë edhe pronësinë e përbashkët

2. Papunësia - humbja e vendeve të punës (të përkohshme ose të përhershme)
3. Rënie e përgjithshme ekonomike
4. Pasiguria ushqimore dhe kequshqyerja
5. Humbja e aksesit në asetet e përbashkëta.

Kompensimi i projektit, i kombinuar me masat shtesë të jetesës, do të jenë mekanizmat kryesorë për të adresuar ndikimet e projektit. Megjithatë, aty ku identifikohen familjet vulnerabël, do të zhvillohen mbështetje shtesë kalimtare sipas nevojës, si gjatë planifikimit të projektit, ashtu edhe në periudhat e ndërtimit dhe pas ndërtimit.

9.2.2 Identifikimi i familjeve të cënueshme

Cënueshmëria do të përcaktohet në baza familjare. Identifikimi i familjeve të cënueshme është duke u përcaktuar përmes angazhimeve të palëve të interesuara, dhe në bazë të analizës së aseteve dhe anketave socio-ekonomike. Familjet e cënueshme mund të identifikohen gjithashtu nga Zyrtarët Ndërlidhës të Komunitetit të Projektit (CLO) dhe personeli tjetër. Përveç kësaj, të dhënat do të sigurohen duke u konfirmuar me tre burime përmes ndërlidhjes me departamentet lokale të mirëqenies sociale, OJQ-të dhe personat e tjerë kyç.

Një vlerësim fillestar i rrezikut të cënueshmërisë u ndërmor për të identifikuar familjet potencialisht të cënueshme për t'u përfshirë në një 'listë vëzhguese të cënueshmërisë'. Vlerësimi i rrezikut përbëhet nga kritere të ponderuara, të cilat marrin parasysh:

1. Ndikimin e projektit: Niveli i ekspozimit ndaj ndikimeve negative (p.sh., pjesa e parcelës së tyre të prekur)
2. Rezistenca e Familjes: Kapaciteti për t'u përshtatur me ndryshimin ose për t'u përballur me stresin ekonomik (p.sh., mbështetja në bujqësinë e jetesës dhe mungesa e burimeve të tjera të të ardhurave)
3. Cënueshmëria paraekzistuese: Ndjeshmëria ndaj rrezikut.

Kriteret e vlerësimit të rrezikut dhe ponderimi janë paraqitur më poshtë.

TABELA 9.1: VLERËSIMI I RREZIKUT TË CËNUESHMËRISË

Faktori	Treguesit e Vlerësimit të Riskut	Ponderimi	PAHs
Ndikimi i projektit (50%)	Projekti që prek > 20% të totalit të tokave	50	6
Rezistenca e familjes (20%)	Të ardhurat e familjes afër (+20%) kufirit kombëtar të varfërisë (5 dollarë në ditë)	10	44
	Familja mbështetet në mënyrë të konsiderueshme (>50%) në parcelën e prekur për jetesë/të ardhura	10	21
Cënueshmëri para-ekzistuese (30%)	Kryefamiljari/ofruesi kryesor i të ardhurave i papunë	5	3
	Kryefamiljare mbi 65 vjeç	5	45
	Familjet që jetojnë në kushte shumë të këqija banimi	5	10
	Kryefamiljari ose anëtari me paaftësi fizike/mendore	5	9

	Kryefamiljari ose anëtari me sëmundje kronike	5	35
	Kryefamiljare Femër me mbështetje të kufizuar	5	4

'Lista Vëzhguese e Vulnerabilitetit' ka rezultuar në identifikimin e 17 familjeve në nevojë. Identifikimi është bërë duke ndjekur kriteret e cënueshmërisë të përcaktuara në tabelën e mësipërme (Tabela 9.1) dhe peshimin e secilit kriter cënueshmërie. Midis familjeve të anketuara ka 7 PAH me faktorë rreziku të rëndë jetese dhe 10 PAH me cënueshmëri të moderuar ndaj varfërisë. PAH-të përfshiheshin në 'Listën Vëzhguese të Vulnerabilitetit' në rastet kur rezultati i ponderimit ishte më shumë se 25. Një cënueshmëri e rëndë është regjistruar për rezultatin e ponderimit prej më shumë se 55. Kjo është bazuar në shpërndarjen statistikore, duke ndjekur metodologjinë e përdorur për studimet e shpërndarjes së varfërisë të kryera nga Banka Botërore¹⁴.

Pas zhvillimit të 'Listës Vëzhguese të Vulnerabilitetit', do të ndërmerren angazhime të mëtejshme me familjet e identifikuara për të konfirmuar / kontrolluar familjet për ndihmë të mëtejshme dhe 'Lista e Vëzhgimit të Vulnerabilitetit' do të përditësohet në përputhje me rrethanat. Familjet vulnerabël të identifikuara përfundimtare do të përcaktohen si 'familje kryesisht bujqësore' dhe familje jo-bujqësore. Familjet kryesisht fermere ka të ngjarë të përfitojnë nga ndihma bujqësore shtesë për të rivendosur produktivitetin, ndërsa familjet jo-bujqësore (p.sh., ato të pensionuara dhe të paafta për t'u marrë me bujqësi) mund të përfitojnë nga mbështetje të tjera të përshtatura si aksesit/lidhjet me mbështetjen e shëndetit dhe strehimit.

9.2.3 Ndihma e mundshme / Mbështetje Tranzicionale

Mbështetja për familjet e identifikuara të cënueshme mund të kërkohe në tre faza kritike:

1. Para ndërtimit
2. Ndërtimi
3. Pas ndërtimit.

Gjatë planifikimit të projektit para ndërtimit, familjet e cënueshme mund të jenë më të izoluara nga ana sociale dhe mund të mos jenë të vetëdijshme për planet e projektit dhe mund të mos kenë qenë aq në gjendje të marrin pjesë në takime publike si pjesë e procesit të VNMS-së. Angazhimi i palëve të interesuara me familjet e prekura drejtpërdrejt do të bëjë përpjekje të veçanta për t'u takuar me familjet e identifikuara vulnerabël nga 'lista vëzhguese'. Projekti dhe proceset e aksesit në tokë, kompensimit dhe mbështetjeve shtesë, do t'u shpjegohen atyre, me mbështetje të jashtme shtesë sipas nevojës.

Gjatë ndërtimit, do të bëhen përpjekje të veçanta për përditësimin e vazhdueshëm të familjeve vulnerabël mbi procesin dhe kohëzgjatjen e mundshme të punimeve.

Gjatë dhe pas ndërtimit, mund të zhvillohen paketa ndihme kalimtare për familjet e prekura, të cilat mund të përfshijnë kupona ushqimore dhe lidhje me mbështetjen e shtetit. Çdo ndihmë do t'u përshtatet nevojave të familjes së prekur dhe e kufizuar në kohë, me strategji të qarta daljeje.

¹⁴ <https://openknowledge.worldbank.org/handle/10986/21355>

10 MBROJTJA E TRASHËGIMISË KULTURORE

10.1 Vlerësimi i Trashëgimisë Kulturore (TK)

Bazuar në literaturën e disponueshme të botuar (p.sh., faqja e internetit të Institutit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore), rezultatet e studimit në terren të TK të projektit "Zona e Re e Zhvillimit në Njësinë Administrative Rremas dhe Libofshë", dhe informacione nga takimet e palëve të interesuara (p.sh., komunitetet lokale, bashkitë, etj.), nuk ka asete të rëndësishme të trashëgimisë kulturore në zonën e Projektit (përfshirë Parkun PV dhe trasenë e propozuar të OHL-së). Informacioni i mbledhur dhe të dhënat historike tregojnë gjithashtu se ka një potencial të ulët për zbulimin e trashëgimisë kulturore të panjohur gjatë procesit të ndërtimit.

Nga zbulimi në terren i kryer nga eksperti i TK si pjesë e procesit të VNMS-së u zbuluan edhe trakte të lëna nga kanalet kulluese (tulla kulluese me 6 kënde dhe fragmente të tyre), kamina për prodhimin e tullave dhe tjegullave të kohës së kooperativës, qeramikë për mbajtjen e ujit. Gjatë punës dhe grumbuj mbeturinash nga vende dhe lokale të ndryshme (shishe birre, pjata para viteve '90, stenda televizive, mbeturina ndërtimi etj.), dhe bunkerë të madhësive të ndryshme apo mbeturina bunkerit.

Vlen të përmendet se vizitat e fundit në terren në kantierin e parkut PV kanë identifikuar dy bunkerë luftarë. Neni 51 i ligjit 27/2018 për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë e Shqipërisë, tregon se bunkerët do të konsiderohen pasuri kulturore të prekshme nën mbrojtje të veçantë me përcaktimin. Sipas ekspertit të TK-së të angazhuar si pjesë e procesit të VNMS-së, këta bunkerë të periudhës komuniste nuk klasifikohen si objekte arkeologjike apo objekte me ndonjë vlerë të veçantë të trashëgimisë kulturore dhe për këtë arsye nuk parashikohet që të ketë rreziqe nga prania e tyre brenda zonave ose edhe heqja (nëse është e nevojshme) gjatë fazës së ndërtimit. Figura 10.1 më poshtë tregon një nga bunkerët e gjetur në kantierin e parkut PV.

FIGURA 10.1: BUNKERI I GJETUR NË KANTIERIN E PARKUT PV



Vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet aseteve të TK të klasifikuara dhe të paklasifikuara (monumente historike, mbetje arkeologjike, qytete historike, xhami, teqe, varre, varreza dhe disa peizazhe natyrore) të vendosura brenda dhe në afërsi të zonës së Projektit. Projekti do të sigurojë që një arkeolog të jetë i disponueshëm gjatë aktiviteteve të ndërtimit dhe që do të ofrohet trajnimi i profesionistëve mjedisorë/socialë në terren për Procedurat e Gjetjeve të Rastësishme.

Masat e mëposhtme zbutëse do të merren parasysh gjatë punimeve të ndërtimit në afërsi të aseteve TK të vëzhguara dhe të mundshme:

1. Gjatë zbatimit, siç parashikohet në legjislacionin e Trashëgimisë Kulturore (TK), punimet tokësore do të mbikëqyren sipas ligjit nr.27, datë 17.05.2018, "Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë", neni 144-147.
2. Aktivitetet e projektit do të planifikohen në mënyrë të tillë që të shmangen/reduktohen ndikimet në mjedis gjatë ngjarjeve të rëndësishme si vizitat në teqe, ditët fetare sipas kalendarit të komunitetit ose ceremonitë mortore.
3. Monitorimi i rregullt i gjetjeve të trashëgimisë kulturore gjatë punimeve tokësore dhe punimeve të tjera të ndërlidhura me to
4. Një procedurë e gjetjeve të rastësishme do të zhvillohet për menaxhimin e trashëgimisë kulturore nëse zbulohet ndonjë trashëgimi kulturore gjatë ndërtimit. Shembuj të gjetjeve të rastësishme mund të përfshijnë një vend arkeologjik, i cili ka mbetur i pavërejtur ose i padokumentuar në të kaluarën ose një vend me rëndësi kulturore/trashëgimie që nuk ishte identifikuar më parë
5. Shmangia dhe minimizimi i shqetësimit në zonat e ndjeshme të identifikuara brenda një tamponi prej 100 m. Nëse zbulohet se ndikimet në zonat e ndjeshme/të rëndësishme janë të pamundura për t'u shmangur plotësisht brenda kufijve të niveleve të pranueshme të ndikimit, atëherë do të zhvillohen aktivitete specifike restaurimi dhe dokumentimi.

11 MENAXHIMI I ANKESAVE

11.1 Praktika më e mirë ndërkombëtare

Sipas standardeve ndërkombëtare, një mekanizëm ankesash duhet të krijohet sa më shpejt që të jetë e mundur në proces, për të marrë dhe trajtuar në kohën e duhur shqetësimet specifike në lidhje me kompensimin dhe zhvendosjen që ngrihen nga personat e zhvendosur, duke përfshirë një mekanizëm rekursi të krijuar për të zgjidhur mosmarrëveshjet në mënyrë të paanshme. Sipas Standardeve të Performancës së IFC-së, mekanizmi i ankesave duhet të jetë proporcional, i përshtatshëm nga ana kulturore, i aksesueshëm, transparent, i përgjegjshëm dhe të ofrojë mbrojtjen e duhur. Kjo shpjegohet më tej më poshtë.

Projekti ka zhvilluar një Mekanizëm Ankesash (GM) për të marrë dhe trajtuar ankesat dhe ankesat brenda vendit, duke lejuar ende rekursin në gjykata ku përpjekjet për të zgjidhur ankesat përmes mekanizmit të ankesave të projektit dështojnë.

11.2 Parimet kryesore

Parimet e mëposhtme janë zbatuar në zhvillimin e mekanizmit të ankesave të Projektit:

1. Proporcionaliteti: një mekanizëm i shkallëzuar në rreziqet e mundshme dhe ndikimet negative që Projekti mund të imponojë në komunitetet e prekura.
2. Përshtatshmëria kulturore: një mekanizëm i projektuar në një mënyrë të përshtatshme kulturore.
3. Aksesueshmëria: një mekanizëm i qartë dhe i kuptueshëm që është i aksesueshëm për të gjitha segmentet e komuniteteve të prekura pa kosto për ta. Ankesat mund të merren ballë për ballë, nëpërmjet telefonit, e-mailit ose postës.
4. Transparenca dhe llogaridhënia: një mekanizëm që funksionon në mënyrë transparente dhe që i përgjigjet të gjitha palëve të interesuara.
5. Mbrojtja e duhur: një mekanizëm që parandalon ndëshkimin dhe nuk pengon aksesin në mjete të tjera juridike, duke përfshirë mekanizmat gjyqësorë publikë ose jogjyqësorë.
6. Mekanizmi i ankesave nuk duhet të pengojë aksesin në mjetet juridike ose administrative të vendit. Ankuesit dhe personat e prekur janë të lirë t'i drejtohen gjykatës në çdo kohë, pavarësisht nga mekanizmi i ankesave të nivelit të projektit.

11.3 Mekanizmi i Ankesave (GM)


Ky seksion përmbledh Mekanizmin e Ankesave (GM) të zhvilluar nga Voltalia. GM për Projektin merr parasysh legjislacionin kombëtar, si dhe kërkesat e BERZH-it dhe IFC-së. Në përputhje me Kodin e Sjelljes së Voltalia-s, GM do t'i kushtojë vëmendje të veçantë të gjitha çështjeve në lidhje me të drejtat themelore dhe do të krijojë mjete të posaçme për çështjet në lidhje me diskriminimin dhe ngacmimin.

Të gjithë individët, grupet dhe familjet dhe njerëzit e prekur dhe të gjitha grupet e palëve të interesuara do të kenë mundësinë të paraqesin ankesa dhe pyetje për çdo aspekt të aktivitetit të Projektit dhe blerjes së tokës. Kompania do të jetë përgjegjëse për krijimin e këtij Mekanizmi të Ankesave (GM) dhe do të veprojë si sekretar i GM për t'u siguruar që GM është operacionale për të trajtuar në mënyrë efektive shqetësimet mjedisore dhe sociale të personave të prekur nga projekti. GM prezantohet gjatë të gjitha konsultimeve publike dhe publikohet në internet. Kompania do të sigurojë që ankesat dhe shqetësimet për çdo aspekt apo çështje që mund të lindin, të adresohen në kohë dhe në mënyrë të kënaqshme.

Të gjitha rrugët e mundshme janë vënë në dispozicion të personave të prekur për të zgjidhur ankesat e tyre në nivel projekti. Sipas mekanizmit të propozuar të ankesave në nivel projekti, familjet e prekura mund të apelojnë çdo vendim, praktikë ose aktivitet që lidhet me zgjidhjen e një ankesë. AP-të do të ndërgjegjësohen për procedurat që mund të ndjekin për të kërkuar korrigjim, duke përfshirë, nëse është e nevojshme, përdorimin e procedurave administrative ose gjyqësore, si dhe mekanizmat e ankesave të huadhënësve. GM e projektit do të shpërndalet përmes takimeve konsultative, FGD (Fokus Grup), KII (Intervistë me personin kryesor) si dhe do të publikohet në faqen e internetit të Projektit.

Figura 11.1 paraqet grafikun e rrjedhës që përmbledh mënyrën se si përpunohet një ankesë:

FIGURA 11.1: HAPAT KYÇ TË MEKANIZMIT TË ANKESAVE



Hapat e paraqitur në figurën e mësipërme përshkruhen më tej më poshtë:

11.3.1 Hapi 1 – Pritja dhe Regjistrimi i Ankesave

11.3.1.1 Pritja e ankesave

Çdo person ose grup i palëve të interesuara mund të dërgojë komente, ankesa dhe/ose kërkesa për informacion duke përdorur kanalet e përshkruara më poshtë. GM është krijuar për të lejuar çdo palë të interesuar të ngrejë ankesa, pavarësisht nga niveli i tyre i shkrim-leximit ose aksesit në infrastrukturë. Palët e interesuara mund të ngrenë ankesa në shqip ose anglisht, dhe në mënyrë anonime. Palët e interesuara me nivel më të ulët shkrim-leximi inkurajohen të ngrenë ankesa verbalisht. Ankesat do të merren përmes kanaleve të mëposhtme:

1. Komunikimi ballë për ballë me menaxhimin e kantierit të Voltalia ose kontraktorët.
2. Adresat e e-mailit për stafin e menaxhimit të ankesave të Voltalia do të përshkruhen në tabelat e informacionit: karavasta@voltalia.com
3. Numri i telefonit i dedikuar GM i parkut “Karavasta Solar”: +355 68 402 7034
4. Kutitë e ankesave që do të vendosen në të gjitha pikat hyrëse në sheshin e projektit të Karavastasë.

Pas marrjes së një ankesë, pranuesi do t'i shpjegojë ankuesit procesin dhe afatet kohore për hapat e mbetur në procedurë dhe do të informojë se si do të trajtohet ankesa. Marrësi do të sigurojë konfidencialitetin e ankuesit që nga paraqitja e një ankesë e tutje. Vetëm ata që janë të

përfshirë drejtpërdrejt në procesin e ekzaminimit do të pajisen me detajet e ankesës. Informacioni i ndjeshëm do të zbulohet vetëm me dijeninë dhe miratimin e përdoruesve.

Pranuesi do të informojë ankuesin se ankesa mund të depozitohet gjithashtu në mënyrë anonime nëse ankuesi e preferon atë. Megjithatë, në rastin e një ankesë anonime, ankuesit nuk do t'i jepet asnjë vazhdim apo zgjidhje.

11.3.1.2 Regjistrimi i ankesave

Pas pranimit, ankesa do të regjistrohet në regjistrin e ankesave **brenda 1 dite pune**.

Regjistri i ankesave është një Microsoft Excel i cili përdoret për regjistrimin, gjurmimin dhe menaxhimin e ankesave. Kjo do të ndihmojë në gjurmimin e tendencave dhe modeleve të përgjithshme në shqetësime, duke lejuar që çështjet e reja të shënohen dhe të kuptohen në një fazë të hershme. Si minimum, informacioni i mëposhtëm do të regjistrohet:

1. Të dhënat
2. Detajet e ankesës
3. Historia e ankesave/pyetjeve/pyetjeve të tjera
